



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 29/24

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data / Datum 16.02.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43, paragrafi 1 i Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28, paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24, paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **29 shkurt 2024, e enjte, me fillim në ora 10:00.**

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 25 janar 2024, vazhduar më datën 01 shkurt 2024
2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2023
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga ZKA, për Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022
4. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet shëndetësore për vitin 2023, në Komunën e Vushtrrisë
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për emërim të komisionit për ndarjen e bursave
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me procedurën e kërkesave për lejet ndërtimore për vitin 2023
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit për punën njëvjeçare të Komitetit për Komunitete për vitin 2023
8. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024
10. Pyetje dhe përgjigje

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 28/24

Nr. i fq. / Br. st - 2 -

Data: / Datum 16.02.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUÇITRN

PËR:	Kuvendin e komunës
NGA:	Melihate Basholli Latifi Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
PËRMES:	Sekretarisë së Kuvendit
TEMA:	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 15.02.2024

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **15 shkurt 2024** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

- Shqyrtimi i Raportit periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga ZKA për Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022.
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***
- Shqyrtimi i Informatës për shërbimet shëndetësore për vitin 2023 në Komunën e Vushtrrisë.
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që t'i bashkëngjitet plani i investimeve kapitale për vitin 2023 dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***
- Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërim të komisionit për ndarjen e bursave.
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***
- Shqyrtimi i Informatës lidhur me procedurën e kërkesave për lejet ndërtimore për vitin 2023.
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të plotësohet dhe të bëhen krahasime me vitet paraprake dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***
- Shqyrtimi i Raportit për punën njëvjeçare të Komitetit për Komunitete për vitin 2023.
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

6. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
7. Shqyrtimi i Planit të Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
8. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2023
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -I- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 25 JANAR, VAZHDUAR MË 01 SHKURT 2024

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:20. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Adnan Lahu, Agim Bregaj, Ali Januzi, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Faton Hyseni, Galip Audi, Gresa Muli, Gentiana Rama, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Jeton Gjaka, Mek Selaci, Refik Maloku, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Shkelzen Xhaferi, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Mehulli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Munguan: Arlind Gogolli dhe Nasuf Aliu.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 33 anëtarë të kuvendit, kuorum i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-pasi uroj për një fillim vit të mbarë kërkoj nga të gjithë anëtarët e kuvendit të kenë një bashkëpunim të sinqertë dhe projektet që janë në të mirë të përgjithshme ti mbështesin dhe ti shtyjnë përpara, ndërsa të kundërshtojnë aty ku ka keqmenxhim keqpërdorim dhe keqebërje.

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-ngriti shqetësimin e adresuar nga qytetaret lidhur me një vend punishte në rrugën “G.J.K. Skënderbeu” përballë Akademisë Policore ku në atë vend është bllokuar rruga dytësore si dhe ka filluar shembja e terreni dhe kësaj ka rrezik të shembjes së rrugës kryesore. Pyetja e saj për këtë çështje është se a janë duke u monitoruar nga komuna këto vendpunishte. Më tej pyeti lidhur me atë se para pak kohe kryetari i komunës ka pezulluar punimet në 6 objekte ndërtimore banesore, për çfarë është bërë ky pezullim a kanë pasur leje këto objekte sepse në njërin nga këto objekte është bërë gërryerja deri në cepin e rrugës dhe të shtëpive përreth duke shkaktuar kështu rrezik të përgjithshëm. Pastaj lidhur me planin e prokurimit të prezantuar nga kryetari i komunës thuhet se për vitin 2024 parashihen rreth 9 milion euro për investime

kapitale, gjë kjo e cila nuk është e saktë sepse në shtator 2023 kur është aprovuar buxheti i komunës kemi pasur 6 milion euro për investime kapitale.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-diskutimi i tij u orientuar në një kërkesë të banorëve të fshatit Stanoc i Epëm lidhur me largimin e një deponie të mbeturinave, e cila gjendet mbi lagjen “Haradinaj” dhe kjo është një pengesë për banorët lokal të atë vend. Lidhur me këtë kërkoj opinionin e Drejtorit të Prokurimit, i cili në kohën kur ka qenë asamblistë e patë ngritur këtë shqetësim për këtë deponi mbeturinash, andaj ky i fundit a do të veproj në këtë drejtim për asgjësuar këtë deponi.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se në dy vitet qeverisje të Ferit Idrizi, nuk di se për çfarë do mbahet mend ky kryetar përpos pastrimin e lumenjve dhe rregullimin e kanalizimit. Pastaj çështja e projektit të ujit është shumë larg realizimit dhe ky projekt ka mbetur aty ku e kishte lënë qeverisja e kaluar e LDK-së.

Ilmi Azemi, drejtor i Drejtorisë së Prokurimit-njoftoi se plani i prokurimit i prezantuar nga kryetari i komunës është identik me planifikimin buxhetor të raportuar dhe aprovuar nga ana kuvendit të komunës. Lidhur me këto çështje duhet pasur parasysh se komuna ka lidhura kontrata njëvjeçare dy dhe trevjeçare varësisht nga natyra e projekteve investive. Dhe e rëndësishme të kuptohet është fakti se komuna ka në dispozicion një buxhet për projekte kapitale të aprovuar pak më shumë se 6 milion euro, ndërsa vlera e projekteve kapitale investive është afër 9 milion euro. Lidhur me çështjen e dopnisë së mbeturinave në fshatin Stanoc i Epëm, u zotua se shpejt do të merren veprimet e nevojshme për ta asgjësuar por do të veprohet edhe në drejtimet tjera ku ato gjenden.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-pyeti se drejtorin e Drejtorisë së Financave, se buxheti i komunës që është aprovuar, në kuvend a ka mbetur i njëjtë në kodet buxhetore, për faktin se edhe atëherë kur është votuar ai ka tërhequr vëmendjen se është duke u votuar buxheti gabimisht me një shabllon, copy-past nga viti 2023 dhe për këtë në bazë të një hulumtim që ka bërë shihet që ka ndryshime dhe këto ndryshime janë në kundërshtim me ligjin, pasi që kur aprovohet buxheti ai bëhet ligj për komunën si organizatë buxhetore. Në bazë të kësaj ai ka informata se ato janë ndryshuar dhe nëse kjo ka ndodhur ai ato do ti dërgoj tek prokuroria e shtetit.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-ngriti shqetësimin e tij lidhur me një projekt të KEDS-it, që po zhvillohet në fshatin Sllakoc-Samadrexh-Ceceli dhe Dumnicë, ku shtyllat elektrike të betonit po vendosen në kanalet e ujit dhe po bllokohen kanalet atmosferike, dhe pyeti sa ka marr leje KEDS-i nga Komuna e Vushtrrisë për vendosjen e këtyre shtyllave. Po ashtu shqetësuese është edhe vendosja e një shtylle elektrike metalike në hyrje të qytetit në ç’ rast është bllokuar trotuar nga të dy anët e kalimit të qytetarëve, edhe për këtë pyeti se a është mbikëqyrur dhe a është marrë leje para se të vendoset kjo shtyllë.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-propozoi që të futet në rendin e ditës propozim-vendimi për amandamentimin e vendimit Nr.47/20 të datës 27.02.2020 për ndarjen e mjeteve financiare për fëmijët e porsalindur në Komunën e Vushtrrisë, ku vlera aktuale është 120 €, por duke parë shkallën e inflacionit por edhe komunat tjera të cilat kanë vepruar, propozoi që kjo vlerë nga 120 € të rritet në 250 €

Lorik Maxhuni, drejtor i DSHPS-së-tha se kostoja aktuale e këtij subvencionimi për fëmijët e porsalindur Komunës së Vushtrrisë i kushton mbi 130,000.00€ që është një barrë jashtëzakonisht e madhe për ne si komunë dhe drejtori. Pastaj shtoi se kupton kalkulimin politik të parive politike në kuvend për të përfituar vota, por kjo nuk logjik të shëndosh. Më tej shtoi se çështje tjera më të rëndësishme që duhet menduar të futen për subvencionim siç është ajo për të sëmuret me sëmundje të rënda kaceroze dhe tomore, të cilëve nuk po mundem tu dalim në ndihmë. Prandaj vlerësoi se

nuk duhet të ngutemi në vendim por ndoshta do të ishte mirë të bëhet një komision nga pozita dhe opozita për ta analizuar këtë çështje.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-sqaroi se përderisa është aprovuar, buxheti i komunës për vitin 2024, atëherë duhet ditur se cili pozicion duhet anuluar për ta mbështetur propozimin për subvencionimin e fëmijëve.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-sqaroi se në Komunën e Vushtrrisë, kemi afër 900 lindje të fëmijëve në vit, ndërsa kostoja propozimit është pak më shumë se 100.000 €, ndërsa anomalia e krejt kësaj është se në këtë rend ditët është ardhur propozimi që Ndërmarrjes “Përparimi” ti ndahen subvencion 190.000 €. Më tej për shujtat e shërbyesve civil, ku do të merren mjete pyeti Drejtorin e Financave. Andaj propozoi që rritja e subvencioneve për fëmijët të bëhet edhe nga drejtorit tjera komunale jo vetëm nga ajo e shëndetësisë. Krejt në fund pa dashur që ti japim kahe politike, kërkoj që propozimi i tij të futet në votim dhe të përkrahet nga të gjitha grupet politike në kuvend.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se duhet të jemi të kujdesshëm kur marrim, vendimi e po ashtu edhe kur dëshirojmë ti anulojmë ato, sepse nuk është e rrugës se si të ndërrohet qeverisja lokale të ndërrohen të gjitha vendimet sepse kështu prishet vazhdimësia e funksionimit të komunës dhe kjo është e dëmshme.

Lorik Maxhuni, drejtor i DSHPS-së-vlerësoi se e mbron qëndrimin e tij se ky vendim për subvencione duhet të shfuqizohet, sepse subvencionet në shumë raste nuk sjellin zhvillim por stagnim, prandaj duhet të fillohet të mendohet në staza të zhvillimit afatgjatë e jo të mendohet për kalkulim elektorale ditore dhe afatshkurtra.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se është mirë të shtyhet përpara kjo çështje, sepse gjendje është e rënd, dhe kjo do të ndihmonte sadopak në zbutjen e kësaj gjendje. Edhe në vitin 2020 kur është marr ky vendim atëherë është lënë mundësia që mjetet të merren edhe nga drejtoritë tjera ku ka mundësi financiare.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se pas diskutimeve që u bën është i mendimit që të formohet një komision që të shikohet se a ka mundësi ligjore dhe financiare të ndryshohet një vendim i tillë për rritjen e mjeteve për fëmijët e porsalindur.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se sinqerisht është për keqardhje ndryshimi brenda minutave i opinionit të anëtarëve të kuvendit, dhe deklaroi se ta shohin të gjithë qytetaret se kush po i mbron interesat e përgjithshme e kush po i kundërshton ato.

Në vazhdim kryesuesja e kuvendit konstatoj se në sallë janë 30 anëtarë të kuvendit kuorum i mjaftueshëm për të marr vendim dhe i procedoj një nga një pikat në të ndryshme për votim dhe atë si vijon:

Me vota 29 vota “për” 2 vota “abstenim” u aprovua për të hyrë në rendin e ditës propozim-vendimi për miratimin e nismës të kryetarit të komunës për bashkëpunim ndërkomunal.

Me 30 vota “për” 1 votë “abstenim” u aprovua për të hyrë në rendin e ditës propozim-vendimi për shfuqizimin lidhur me miratimin e Planit për Integritet.

Me vota “unanime” u aprovua për të hyrë në rendin e ditës propozim- vendimi për ndryshimin e vendimit Nr.289/23 i datës 28.12.2023 për ofrimin e ndihmës financiare për z.Nasuf Aliu.

Lidhur me propozimin për ndryshimin e vendimit Nr.47/20 të datës 27.02.2020 për ndarjen e mjeteve financiare për fëmijët e porsalindur në Komunën e Vushtrrisë, gjegjësisht rritja shumë financiare nga 120 në 250 €, kryesuesja e hodhi në votim këtë propozim, ku rezultati i votimit ishte 9 vota “për” dhe 9 vota “kundër” në ç’ rast ishte shfrytëzuar vota e dyfishtë e kryesueses së kuvendit, e cila konstaton se një propozim i tillë nuk aprovohet për shqyrtim në rendin e ditës.

Më pas opozita reagon duke deklaruar se ishte edhe një anëtar i kuvendit të cilit nuk i ishte numëruar vota e tij, e që pretendimi ishte se kjo votë ka qenë “pro”. Në këtë rast u kërkua të shikohet video-incizimi, mirëpo tek pjesa e votimit incizimit kishte pasur defekt.

Në vazhdim kryesuesja e kuvendit lidhur me propozimin për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit Nr.47/20 të datës 27.02.2020 për ndarjen e mjeteve financiare për fëmijët e porsalindur në Komunën e Vushtrrisë, deklaroi se pas disa defekteve që patë në sistemin e incizimit vizuel të seancës, nuk po mund të konstatohen saktë numri i votave për këtë pikë, prandaj mënyra e vetëm për të dal nga kjo situatë është përsëritja e këtij votimi, sepse sipas saj ajo ka konstatuar vetëm pjesën e parë të kësaj pike të rendit të ditës por jo edhe për pjesën e dytë, që është propozim-vendimi për formimin e komisionit.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-tha se kjo çka po ndodhë është një turp i kësaj qeverie komunale, për faktin se nuk e kishte besuar se do të bien në këso gjendje, sepse po thuhet se nuk po shihet, por deklaroi se vota e tij ka qenë “për” dhe ka përfunduar gjithçka sipas tyre votimi ka qenë 9- 9 pro dhe kundër, dhe kur u deklarua se ka votuar edhe anëtari i kuvendit Faton Hyseni atëherë del se rezultati i votimit është 10 “për” ndërsa 9 vota “kundër”. Dhe tani në këtë situatë duhet të shfuqizohet ai votim dhe kjo nëse ka drejt ligjore dhe më tej të vazhdohet votimi, prandaj shtoi se kjo situatë e fshehjes së gjërave është e turpshme dhe nuk është as në traditën e shqiptarëve.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-tha se pas konstatimit të kryesueses së kuvendit se nuk ka kaluar ajo pikë e rendit të ditës, atëherë nuk mbetet gjë tjetër veç të kalohet në pikën e radhës, ndërsa të gjithë tjerët që mendoj se ka pasur paqartësi dhe parregullsi në votim mund të ankohen në MAPL, sepse nëse kthehesh mbrapa atëherë bënë shkelje ligjore.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se ajo çfarë po ngjan në këtë kuvend vërtet është e turpshme, është e paprecedent, nuk është hera e parë që dikush nga teknologjia bënë kesi lloj veprimesh edhe tek fjalimet edhe tek drejtimi i kamerës, sepse nuk është çudi se kur përfundon në IT dhe në kamerë nga zyrtari i administratës së partisë në zyrtar i administratës së kuvendit komunal atëherë pritet gjithçka që të ndodh. Andaj kryesues asnjë fuqi nga jashtë nuk e prevalon vullnetin e të zgjedhurve të popullit dhe deklarimin e tyre në votim, nuk ka sekretari që mund ta ndryshoj vullnetin e lirë të shprehur nga qytetarët, nëse ka gabim atëherë keni obligim të përmirësoni gabimin në bazë të deklarimit të anëtarit të kuvendit. Kjo tregon për nivelin e vërtet të qeverisjes së Ferit Idrizit kjo është e turpshme!

Në vazhdim kryesuesja i dha fjalën drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë për tu deklaruar, ndërsa filloj protestimi me trokitez në tavolinë i grupeve dhe anëtarëve nga opozita, për këtë kryesuesja mori pauzë prej 10 minutave.

Pas pauzës dhe pas konsultimeve, kryesuesja e kuvendit deklaroi se me qëllim të heqjes së çdo dileme, lidhur me procesin e votimit e dërgoj në votim të përsëritur propozim-vendimin

për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr.47/20 të datës 27.02.2020 për ndarjen e mjeteve financiare për fëmijët e porsalindur në Komunën e Vushtrrisë, ashtu që të rritet vlera e mjeteve financiare nga 120 € në 250 €, pas votimit ky propozim nuk more *asnjë votë “për”*, ndërsa 13 anëtarë të kuvendit votuan *“kundër”* kësisoj kryesuesja konstatoj se kjo pikë nuk aprovohet për futej në rendin e ditës.

Më pas kryesuesja e hedhi në votim propozim-vendimin për formimin e komisionit lidhur me shqyrtimin e gjendjes për ofrimin e ndihmës për fëmijët e porsalindur, pas votimit ky propozim mori 18 vota *“për”* asnjë kundër asnjë abstenim dhe kësisoj u aprovua për rend dite.

Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 22 vota *“për”* aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 28 dhjetor 2023;
2. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve për periudhën janar – dhjetor 2023;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për pagesën e shujtave ditore për zyrtarë të administratës së komunës;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për ndarje të mjeteve financiare - Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” SH.A në Vushtri;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për ndarje të dekoratës “Nderi i Qytetit” për Heronjtë e Kosovës: Enver Zymberi (post mortum) dhe Afrim Bunjaku (post mortum);
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për financim të shkollimit të fëmijëve të Heronjve të Kosovës: Enver Zymberi dhe Afrim Bunjaku;
7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit për KKSBB-në;
8. Rishqyrtimi i vendimit të kuvendit nr.289/23 i datës 28.12.2023 për ofrimin e ndihmës financiare për z.Nasuf Aliu;
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për shfuqizimin lidhur me miratimin e Planit për Integritet;
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për miratimin e nismës të kryetarit të komunës për bashkëpunim ndërkomunal;
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit lidhur me shqyrtimin e gjendjes për ofrimin e ndihmës për fëmijët e porsalindur;
12. Pyetje dhe përgjigje.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 28 dhjetor 2023;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me 23 vota “për”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datën 28 dhjetor 2023.

2. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve për periudhën janar – dhjetor 2023;

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se raporti i shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor 2023 është dëshmia më e mirë, e keqqeve dhe keqmenaxhimit të kësaj qeverisje lokale në Komunën e Vushtrrisë. Në i shikojmë të hyrat vetanake sipas drejtorive komunale dhe kodeve ekonomike, i kemi afër gjysmë milioni me tepër të inkasuar në vitin 2023 por kjo ka ardhur si rezultat i rritjes së tatimit në pronë. Tabela tjetër shpenzimet sipas burimeve të financimit tek kodi 10 nga bashkëfinancimi i kemi 600 mijë euro të humbura që kanë shkuar në suficit që nuk i kemi shfrytëzuar për projektet zhvillimore për Komunën e Vushtrrisë. Hiq më mirë nuk qëndron gjendja tek kodi 21 dhe 22 i të hyrave ku në total kemi të pashfrytëzuara 636, 000.00 €, e kemi parasysht se këto mjetet mund të barten këtë vit por gjithsesi se edhe këtu kemi humbje. Në tabelën tjetër sipas kategorive të larta të shpenzimeve këtu kemi një pasqyrë jo reale të të dhënëve ashtu siç është dashur të jetë p.sh shohim se shënon se kemi buxhet të planifikuar rreth 9 milion euro ndërsa realizimi i buxhetit 8.1 milion euro ose në përqindje 95%, por kjo ka ndodhur që 2.1 milion euro janë shkuar për mbulimin e obligimeve nga vendimet gjyqësore d.m.th mjetet e dedikuara për projekte kapitale janë shkuar për pagesat për vendimet gjyqësore dhe kësaj shpenzimi i buxheti për investime kapitale bie në 5.9 milion euro dhe kësaj shume nëse ia shtojmë edhe shumën e avanseve që komuna i ka paguar në vlerë prej 600 mijë euro pagesa për punët që akoma nuk kanë filluar, kështu del se buxheti është shpenzuar në vlerën 5.3 milion euro apo në përqindje 59%, që afërsisht jemi aty sikurse në vitin e kaluar dhe qytetarët e Vushtrrisë duhet ta dinë se gjysma e projekteve për këtë vit fiskal kanë dështuar në Komunën e Vushtrrisë. Pastaj tek mallrat dhe shërbimet kodi 13440 në vitin 2023 janë shpenzuar 52.000.00 € shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse, dhe në këtë kod kryetari i komunës iu ka dhënë kontrata shokëve dhe shoqeve të tij, të afërmeve dhe militantëve të tij partiak, në kodin ekonomik 13820 avans për udhëtime jashtë vendit shuma në raportin vjetor që është shpenzuar është 28.400 €, por çuditërisht në raportin nëntëmujor kjo shumë është më e madhe se sa në raportin vjetor ku kjo shumë figuron 32,000.00€ pyeti si është e mundur kjo. Por sipas informatave që ka ai kjo shumë vjetor del të jetë mbi 70 mijë euro, dhe kërkoj nga drejtori i DBF-së që ta konfirmoj këtë. Fatkeqësisht atje ku është dashur të shpenzohet më shumë është shpenzuar më pak p.sh tek mirëmbajtja e ndërtesave, mirëmbajtja e shkollave, mirëmbajtja e objekteve shëndetësore për këtë të fundit janë shpenzuar 655 € dhe kjo është shumë keq. Në fund duke ju referuar një komenti ku ceket se mbetja për bartje të mjeteve nga investimet kapitale për vitin 2024 është në vlerë prej 900.000.00 € dhe duke pasur parasysht se kemi edhe 500 mijë euro tejkalime nga të hyrat e komunës gjithashtu 600 mijë euro që barten nga fondi 21 dhe 22 dhe mbledhur të gjitha këto mjete në total del se të gjitha këto nuk po i mbulojnë kostot për të gjitha projektet kapitale të planifikuar për vitin 2024 dhe për këtë pyeti kryetarin e komunës se cilat projekte do të hiqen nga lista e projekteve për tu realizuar në vitin 2024.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-duke ju referuar raportit vjetor të shpenzimit të buxhetit vlerësoi se në kushte normale kur një qeverisje performon mirë është dashur të pritët me padurim dhe me krenari prezantimin e këtij raporti, mirëpo kur kemi të bëjmë me një qeverisje skandaloze të dështuar, e cila nuk ka ditur të menaxhoj tash e dy vite ku me dhjetëra milion euro kanë shkuar në suficit, këtu i pengon edhe incizimi i mbledhjes dhe nga zyrtari përgjegjës ku po mundet edhe po prehet incizimi. Kur bëhet fjalë për 90 projekte kapitale që janë votuar nga ana e këtij kuvendi, për ti gëzuar qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, por prej këtyre projekteve shuma prej 3,5200.166 € nuk kanë shkuar në adresim për çfarë janë votuar, prej tyre 909,255.00 € kanë mbetur suficit, kurse shumën prej 2, 142.911 € i ka marrë përmbaruesi. Prandaj ai duke ju adresuar qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, deklaroi se kryetari i komunës në rrjetet sociale ka paraqitur kryevepra dhe mega projekte në investime, por deklaroi me përgjegjësi të plotë se projekti më i madh i këtyre dy viteve i qeverisjes Idrizi, quhet përmbaruesi Atip Mustafa 1,750.788 € i ka marrë nga projektet

kapitale të planifikuara të realizohen në të gjitha lokalitetet e Komunës së Vushtrrisë në vitin 2023, kjo është e vërteta dhe diku mundet të mos i pëlqej në incizim. Në vazhdim ai përmendi disa nga projektet kapitale që janë votuar e të cilat si rezultat i të cekurave më lart nuk do të realizohen: ndërtimi i vigave mbi lumin “Silnica” “Terrstena” 60 mijë ero nuk do të realizohet sepse paratë i ka marrë përmbaruesi, Kolektori kryesor Nadakoc-Studime 60 mijë ero, Kolektori kryesor Sfaraçak 60 mijë ero, ndërtimi i rrugëve me kubëza “Adem Ademi” 25,514 €, ndërtimi i trotuarit “Sadri Maksuti” 10,000.00 €, sinjalizimi horizontal dhe vertikal 25,000.00 €, sinjalizimi digjital 20,000.00 €, zgjerimi i rrjetit në Pasomë 60,000.00 €, zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit Beçiq-Duboc 50,000.00 €, zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit Stanco-Dumnicë 170,000.00 €, zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në Mihaliq 80,000.00 €, zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në Prelluzhë 5000 €, ndërtimi i shesheve dhe parqeve 20,000.00 €, blerja e veturave për administratën komunale 20,000.00€, rregullimi i shtratit të lumit “Tërrsten” 95,000.00 €, ndërtimi i urës mbi lumin “Podranqa” 50,000.00 €, blerja e automjeteve për zjarrfikësit 14,000.00 €, blerja e pajisjeve për zjarrfikësit 50,000.00 €, blerja e sistemit të montimit të alarmit 8000 €, projektit me bashkë donator në Drejtorinë e Bujqësisë 280,000.00 €, asfaltimi i rrugës në Prelluzhë 5613 €, ndërtimi i rrugës “Avni Saraçi” 62,000.00 €, nderimi i rrugës “2 maji” me infrastrukturë 129,000.513 €, ndërtimi i rrugës “Boletini” 29,000 789 €, asfaltimi i rrugës “Rasim Tahiri” 13,445 €, ndërtimi i parkut tek Shkolla Ali Kelmendi 10,000 €, asfaltimi i rrugës në Dumnicë 12,000.00 €, asfaltimi i rrugës në Ceceli 8724 €, asfaltimi i rrugës në fshatin Akrashticë 81,987.00 €, asfaltimi i rrugës në fshatin Balicë 5946 €, asfaltimi i rrugës në fshatin Doberllukë 21,459.00 €, asfaltimi i rrugës në fshatin Begaj 13,000.00 €, asfaltimi i rrugës në fshatin Pasomë 5000 €, blerja e veturës për shërbimet rezidenciale 3863 €, ndërtimi i ndihmës objektit të stadiumit Ferki Aliu 20,000.00 €, ndërtimi i pllakave përkujtime në fshatin Pasomë 20,000.00 € restaurimi dhe konstruktimi i objektit të Arkivit Historik 20,000.00 €, ndërtimi i një skulpture me karakter historik 22,000.00 €, renovimi i palestrës “Jeton Tërstena” 28,000.00 €, renovimi i çerdhes 26,000.00 €, ndërtim i kaldasë për ngrohej në shkollën “Lutfi Musiqi” 10,878 €, të gjitha këto projektet që i numëroj nuk janë realizuar në vitin 2023 sepse kanë shkuar tek përmbaruesi, edhe pse këto kuvendi i ka aprovuar por këto nuk janë realizuar dhe kësaj është humbur mundësia për zhvillim të komunës sonë dhe ofrimin e kushteve më të mira për qytetarët tanë. Sipas drejtorive komunale humbjet janë infrastruktura publike 1,67000.504 €, zjarrfikësit dhe inspektimet 34,000.00 €, menaxhimi i fatkeqësive 8000 €, bujqësia 289,000.496 €, planifikim, urbanizmi dhe inspeksioni 446,000.650€, shërbimet e shëndetit primar 50,000.00 €, shërbime rezidenciale 13863 €, shërbime kulturore 145,000.100 €, arsimit para fillor-çerdhet 37,822 €, arsimit fillor 8000 €, arsimit mesëm 41,474 €. Përmbaruesi privat këto mjetet nuk do i kishte marrë sikur këto projektet do të realizoheshin para muajit dhjetor 2023, por meqë projektet nuk janë realizuar me qëllim që të dilet pak më mirë në këtë raport financiar, kanë arritur një marrëveshje për të realizuar kontrata e punëtorëve të arsimit që ku takojnë me kontratën kolektive, por sikur komuna të kish performuar si duhet dhe të kishte aplikuar ankesë, mjetet nuk do të kishin shkuar në këtë formë, ai e mirëpret dhe i gëzohet faktit që mësimdhënësit i kanë marrë mjetet që iu takojnë sepse buxheti ka mundur të shkojë komplet në suficit, me gjithë këtë kjo formë e shpenzimit të buxhetit bazuar në ligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës ku brenda ditësh bëhen transaksione miliona euro është pistë e hapur për Prokurorinë dhe krimet ekonomike. Kushdo që i konteston këto të dhëna le ta kontestoj Drejtorin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa sepse ai e ka sjellë këtë raport. Në fund tha se qeveria i ka gënjyer qytetarët kur i ka votuar projektet për të realizuar në vitin 2023 dhe ka dështuar në realizimin e tyre, ndërsa paratë i ka adresuar në një drejtim krejt tjetër tek përmbaruesi privat.

Benjamin Shala, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike-tha se raporti i cili është sjell është i sakë por interpretimi i tij nga z.Meholli është 99 % i pasaktë, sepse duhet pasur parasysh se dallojë shumat e planifikuara nga shumat e kontraktuara, shumica e projekteve janë realizuar ato janë të prekshme dhe disa janë në procedurë e sipër, por me qëllim po tentohet të krijohen situata të pa qarta para qytetarëve.

Ilmi Azemi, drejtor i Drejtorisë së Prokurimit-në diskutimin e tij bëri një pyetje publike për parafolësit, se çfarë mendojnë qytetarët kur i dëgjojnë këto diskutime të tyre, kur buxheti për vitin 2023 është shpenzuar në masën 95%. Tutje shtoj se deputeti Meholli, preku shumë tema të cilat i ka devijuar në masën 90%, sepse ai nuk e kupton strukturën e investimeve kapitale. Më tej shtoj në adresë të z.Meholli se a është i gatshëm të kërkoj falej publike, për ato projekte që i përmendi si të dështuara, e që nuk është e vërtet sepse shumica e tyre janë në realizim e sipër, d.m.th diskutimi i tij është mashtrim. Lidhur me suficitet buxhetore sqaroi se konstatimet e sipër cekura janë të paqëndrueshme, sepse në procedurat e prokurimit mund të ketë kursime në projekte të caktuara. Çështja e përmbartimit, ceku se nuk është mirë ti jepet konotacion negativ sepse kemi të bëjmë me një marrëveshje që ka arritur kryetari i komunës me avokatet për realizimin e një të drejte ligjore që iu ka takuar mësimdhënësve nuk është mirë të fyhet inteligjenca e 1200 arsimtarëve që janë në Komunën e Vushtrrisë. Në bazë të kësaj marrëveshje janë kursyer rreth 1 milion euro shpenzime gjyqësore dhe pagesa e këtyre obligimeve do të bëhet me dy pjesë. Ai shtoj se si qeveri janë të lumtur që kjo marrëveshje është përmblyllur deri në një masë dhe mësimdhënësit i kanë marr mjetet e tyre.

Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-duke replikuar ceku se me shifra dhe emër është e evidentuar se cilat projektet kanë dështuar të tjerat që fare nuk kanë filluar, dhe krejt kjo ka ndodhur si rezultat i paafësisë së kësaj qeverie komunale.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se buxheti për kapitale është shpenzuar në vlerën 8 milion euro, por që ky buxhet nuk është dedikuar për qytetarët, sepse e dimë që një pjesë bukur të madhe i ka marr përmbartuesi dhe një pjesë janë paguar avansë, d.m.th. shuma që komuna e ka realizuar për investime kapitale është 5.3 milion euro, dhe pyetja konkrete është se mungojë afër 3 milion euro për ti mbuluar realizimin e projekteve kapitale për vitin 2024 pyetja është se ku do të merren këto mjete.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se në raport evidentohet se kemi një shpenzim të buxhetit rreth 95%, por jo në realizim të projekteve, pra projektet nuk janë realizuar ashtu siç kanë qenë të planifikuara për vitin 2023. Realizimi i buxhetit për 2023 është bërë në këtë masë për faktin se përmbartuesit privat i kanë marrë komunës mbi 2 milion euro për kryerjen e obligimeve ndaj punëtorëve të arsimit obligime që burojnë nga Kontrata Kolektive e Arsimit e nënshkruar në vitin 2017 mes MASHTI dhe SBASHKU. Edhe për kundër kësaj prapë shihet se kemi mos shpenzim të buxhetit tek investimet kapitale nga mbi 9 milion që kanë qenë të planifikuara janë shpenzuar mbi 8 milion euro që i bie sa afër 1 milion euro kanë mbetur të pashpenzuara. Duke ditur se shumë lagje dhe fshatra të Komunës së Vushtrrisë nuk kanë ujë të pijes, nuk kanë kanalizime dhe trotuare, ndriçim publik etj, mos realizimi i buxhetit në projekte kapitale për vitin 2023, është dëshmi për dështim të qeverisjes lokale dhe mos realizim të premtimeve nga kryetari Ferit Idrizi. Nga tabelat për mallrat dhe shërbime për periudhën janar-dhjetor 2023 janë dal këto të gjetura se për udhëtime brenda vendit nga 756 € sa kishim në vitin 2023 kjo shifër është rritur në 3131 € në vitin 2023, shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit nga 3260 € kemi rritej 13,674 €, shpenzime tjera të udhëtimit zyrtar jashtë vendit nga 1731 € kemi rritje në 13,532 €, shpenzime tjera intelektuale dhe këshillëdhënës nga 541 € në 52,652 €, dhe shpenzime të vendimeve gjyqësore nga 18,612 në

254,681 €, nga këto raporte shihet se kemi dështim në realizimin e projekteve dhe dështim në menaxhimin e parasë publike.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-duke u bazuar në raport vlerësoi se si rezultat i keqmenaxhimit të kësaj qeverie, shumë mjete kanë shkuar në suficit dhe shumë projekte kanë dështuar për të cilat ndjenë keqardhje për të gjithë ata qytetar që kanë mbetur pa këto projekte. Veçanërisht ndjen keqardhje që në fushën e rinisë nuk është realizuar asnjë projekt dhe të gjitha mjetet kanë shkuar në suficit. Ajo çka e karakterizon këtë qeveri janë udhëtimet jashtë vendit me taksat e qytetarëve ku nga 5998 € në vitin 2022 në vitin 2023 janë shpenzuar 31,370 € për udhëtime jashtë vendit. Ndërsa tek udhëtimet brenda vendit në vitin 2023 kemi 5989 € shpenzime a po ashtu edhe 2022 është një shifër e përafërt. Mandej ngriti shqetësimin e tij tek shpenzimet intelektuale dhe këshillëdhënëse ku kërkoj sqarime nga Drejtori i Financave se si është rritur shuma nga 541 € në 52,652 €.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-tha se këtë raport e kemi përgatitur në bazë të planit të rrjedhës së parasë të buxhetit të vitit 2023. Tutje shtoi se të dhënat e parashtruar në raport janë të sakta dhe realizimi i buxhetit i prezantuar është e dhënë e saktë. Pastaj njoftoi se në të hyrat vetanake kemi pasur një ngritje në inksim dhe tejkalim të planit për 17%. Mandej njoftoi se buxheti i planifikuar për 2023 ka qenë pak më shumë se 28 milion euro, ndërsa realizimi afër 27 milion apo në përqindje 95%. Më tej sqaroi se shpenzimi i buxhetit bëhet sipas kodeve ekonomik, ndërsa kur bëhet shpallorja në pasqyra financiare do të shihni sa kemi pasur shpenzim në projekte kapitale dhe sa janë marrë nga procesi përmbarimor. Lidhur me shpenzimet e përmbaruesit ceku dhe vlerësoi se nuk janë të dëshirueshme, por ato në një formë apo në një tjetër është dashur të paguhen sepse janë obligime ligjore që dalin nga kontrata kolektive.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se raporti është me të dhëna të sakta, por problemi qëndron në atë se cilat projekte do të hiqen nga plani buxhetor për vitin 2024 si rezultat i mungesës së mjeteve financiare dhe duhet njoftuar qytetaret e Vushtrisë se disa projekte do të mbesin pa u realizuar si rezultat i përmbarimit.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-falënderoj drejtorin e Drejtorisë së Financave, për informacionet e ofruara, dhe shtoj se është e vërtetë që buxhetit është shpenzuar në masën 95% por jo në dedikimin për të cilin ka votuar kuvendit sepse shumë projektet janë mbetur pa u realizuar si rezultat i përmbarimit.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-tha se si rezultat i pa aftësisë së kësaj qeverie mjetet do të shkonin në suficit, dhe duke dashur që këto para mos ti merr Qeveria, është shfrytëzuar mundësia që këto pare të iu jepjen mësimdhënësve përmes përmbaruesit privat. Po ashtu paraqiti vërejtje tek udhëheqja e mbledhjeve nga kryesuesja e kuvendit, kur rasti më eklatant ka qenë votimi në emër të tjetër kujt, ndërsa sot ka qenë tjetërsimi i votës të një asamblisti.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-tha se shpenzimi i buxhetit në këtë formë nuk është i mirë, dhe kjo bënë që shumë projektet do të mbesin pa u realizuar dhe kështu nuk do ti dalim në fjalë zotimeve që i kemi marrë para qytetarëve.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 23 vota “për” 6 vota “kundër” aprovoj Raportin e shpenzimeve për periudhën janar – dhjetor 2023.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për pagesën e shujtave ditore për zyrtarë të administratës së komunës;

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se e mbështetin këtë propozim-vendim për mbështetjen sa do pak të punëtorëve të administratës komunale, por siç dihet shujtat hyn në kuadër të pagës, dhe pagesa e tyre është dashur të bëhet nga kategoria paga dhe mëditje e jo siç është propozuar nga kategoria e subvencioneve. Dhe tani shtohet pyetja se a kemi të drejtë të paguajmë shujta për punëtorët e administratës nga kategoria subvencione dhe transfere.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-tha se nëse votohet ky propozim me shumën prej 3 € për shujtë kostoja vjetro është 240.000.00€ dhe kjo është shumë e madhe për buxhetin dhe kjo është një veprim populist nga kryetari i komunës. Ai shprehu bindjen se ky vendim do të kthehet negativ nga MAPL-ja sepse është në kundërshtim me pagat. Pastaj shtoj se arsyetimi i këtij propozim nuk është hartuar si duhet ku thuhet se janë prekur nga kriza punëtorët e administratës por nga kriza janë prekur edhe kategoritë tjera si mësimdhënësit mjeket dhe kategoritë tjera. Ai propozoi që këto 240,000.00 € të ndahen në mënyrë lineare për të gjithë të punësuarit në sektorin publik në Komunën e Vushtrrisë. A po ndryshe më mirë kishte me qenë që këto mjetet të ndahen për të hendikepuarit.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-tha se përkrahi këtë propozim –vendim si mjaft i qëlluar dhe shtoj se vlera prej 3 € është e vogël dhe duhet të rritet. Tutje shtoj se mjetet do të merren nga kategoria subvencione dhe transfere dhe kjo e bënë më lehtë të zbatueshëm këtë vendim. Gjithashtu sqaroi se me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, është e ndaluar që nga kategoria e pagave të bëhen pagesa të tilla. Prandaj propozoi që shuma për shujtë të jetë 4 € për punëtorët e administratës së komunës dhe kërkoj që propozimi i tij të hedhet në votim.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se e përkrahi këtë propozim-vendim, por mënyra e pagesës nga kategoria subvencione dhe transfere, dyshon se është e kundërligjshme dhe do të ketë problem në zbatimin e këtij vendimi.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-tha se vërtet është mirë që stimulohen punëtorët e administratës së komunës, por mirë kishte me qenë që edhe sektorët tjerë të përkrahen sepse kriza i ka kapluar të gjithë. Ai pyeti Drejtorin e Arsimit se sa është numri i punëtorëve të arsimit dhe i administratës ashtu që të kemi një pasqyrë të sakë për koston e shpenzimit para se kuvendi të marrë vendim.

Nurie Halili, anëtare e kuvendit-tha se si parti politike e kanë analizuar këtë propozim-vendim dhe në konsultim me kryetarin e komunës, janë ardhur në përfundim se shuma e përballueshme për zbatimin e këtij vendim është 3 €, prandaj nëse insistohet në shuma tjera atëherë vihet në rrezik zbatimi i këtij vendim për shkak të mungesave financiare të komunës. Kërkoj nga të gjitha grupet kuvendar që të përkrahet propozimi i kryetarit të komunës ashtu që tu dalim në ndihmë punëtorëve të komunës.

Zojë Hajrizi, anëtare e kuvendit-tha se ky propozim-vendim i sjell nga kryetari i komunës, është mjaft i qëlluar, kur dihet fakti se pagat në administratën komunale janë mjaft të ulëta, dhe duke parë ngritjen enorme të çmimeve për produktet bazike, pozita materiale e punëtorëve të administratës është mjaft e rënduar. Tutje vlerësoi se vlera prej 3 € fillimisht është e mjaftueshme për të zbutur sado pak gjendjen e rënduar të këtyre punëtorëve. Kërkoj nga të gjithë anëtarët e kuvendit që ta përkrahin këtë propozim-vendim.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-tha se e përkrahë këtë propozim-vendim për të ofruar ndihmë, dhe pyeti se a është i ligjshëm dhe duke u zbatuar vendimi për shujtat e zjarrfikësve. Ai shprehu drojën se edhe ky vendim do ta ndaj fatin e vendimit për shujtat e zjarrfikësve sepse do të jetë vështirë i realizueshëm. Ai potencoi se sigurimi i shujtave të ishte i mirëseardhur edhe për punëtorët e ndërmarrjeve publike në Vushtri.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-pyeti sa në pikën 2 të këtij vendimi thuhet se mjetet do të sigurohen nga të hyrat e bartura të vitit 2023 në vitin 2024 nga kategoria ekonomike e

subvencioneve dhe transfereve, nga programi Administrata dhe Personeli, kodi buxhetor 163, nënprogrami 16324 (administrata), në shumë prej 240,000.00 € (dyqind e katërdhjetëmijë euro). Kjo nuk është e sakë për faktin se nga raporti më herët pamë se ky fond është shpenzuar dhe tani kanë mbetur vetëm 26,562.00 €, prandaj shtohet tema si do të sigurohen këto mjetet kur në fakt nuk i kemi në dispozicion për faktin se janë shpenzuar. Tutje ai ngriti çështjen e koeficientit për anëtarët e kuvendit i cili nuk është konform numrit të popullatës së Komunës së Vushtrrisë i cili është 5.7 e që duhet të jetë 5.8, kjo është pasojë e organeve të administratës së komunës të cilët nuk e kanë ngritur me kohë këtë problematikë tek ministria e linjës.

Mensur Kasumi, anëtar i kuvendit-i kërkoj falje anëtares së kuvendit znj.Fatmire Cecelia, për keqkuptimin që patën gjatë seancës së kuvendit.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-lexoj dispozitat e nenit 46 të Ligjit për pagat në Sektorin Publik ku thuhet se me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet çdo dispozitë që lidhet me pagesat dhe shtesat tjera në sektorin publik. Kjo i bie se përpos kategorisë ekonomike ku merren mjetet që është gabim, po ashtu do të jetë e pamundur zbatimi i këtij vendimi edhe sa i përket Ligjit të Pagave.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-tha se bazuar në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, nuk ka linjë buxhetore për pagesën e shujtave nga kategoria paga dhe mëditje dhe ajo mallra dhe shërbime, sikur të kishte pasur kod, këto mjete me kohë do të planifikoheshin dhe të njëjtat do të ekzekutoheshin. Çështja është se brenda për brenda kategorisë ekonomike në nënprograme mund të bëhen bartje dhe dedikime të caktuara për destinim të caktuar, por sido që të jetë verdiktin final për këtë çështje do ta japë edhe MAPL-ja.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesja e kuvendit fillimisht e hodhi në votim propozim-vendimi me shkrim nga kryetari i komunës që shuma për shujtat e punëtorëve të administratës së komunës të jetë 3.00 €, propozim i cili mori 12 vota “për” asnjë kundër asnjë abstenim, kryesuesja konstatoj se ky propozim nuk aprovohet.

Ndërsa për propozim që shuma e shujtave të jetë 4.00 € mori 16 vota “për” ndërsa 3 anëtarë të kuvendit kishin votuar edhe për propozim e parë edhe për propozimin e dytë, që kishte shkaktuar dilema sa i përket rregullsisë së këtij procesit të votimit, në këtë rast kryesuesja e kuvendit konstatoj se asnjëri nga propozime nuk aprovohet.

Në vazhdim si rezultat i pakënaqësisë lidhur me votimin në mënyrë demonstrative grupi kuvendar i LDK-së, grupi kuvendar i LVV-së dhe anëtari i kuvendit nga AAK në mënyrë demonstrative lëshuan sallën e mbledhjes, në sallë mbeten 16 anëtar të kuvendit kuorum i pamjaftueshëm për marrjen e vendimeve dhe mbledhja u ndërpre në ora:15:10.

Më datën 01 shkurt 2024 ditë e enjte ora 10:20 kryesuesja e kuvendit hapi punimet e mbledhjes së ndërprerë të datës 25 janar 2024, konstatoj se në sallë janë të pranishëm 22 anëtarë të kuvendit kuorum i mjaftueshëm për marrjen e vendimeve të plotfuqishme me pika e rendit të ditës të mbetura nga mbledhja e ndërprerë.

Munguan: Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Edona Gashi, Fakete Dushi, Gentiana Rama, Kushtrim Hyseni, Mek Selaci, Mensur Kastrati, Nasuf Aliu, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Spasoje Stefanoviq.

Fillimisht kryesuesja e kuvendit, njoftoj anëtarët e kuvendit, për shkakun e ndërprerjes së mbledhjes të datës 25.01.2024, e po ashtu njoftoj se për votimin e pikës për shujtat e shërbyesve civil, ka kërkuar opinion ligjor nga MAPL, rreth atij votim, dhe është në pritje të një përgjigje zyrtare.

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për ndarje të mjeteve financiare - Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” SH.A në Vushtrri;

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-fillimisht kërkoj nga kryesuesja e kuvendit që të kërkoj opinion ligjor nga MAPL, edhe për sa i takon propozimit lidhur me rritjen e vlerës së subvencioneve për fëmijët e porsalindur që kishte propozuar të rritet kjo vlerë nga 120 € në 250 €, për shkak se në bazë të asaj që ka ndodhur me deklarimin e anëtarit të kuvendit vendimi ka kaluar. Sa i takon propozim-vendimit për ndarje të mjeteve financiare - Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” SH.A në Vushtrri, deklaroi se si grup nuk do ta mbështesin një vendim të tillë, për faktin se si komunën kemi ndarë tash e disa herë shuma të mëdha parash për këtë ndërmarrje dhe në asnjë rast këto mjete nuk janë arsyetuar nga kjo ndërmarrje. Kjo shumë prej 190,000.00 € që ka ardhur është mjaft e madhe, dhe po ndahet nga kategoria subvencione, ndërsa kur po kemi çështje tjera po arsyetohemi se nuk ka mjete. Tutje shtoj se parimisht nuk janë kundër që të ndihmohet kjo ndërmarrje në fuqizimin e saj nuk janë kundër kërkesave të tyre dhe kundër atyre punëtorëve. Megjithatë kjo ndërmarrje duhet të ndërtoj një sistem dhe një shëndet financiar, pasi që tani e tutje qytetarët do të ia paguajnë faturën e mbeturinave kësaj ndërmarrje, dhe kjo do të krijoj të hyrat e veta dhe kësaj nuk ka nevojë që kjo ndërmarrje të ia shpenzoj komunës subvencionet. Mandej nëse shikohet propozim-vendimi dhe arsyetimi i tij del se këtë arsyetim e ka bërë komuna, ne nuk kemi një kërkesë apo një arsyetim nga ana e N.P.L. “Përparimi” si kërkues i mjeteve, dhe kuvendi minimalisht është dashur ta ketë një kërkesë nga ndërmarrja për ti parë specifikat se çfarë kërkesash kanë për ti financuar nga ana e komunës, për shkak se duhet ditur se a është në rregull që nga mjetet e subvencioneve të komunës ndërmarrja me ble makineri punuese që janë investime kapitale. Tutje ne gjithë e dimë sa çfarë kosto ka makineria e re (kamionët për bartjen e mbeturinave), dhe me 190,000.00 €, nuk ka mundësi të blihen as dy kamion të ri dhe të certifikuar për bartjen e mbeturinave. Me këto mjete mund të blihen kamion të përdorur, siç ka ndodhur edhe më herët që janë pa garancion dhe të njëjtit nuk kanë mundur të regjistrohen. Pastaj shtohet pyetja se si ka lejuar komuna ta ngarkoj këtë ndërmarrje me menaxhim të mbeturinave kur e njëjta nuk është e gatshme, sepse nuk ka makineri, dhe tani ne si komunë duhet të investojmë vazhdimisht në këtë ndërmarrje. Në fund vlerësoi dhe potencoi se kjo pikë duhet të kthehet për plotësim me kërkesë dhe me specifikat e duhur për këtë makineri dhe më pas të silllet në kuvend për ta analizuar dhe aprovuar, në këtë formë si ka ardhur nuk duhet votuar sepse nuk i bëjmë mirë as ndërmarrjes, as komunës e as qytetarëve tanë.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se fillimisht nga kryesuesja e kuvendit u tentua që të tejkalohej çështja e votimit të pikës paraprake që ishte bërë shkak për lëshimin e mbledhje së datës 25 janar 2024, pa i marr sqarimet e nevojshme nga kryesuesja e kuvendit. Pastaj shtoj se nuk është hera e parë që krijohet mjegulli sa i përket votimi të pikave të rendit të ditës nga ana e kryesueses së kuvendit, dhe kjo ka ndodhur herën e fundit në dy raste apo në dy pika të rendit të ditës. Nga shikim i seancës së kaluar del se për pikën shujtat e punëtorëve të administratës kanë votuar 19 anëtarë të kuvendit, dhe kërkoj që shkresa që i është dorëzuar MAPL-së nga ana e kryesuese së kuvendit ti dërgohet të gjithë anëtarëve të kuvendit. Sa i përket propozimit për ndarjen e mjeteve për “Përparimin”, vlerësoi se nuk duhet që këtë ndërmarrje ta politizojmë sepse po tentohet nga

ana e pushtetit, por ceku se duhet lënë që ata punëtor ta kryejnë punën e vet sipas ligjit. Dyshimet kryesore janë në mënyrën e kalimit të punëtorëve nga Ndërmarrja “Uniteti” tek ndërmarrja “Përparimi” dhe pyeti se për këtë çështje a është konsultuar aspekti ligjor, se a është ligjore apo jo kalimi i këtyre punëtorëve. Ndërsa sa i përket shumës, kërkoj të shqyrtohet mundësia që kjo shumë të rritet për shkak se kjo vlerë është e vogël për ta rimëkëmbur këtë ndërmarrje. Si grup kuvendar e përkrahin këtë propozim-vendim.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-tha se ka pasur gabime për sa i përket menaxhimit të seancës, dhe pikat kontestuese nga mbledhja e ndërprerë kanë kaluar. Sa i përket Propozim – vendimit për ndarje të mjeteve financiare - Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” SH.A në Vushtrri, jemi të obliguar që ti ndihmojmë kësaj ndërmarrje, mirëpo edhe bordi i kësaj ndërmarrje duhet ti marr punët me seriozitet që të kujdeset mirë për punëtorët dhe pajisje e kësaj kompanie. Kërkoj nga bordi i kësaj ndërmarrje që në raport kur të vjen në mars ti përmbush këto pika si në vijim: të specifikoj në detaje për blerjen e kamionit për të cilin po dyshohet se ka pasur keqpërdorim të parave të qytetarëve, me mjetet që do ti ndajmë të regjistrohesh të gjitha mjetet që janë të pa regjistruar që çdo ditë po rrezikohet jeta e atyre punëtorëve, të shtrohet me kubëza ose të asfaltohet oborri ku po mbahen mjetet makineria e ndërmarrjes, sepse sa herë që bie shi baltoset i tërë qytetit nga këto mjete, nëse ka mundësi në bashkëpunim me komunën ta ndërrojnë lokacionin i kësaj ndërmarrje, të gjendet mënyra që punëtorëve tu paguhet shujta, sepse sipas informatave Ndërmarrja “Uniteti” veç e ka përfunduar çështjen e shujtave, kjo ndërmarrje ti merr në mbikëqyrje pastrimin e varrezave sikur ka ndodhur në komunat tjera, ti kryejnë punët që iu takojnë si p.sh zhblllokimi i kanalizimeve sepse nuk është në rregull që dy vite mos të funksionoj kanalizimi në shkollën “Migjeni” në Stanoc të Epërm, të merret me seriozitet puna e ndriçimit dhe mos të marr urdhra nga qeveria komunale për ndriçimin e lagjeve të caktuara, sepse kemi shumë vende ku dritat e dëmtuara asnjëherë nuk janë ndërruar. Në fund tha se vota e tij do të jetë pro kësaj pike për ta ndihmuar këtë ndërmarrje, por gjithëherë do të jetë zë aktiv për ti shpërfaqur keqpërdorimet kudo që ndodhin ato.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit-tha se kjo ndërmarrje duhet të ndihmohet që të mëkëmbet dhe duhet po ashtu të mbështetet ata punëtor. Më tej shtoj se nuk duhet të kemi ndasi politike, por duhet të jemi unik në ndihmesën e kësaj kompanie. Ai shtoj se punëtorët e kësaj ndërmarrje kanë të angazhuar 100% në interes qytetar dhe duhet të njëjtit të mbështeten. Kërkoj që ndihma për këtë ndërmarrje të rritet shuma dhe propozoi që të mbështet unanimisht.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-tha se krejt kishte me qenë në rregull ndarje e këtyre mjeteve sikur të mos kishte pasur politizim të kësaj ndërmarrje, dhe sikur të mos kishte qenë i vendosur pasuesi që mjetet dedikohen për blerjen e mjeteve të punës. Është me rëndësi që të kemi një specifikacion se për cilat mjete të punës po dedikohen këto para.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-si përfaqësues i NISMES Socialdemokrate, i japë mbështetje të plotë këtij propozim-vendimi, kjo për faktin se me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, i është dhënë mundësia që komunat të themelojnë ndërmarrje lokale, duke shfrytëzuar këtë të drejtë ligjore komuna jonë tashmë e ka të themeluar këtë ndërmarrje në pronësi 100% komunale të aksioneve. Më tej ai parashtron një mori të detyrave, përgjegjësi dhe funksioneve të ndërmarrje të cilat duhet ushtruar konform statutit, dhe strategjisë së funksionimit të kësaj ndërmarrje ku bartës i këtyre funksioneve është komisioni i aksionarëve dhe bordit drejtues i ndërmarrjes. Meqë jemi në proces kur ndërmarrja ka marrë në menaxhim mbeturinat dhe po ashtu është regjistruar në ARBK, dhe ka marrë në shfrytëzim edhe deponimin e mbeturinave në Gërmovë, konsideron se është tepër e nevojshme aprovimi i këtij subvencioni për këtë ndërmarrje.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se nga propozim-vendimi shihet se kemi të bëjmë me një kërkesë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, e jo nga ndërmarrja çka nuk është dashur të jetë kështu. Pastaj shtoj se arsyetimi i këtij propozimi është tepër i mangët, për shkak se nuk e kemi të specifikuar se çfarë do të blihet me këto mjete. Kjo ndërmarrje ofron shërbime, ndërsa këto shërbime qytetarët e Komunës së Vushtrrisë i paguajnë, a ceku se nuk janë kundër ta ndihmojnë këtë ndërmarrje por duhet të kemi paraprakisht një kërkesë të specifikuar se çfarë po mëtohet të bëhet me këto mjete financiare. Nëse ndahen këto mjetet atëherë ato duhet të shpenzohen sipas ligjit për financat publike. I bëri thirrje kësaj ndërmarrje që ti krye punët për të cilat është e thirrur, sepse ka kohë të gjatë që në tri rrugë në Stanoc të Epërm nuk funksionin ndriçimi publik, po ashtu kanë detyrë të merren me pastrimin e varrezave.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke u përgjigjur në çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit. Dhe shtoj se kjo shumë nuk e dëmton kategorinë dhe plani buxhetor, ndërsa mjetet do të ndahen për blerjen e pajisjeve të punës për këtë ndërmarrje ndërsa për destinime tjera nuk mund të përdoren, sepse kjo është e specifikuar me ligj.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se për të bërë të qartë sqaroi se nuk kemi kërkesë nga ana e ndërmarrjes por kërkesa ka ardhur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe kryetari i komunës. Pastaj shtoj se një kërkesë nga kjo kompani e kemi pasur në muajin dhjetor, dhe po e njëjta nuk ka specifikuar se sa do të jetë çmimi i këtyre pajisjeve.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-tha se duhet të rritet kontrolli i shpenzimit të parasë në ndërmarrjen “Përparimi” duke ceku se këtë i takon ta bënë komisioni komunal i aksionarëve. Tutje shtoj se ka keqpërdorime nga menaxhmenti i kësaj kompanie dhe kjo duhet të ndalet. Pastaj shtoj nevojën që të ndryshohet rregullorja për menaxhimin e mbeturinave për faktin se kemi tarifa shumë të larta si për bizneset ashtu edhe për ekonomitë familjare.

Ferit Idri, kryetar i komunës-tha se kërkesës për këto mjetet nga ndërmarrja është bërë vitin e kaluar dhe në dhjetor janë ndarë 60,000.00 €, ndërsa tani duhet të ndahet edhe kjo pjesë. Kjo ndërmarrje duhet të ndihmohet sepse është e qytetarëve pa dallime dhe njoftoj tani ndërmarrja ka marrë në menaxhim edhe mbeturina dhe pastrimin e varrezave në gjithë fshatrat e Komunës së Vushtrrisë, dhe ndarja e këtyre mjeteve nuk duhet specifikuar por le të jepen këto mjete si ndihmë sepse besojmë se në të ardhmen kjo ndërmarrje do të pavarësohet financiarisht dhe nuk do të ketë nevojë për ndihmë, ftoj të gjithë që ta votojnë këtë pikë këtë subvencion.

Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 19 vota “për” 6 vota “kundër” kuvendi vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, ndahen mjete financiare nga buxheti i komunës – subvencione dhe transfere të vitit 2024, në shumë të përgjithshme prej 190,000.00 € (njëqind e nëntëdhjetëmijë euro) në llogari të N.P.L “Përparimi” SH.A. në Vushtrri, mbështetje financiare për blerje të mjeteve të punës.

2. Mjetet në shumën e cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen si vijon:

2.1. Drejtoria e Shërbimeve Publike, kodi i programit 180, nën programi 18184, shuma 40,000.00 € (katërdhjetëmijë euro), kategoria subvencione dhe transfere.

2.2. Drejtoria për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, kodi i programit 470, nën programi 47024, shuma 98,000.00 (nëntëdhjetë e tetëmijë euro), kategoria subvencione dhe transfere.

2.3. Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, kodi i programit 850, nën programi 85024, shuma 40,000.00 (katërdhjetëmijë euro), kategoria subvencione dhe transfere.

2.4. Drejtoria për Arsim, kodi i programit 920, nën programi 92120, shuma 12,000.00 € (dymbëdhjetëmijë euro), kategoria subvencione dhe transfere.

2. Kryeshefi Ekzekutiv i NPL. “Përparimi” përmes komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes do të paraqes raport periodik dhe vjetor financiar në kuvendin e komunës lidhur me shpenzimin e mjeteve nga pika 1 e këtij vendimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shërbime Publike dhe drejtoritë tjera kompetente.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen Zyrtare të komunës së Vushtrisë.

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për ndarje të dekoratës “Nderi i Qytetit” për Heronjtë e Kosovës: Enver Zymeri (post mortum) dhe Afrim Bunjaku (post mortum);

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se në emër të grupit kuvendar të LVV-së, i mbështesim plotësisht këto propozime për nderimin e këtyre heronjve që ranë në krye të detyrës në mbrojtjen e atdheut.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit- tha se në emër të grupit kuvendar të LDK-së, i mbështesim plotësisht këto propozime për nderimin e këtyre figurave dhe përgëzoj kryetarin e komunës që për nderë të pavarësisë së Republikës së Kosovës të nderohen këta heronj.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-kërkoj që emri i heroit policit Enver Zymeri të shënohet drejt sepse mbiemri i tij është Zymeri.

Zojë Hajrizi, anëtare e kuvendit- tha se edhe grupi kuvendar i PDK-së e përkrah këtë propozim-vendim për nderimin e këtyre heronjve që ranë në krye të detyrës në mbrojtjen e sovranitetit dhe integriteti territorial të Republikës së Kosovës.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Në shenjë respekti, për akte të larta sakrifice dhe heroizmi për vendin, me titullin “Nderi i Qytetit” nderohen Heronjtë e Kosovës:

1.1. Enver Zymeri – (post mortum)

1.2. Afrim Bunjaku – (post mortum)

2. Dekoratat nga pika një e këtij vendimi i dorëzon Kryetari i Komunës familjarit të të dekoruarit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen Zyrtare të komunës së Vushtrisë.

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për financim të shkollimit të fëmijëve të Heronjve të Kosovës: Enver Zymeri dhe Afrim Bunjaku;

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-kërkoj që për djalin e heroit Enver Zymeri, të bëhet pagesa në mënyrë retroaktive për dy pagesa që ka bërë në rastin e ndjekjes së mësimit për të rritur në shkollën teknike.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, fëmijëve të Enver Zymerit, dhe Afrim Bunjakut, Heronj të Kosovës, iu financohet shkollimi në të gjitha nivelet e arsimit nga buxheti i komunës, subvencione dhe transfere.
2. Mjetet financiare për financim të shkollimit do të jepen në formë të bursave nga buxheti i Drejtorisë për Arsim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Arsim.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen Zyrtare të komunës së Vushtrisë.
7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit për KKSB-në;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 17 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim ndryshohet vendimi 01 Nr. 101/23 date.27.04.2023 për themelimin të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si vijon:
 - 1.1 Në paragrafin 1, pika 1.3, z. Alban Tahiraj, caktohet anëtar i KKSB-së kurse z. Dardan Abazi, pushon të jetë anëtar i KKSB-së, sipas nenit 4, pika 1.9 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e kryetarit dhe Sekretaria e Kuvendit.
3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen Zyrtare të komunës së Vushtrisë.
8. Rishqyrtimi i vendimit të kuvendit nr.289/23 i datës 28.12.2023 për ofrimin e ndihmës financiare për z.Nasuf Aliu;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim z. Nasuf Aliu, anëtar i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë i ofrohet mbështetje financiare në shumë prej tremijë euro (3000.00 €) për nevoja të shërimit nga një sëmundje serioze që është diagnostikuar kohëve të fundit.

2. Mjetet financiare të cekur në pikën paraprake të këtij vendim do të sigurohen nga buxheti i komunës – kategoria subvencione dhe transfere, **Programi Buxhetor (16024)-zyra e kryetarit.**

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për shfuqizimin lidhur me miratimin e Planit për Integritet;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 157/23 datë 29.06.2023 për miratimin e Planit Komunal për Integritet për periudhën 2023-2025.

2. Obligohet kryetari i komunës që të merr masat e nevojshme për të miratuar Planin Komunal për Integritet për periudhën 2024-2026.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pushon të vlej vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 157/23 datë 29.06.2023 si dhe Plani Komunal për Integritet 2023-2025.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen Zyrtare të komunës së Vushtrrisë.

10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për miratimin e nismës të kryetarit të komunës për bashkëpunim ndërkomunal;

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-njoftoi se kjo iniciativë ka buruar nga ana e tij si kryetar i komunës që në bashkëpunim me këto komuna të iniciohet procesi për ndërtimin e rrugës regjionale që fillon nga fshati Barilevë-Kozaricë-Dumnicë e Epërm-Konovik-Vesekoc-Kurillovë e që lidhet me rrugën e Bajgorës e që i lidhë Malet e Shalës së Bajgorës me qëllim të zhvillimit të agroturizimit dhe zhvillimit ekonomik. Kjo kërkesë është nënshkruar nga të gjithë kryetaret e komunave dhe është proceduar tek Ministria e Infrastrukturës e cila e ka mbështetur një kërkesë të tillë. Në konsultim me zyrtaret e ministrisë së linjës është marrë obligim që komunat të bëjnë hartimin e projektit dhe studimin e fizibilitetit, ndërsa Ministria e Infrastrukturës të bëjë financimin e këtij projekti.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë 02Nr. 47/24 datë 23.01.2024 për bashkëpunim ndër komunal në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Komunave: Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Prishtinë dhe Podujevë, për realizim të projekteve me interes të përbashkët.

2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, miratohet propozim vendimi për financim të përbashkët të **studimit të fizibilitetit si dhe hartimit të projektit detaj/zbatues për ndërtimin e rrugës: Barilevë-Kozaricë-Dumnicë e Epërme-Kunovik-Vesekoc-Kurillovë-Bajgorë.**

3. Autorizohet Kryetari i Komunës së Vushtrrisë që të filloj konsultimet me Kryetarët e Komunave nga pika 1 (një) e këtij vendimi për të përgatitur Draftin e Marrëveshjes për bashkëpunim ndërkomunal për financim të përbashkët të studimit të fizibilitetit dhe hartimit të projektit detaj.

4. Ky Vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Vendim iu dërgohet : MAPL-së dhe Kryetarëve të Komunave: Prishtinë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq dhe Podujevë.

11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit lidhur me shqyrtimin e gjendjes për ofrimin e ndihmës për fëmijët e porsalindur;

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se lidhur me këtë pikë konsideron se ka kaluar në seancën e kaluar, në pikën e rendit të ditës ku është propozuar rritja e përkrahjes financiare për fëmijët e porsalindur në vlerën prej 250 € nga numri i pjesëmarrësve me votim të thjesht vendimi është aprovuar, ka mbetur vetëm konstatimi nga ana e kryesueses të cilin konstatim nuk e keni bërë, këtë konstatim keni provuar ta bëni përmes video-xhirimit të seancës ky video incizim është prerë apo nuk është prezantuar nga zyrtari përkatës, e vetmja votë që ka qenë kontestues anëtar i kuvendit ka dal publikisht dhe e ka deklaruar votën e tij. Prandaj për grupin e ti kuvendar tashmë ky vendim është aprovua dhe vetëm duhet ti kaloj filtrat e MAPL-së dhe fëmijët e porsalindur të Vushtrrisë të gëzojnë këtë të drejtë. Diferenca e aspekti financiar të këtij vendimi është pak më tepër se 100,000.00 €, dhe kërkoj që pasi të merr vlerësimin ky vendim të zbatohet.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se si LDK janë që të rritet kjo shumë për fëmijët e porsalindur, sepse dihet që ky vendim ka ardhur pikërisht në qeverisjen e LDK-së. Mirëpo pasi kanë biseduar me Drejtorin e Financave, ata janë që të formohet një komision dhe kështu të mos merren vendime të cilat nuk do të mund të zbatohen.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-edhe njëherë deklaroi se për atë pikë vota e tij ka qenë pro, sepse për të nuk është me rëndësi se kah vjen ideja e rëndësishme është të kemi një përparim. Tutje shtoj se derisa Komuna e Rahovecit një komunë më e vogël se Vushtrria po ndan deri në 500 € për fëmijët e porsalindur, pse komuna jonë nuk e bënë një gjë të tillë.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha pushteti aktual punon me dy standarde, nuk kërkon analizë financiare dhe komision për ndarjen e mjeteve për Kompaninë “Përparimi”, ndërsa kërkojnë komisione të veçanta për rritjen e subvencioneve për fëmijët e porsalindur. Nuk kërkohet

analizë, dhe ndahen mjete për një ndërmarrje e cila fare nuk ka parashtruar kërkesë dhe pa pasur asnjë specifikë se ku do të shkojnë ato jete ky është standardi i funksionimit të kësaj qeverie.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-sqaroi se sikur ka ndodhur një ngatërrim sepse propozimi atë ditë në seancë për rritjen e subvencioneve për fëmijët e porsalindur ka qenë propozim për të hyrë në rend dite e jo që është marr vendim për këtë çështje.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-tha se nuk e kupton dualitetin e standardeve të përdoruar, derisa më herët u ndan 190,000.00 € pa asnjë specifikacion se ku do të shkojnë ato mjete, tani dalin dilema sa i përket rritjes së subvencioneve për fëmijët e porsalindur kur dihet saktë se për çfarë do shfrytëzohen ato mjete.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se nuk e ka problem se kush e propozon një pikë në rend dite, por problem është buxheti dhe zbatimi i vendime në mungesë të buxhetit. Pastaj shtoj se komuna tjetër e cila ka marr vendim për subvencion ka marr vendim vetëm për fëmijët që lindin në maternitetin e asaj komuna, nëse e marrim këtë formulë, atëherë siguron se ka mjete për zbatim të vendimit, por e vërteta është se krejt lindjet nuk kryhen në Vushtri, por kryhen edhe në Mitrovicë e shumica në Prishtinë. Prandaj ne si komunë jemi duke i subvencionuar të gjithë fëmijët që janë rezident të Komunës së Vushtrisë. Më tej nuk nevojë të formohet komision për këto çështje, sepse Drejtori i Financave do të vjen dhe do të raportoj me shifra të sakta para kuvendit, e nëse ai prezanton shifra të rrejshme dhe jo reale atëherë keni të drejt të formoni komision. Prandaj ai i sugjeroi kuvendit që të kërkojnë nga Drejtori i Drejtorisë së Financave një informatë të qartë lidhur me të gjitha subvencionet dhe të bëhet një analizë financiare lidhur me këtë çështje, nëse ka hapësirë atëherë do aprovojmë këtë rritje

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se qëllimisht këtu po tentohet të devijohet e vërteta, sepse askush nuk ka dilema në pasqyrat financiare. Mbledhjen e kaluar është votuar për të hyrë në rendin e ditës propozimi për rritjen e subvencioneve për fëmijët, kryesuesja nuk e ka numëruar një votë, janë incizimet, ka pasur dilema të një asamblistë i cili doli publikisht deklaroi se vota e tij ka qenë pro propozimit për rritjen e subvencioneve në 250 €. Kemi bërë përpjekje që ajo votë të konstatohet përmes video-incizimit dhe nuk kemi mundur, ndërsa kryesuesja nuk e ka konstatuar drejt situatën lidhur me epilogun e votimit të kësaj çështje.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-tha se nuk e ka të qartë se për çfarë komisioni po bëhet fjalë, nëse veç ka vullnet atëherë është dashur që vjen sot propozim-vendimi për formimin e atij komisioni.

Në fund të debatit lidhur në kuadër të pikës së rendit të ditës Propozim – vendimi për formimin e komisionit lidhur me shqyrtimin e gjendjes për ofrimin e ndihmës për fëmijët e porsalindur, kuvendi pas votimit me 14 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim vendosi me sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrisë, në mbledhjen e mbajtur më datë: **01 shkurt 2023**, ka shqyrtuar Propozim – vendimit për formimin e komisionit lidhur me shqyrtimin e gjendjes për ofrimin e ndihmës për fëmijët e porsalindur, dhe në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës është aprovuar sugjerimi i kryetarit të komunës ashtu që Drejtorisë për Buxhet dhe Financa i parashtron këtë:

Rekomandim:

Kuvendi i Komunës së Vushtrisë ka miratuar rekomandimin e kryetarit të komunës ashtu që Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Vushtrisë, të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse,

buxhetore dhe të dalë me një raport se a ka mjete financiare për rritjen e subvencioneve për përfituesit fëmijët e porsalindur të Komunës së Vushtrrisë, ashtu që vlera financiare prej 120 € sa është aktualisht të rritet në 250 €, sipas propozimit të dhënë nga shefi i grupit kuvendar të LVV-së z. Sylejman Mehulli.

Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Vushtrrisë, që ta informoj kuvendin e komunës në një afat sa më të arsyeshëm.

12. Pyetje dhe përgjigje:

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-deklaroi se në takimin e fundit që ka pasur me kryetarin e komunës në zyrën e tij, ai i ishte drejtuar se koalicion nuk ka lidhur me z.Faton Hyseni por me kryetarin e Degës së AAK-së në Vushtrri, gjë për të cilën ka pasur të drejtë, dhe kishte thënë se është i lirë që të votoj sipas bindjes së tij, dhe pikërisht esh kështu është duke vepruar, sepse nuk i lejon kredibiliteti i tij moral e njerëzor të bëhet marjonetë e askujt. Prandaj pyetja e tij është pse dërguat drejtorin tuaj në nivel qendror për të ia ndalur zërin atij pasi që ai është i lirë.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se me Faton Hyseni, ka rrugëtuar gjatë, dhe nëse i ka thënë ndonjë fjalë që e ka lënduar atëherë ai i kërkon falje, por ai u zotua se ja ku i ka drejtoret nga subjekti i tij le të flasim nëse ai ka kërkuar që të ja ndal zërin anëtarit të kuvendit z.Faton Hyseni, sepse nuk e lejon veten në bien në pozicione të tilla, për të kërkuar diçka që nuk është në natyrën e tij.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-kërkoj nga kryesuesja e kuvendit që të jetë shumë më e përpiktë në zbatimin e rregullores së punës së kuvendit dhe kërkoj sqarime se çfarë aprovimi ndodhi dhe e kaloi kryesuesja e kuvendit nuk e kemi të qartë dhe dëshirojmë të dimë. Ku mbeti pika për tu formuar komisioni që ishte në rend dite, a u votua, a u ndryshua nëse po si ka mundësi të ndryshohet pika gjatë trajtimit të rendit të ditës dhe dëshiron një shpjegim juridikisht të kësaj çështje. Prandaj ai kërkoj nga kryesuesja e kuvendi që të zbatohet rregulloren dhe mos ta sjellë kuvendin dhe anëtarët e tij në kësi lloj situatash të palakueshme kur nuk dihet se për çfarë po votohet.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se nga mbledhja e kaluar u pajtuam që të shkohet me formimin e një komisioni ku do të konstatohej nëse kemi mjete për ti rritur këto subvencione, dhe me qëllim që të mos merret vendim pa pasur mbulueshmëri financiare, dhe tani është dashur që ajo pikë të dal në votim, por nuk ndodhi dhe kësaj kjo formë e udhëheqjes së kuvendit është për keqardhje dhe po i fyen anëtarët e kuvendit. Pastaj shtoj se kryetari i komunës kishte premtuar se për afatin prej 6 muajsh do të rregullohet furnizimi me ujë të pijes, por shtroj se a e din se përse nuk ka pasur ujë Vushtrria për 12 vitet e qeverisjes së PDK-së, sepse pikërisht qeverisja e tyre ka ndërtuar një fabrikë të ujit në vendin e gabuar, sepse vendi ku është vendosur është në nivelin e duhur për ta furnizuar të gjithë qytetin me ujë dhe kjo bënë që duhet të kemi sistem të pompimit. Aty ku gjendet fabrika, nuk mundet të furnizohet me ujë i gjithë qyteti me rënie të lirë, dhe detyrimisht është dashur të përdoret sistemi i pompimit.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-tha se para dy viteve e kishte pyetur kryetarin e komunës, se si është çështja e furnizimit me ujë të pijshëm për rajonin e Lumit të Kuçi siç quhet, dhe tani përsërit se deri ku ka shkuar ky projekt.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se ka pasur përpjekje të pareshtura për ta lëshuar ujin e pijshme, por ka shumë problem dhe ndër to është fakti se kur është bërë instalimi i rrjetit të ujësjellësit është bërë pa projekt, sepse është shkuar në sistem të pompimit në sistem të

hidroforëve, dhe pompat janë vendosur më tepër se 1 km larg burimit të ujit. Ai njoftoi se është bërë projekti që të bëhen disa nën bazën dhe të eliminohet sistemi i pompimit i cili po del se nuk është funksional.

Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit-njoftoi se pasi vjen nga ai rajon e një shumë mirë dhe deklaroi se fabrika është e vendosur në vendin më të mirë të mundshëm. Po ashtu ai kërkoi nga kryesuesja e kuvendit që jap sqarime lidhur me mënyrën e votimit, në rastin kur kemi dy propozime.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-tha se në kohën sa ka qenë drejtor nuk është vendosur sistemi i pompimit për ujin e pijshëm.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-përsëriti dhe kërkoi përgjigje për atë se çfarë ka ndodhur me disa pika të rendit të ditës si ajo për shujta e punëtorëve të administratës, mandej për subvencionet e fëmijëve, sepse kryesuesja e kuvendit me qëllim po i bishton përgjigjes në këto pyetje kërkoi që këto tema të dihen se si kanë përfunduar. Po ashtu përsëriti se çfarë u votua para kësaj pike, ku krejt tjetër ishte në rendin e ditës e tjetër gjë u votua këtu. Ai kërkoi nga mediat që ta pasqyrojnë drejt këtë seancë të kuvendit se çfarë po ndodh, e po ashtu kërkoi nga MAPL të bëjë një analizë të mirëfilltë dhe të shikoj se si dhe sa po zbatohet rregullorja e punës së kuvendit në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit- sqaroi se lidhur me çështjen kontestuese të votimit, ka kërkuar opinion ligjor nga MAPL, dhe është në pritje të një përgjigje zyrtare se si të veprohet dhe do të veproj sipas udhëzimeve të MAPL-së. Sa i përket çështjes së formimit të komisionit, ceku se në bazë të diskutimeve erdhe në konkluzion se duhet të aprovohet rekomandimi i kryetarit të komunës, për ti marrë nga drejtorja e Financave informacionet e nevojshme, dhe poenta ishte që pika për formimin e komisionit të shtyhet për seancën e radhës.



Mbledhja përfundoi në ora: 12:10.

Bastri Duraku

Procesmbajtës

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Qeveria – Vlada – Government Ministria e Punëve të Brendshme Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police	
	Drejtoria Rajonale e Policisë / Mitrovicë Regionalna Policijska Direkcija / Regional Police Directorate Stacioni Policor Vushtrri Policijska Stanica Vučitern / Police Station Vushtrri	

MEMORANDUM ZYRTAR - SLUZBENI MEMORANDUM - OFFICIAL MEMORANDUM

PËR: ZA: TO:	z.nj Melihate Basholli/Latifi Kryesuese e kuvendit komunal Vushtrri	Data: Datum: Date:	12.02.2024
PËRMES: PREKO: THROUGH	Direkt	Nr. i Referencës: Br. Referencije: Reference No:	05/1-03 VSH-O / 015/ 24
PREJ: OD: FROM:	Toger Shaban Salih Shef i Sektorit të Operativës Stacioni policor Vushtrri		
LËNDA: PREDMET: SUBJECT:	Raporti i sigurisë për vitin-2023		

E nderuar Kryesuese z.nj Basholli/Latifi.

- Gjendja e sigurisë në zonën e përgjegjësisë së Vushtrrisë është e qetë dhe stabile. Gjatë vitit 2023, është shënuar rënie e veprave penale në krahasim me vitin paraprak për 9.1 %, ndërsa numri i rasteve është i njëjtë me vitin paraprak, për shkak se rastet që konsiderohen kundërvajtje, si aksidentet e trafikut, kanë shënuar ngritje. Në përgjithësi është përmbushur objektivi në ndriçimin e rasteve, respektivisht zbulimi i rasteve ka arrit në 69.3%.
- Veprimet tona dhe angazhimi i zyrtarëve Policor është i fokusuar kryesisht në parandalimin e krimit dhe në zbulimin e rasteve, kemi vazhduar me avancimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimin e aktiviteteve me institucione, forumet e sigurisë, organizatat jo qeveritare, po ashtu kemi vazhduar avancimin e bashkëpunimit edhe me qytetar.
- Rastet me motive ndëretnike
Gjatë vitit 2023, në zonën e përgjegjësisë së Vushtrrisë nuk ka pasur të raportuar asnjë rast me motive ndëretnike.
- Siguria e përgjithshme gjatë vitit 2023, sigurisht se ka ndikuar edhe në angazhimin e pjesëtarëve të SP-Vushtrri, të cilët shpesh herë kanë dhënë kontribut në ruajtjen e rendit edhe përtej zonës së Vushtrrisë.

- Gjatë këtij viti njësia e hetimeve pran stacionit policor ka arrit të identifikoj disa grupe të personave të dyshuar të cilët kanë kryer kryesisht vepra penale kundër pasurisë, siç janë: Vjedhjet dhe Vjedhjet e rënda, e po ashtu ka arrit të gjejë dëshmitë (sendet) e vjedhura dhe të ju kthej pronarëve legjitim.
- Siguria në Trafikun rrugor:
Kemi marrë një sërë aktivitete në sensibilizimin dhe vetëdijesimin e qytetarëve (pjesëmarrësve në trafik) për respektimin e rregullave dhe dispozitave që dalin nga ligjit mbi komunikacionin rrugor. Aktivitetet më të rëndësishme janë: Fushatat për vetëdijesim, përmes shpërndarjes së fletushkave për pjesëmarrësit në trafik, Propozimet dërguar Drejtorisë përkatëse në nivel të komunës rreth vendosjes së sinjalizimeve dhe shenjave të trafikut, vendosjes së pengesave etj., si dhe shtimi i prezencës policore në rrugë dhe ndëshkimi i kundërvajtësve në vazhdimësi, sidomos për kundërvajtjet që paraqesin rrezik për pjesëmarrësit në trafik rrugor. Edhe përkundër shtimit të aktiviteteve policore dhe gjobave administrative, që i kemi shtuar për 60 %, numri i aksidenteve të trafikut rrugor është shtuar për 39 % në krahasim me vitin paraprak. Mbetet të punohet edhe më shumë në përmirësimin e gjendjes në trafikun rrugor.
- Veprat penale kundër narkotikëve:
Bazuar në trendin e rritjes së kësaj dukurie negative dhe informacioneve të pranuar, kemi marr aktivitete shtesë në parandalimin e përdorimit dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve, sidomos jemi fokusuar në afërsi të shkollave të mesme, në rrugët “Pandeli Sotiri” dhe “Marin Barleti” tek kafiteritë, si dhe në lokacione të ndryshme, sidomos nëpër qytet. Gjatë vitit 2023, kemi hasur në 60 raste substanca narkotike, në lidhje me këto raste i kemi arrestuar 64 persona të dyshuar, të cilët kanë pasur në posedim substanca narkotike dhe pajisje për përdorimin e tyre, substancat narkotike janë konfiskuar dhe ndaj të dyshuarve janë iniciuar dhe proceduar rastet në konsultim me prokurorin kompetent të shtetit.
- Rastet e dhunës në Familje:
Rastet e dhunës në familje kanë shënuar rënie gjatë vitit 2023, në krahasim me vitin paraprak për 33%. Zyrtarët policor reagues dhe hetuesit e rasteve të dhunës në familje, këto raste i kanë trajtuar me përgjegjësi, profesionalizëm dhe kujdes të shtuar, bazuar në ligjin përkatës, si dhe kanë zbatuar me përpikëri të gjitha detyrat që dalin nga proceduara standarde të operimit, po ashtu kemi mbajtur edhe ligjëratat për dhunën në familje nëpër shumë shkolla, me qëllim të informimit të nxënësve, se çka është dhuna në familje, pasojat e dëmshme të saj dhe mënyrën e raportimit, përveç shkollave, kemi zhvilluar edhe fushata tjera për vetëdijesim në tërë zonën e përgjegjësisë. Konsiderojmë se si rezultat i të gjitha angazhimeve dhe aktiviteteve policore të lartcekura, kemi rënie të rasteve të dhunës në familje.
- Siguria në Shkollë:
Zyrtarët policor në rroba civile por edhe njësitë e rregullta policore janë angazhuar gjatë gjithë vitit në përmbushjen e objektivave të Policisë për ofrimin e një ambienti të sigurt shkollor për nxënës, mësues, prind dhe mysafirë të rastit në të gjitha shkollat e mesme dhe fillore të komunës së Vushtrrisë. Në përgjithësi është arritur qëllimi në këtë drejtim, gjithsej janë raportuar 17 raste të lëndimeve trupore, sulmeve fizike, vjedhjeve etj. Përveç aktiviteteve operative nga Policia e Kosovës përkatësisht nga zyrtarët policor të stacionit policor Vushtrri janë mbajtur edhe ligjëratat nxënësve të shkollave të mesme dhe fillore të komunës së Vushtrrisë.
- Temat e ligjëruara për vetëdijesim dhe ngritjen e përgjegjësisë tek nxënësit, janë si në vijim:
 1. Bullizmi dhe masat parandaluese.
 2. Pasojat e përdorimit të Narkotikëve.
 3. Dhuna në familje.
 4. Masat e sigurisë ndaj keqpërdorimit të Internetit.
 5. Parandalimi i ngacmimeve seksuale dhe masat ligjore ndëshkimore.
 6. Respektimi i shumëllojshmërisë së shoqërisë me qëllim të parandalimit të ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm.
 7. Siguria e qarkullimit të këmbësorëve në trafik.
 8. Ruajtja e ambientit dhe trashëgimisë kulturore.

- Aktivitetet tjera policore në parandalimin e sjelljeve devijuese nga nxënësit (të miturit)
 1. Kontrollimi i nxënësve të shkollave të mesme
 2. Plani Operativ “Siguria në Shkolla”
 3. Si dhe veprime tjera operative
- Objektivat policor për vitin 2024:

Fokusi kryesor i Policisë në përgjithësi mbetet Parandalimi apo reduktimi dhe zbulimi i krimit. Përmirësimi i gjendjes në trafikun rrugor, parandalimi i shpërndarjes /shitjes së substancave narkotike, mbeten ndër sfidat e veçanta të Policisë, respektivisht të stacionit policor në Vushtrri. Siguria në trafikun rrugor dhe parandalimi i shpërndarjes së substancave narkotike kanë qenë dhe mbeten lartë në prioritetet e Policisë.
- Raste të raportuara 2023: **1168**
- Zbulimi i të gjitha rasteve 2023: **69.3 %**
- Zbulimi i veprave penale 2023: **58.1%**
- Urdhëresat e realizuara të gjykatës 2023: **189**
- Gjobat-tiketatat e shqiptuara 2023: **7367**

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

DATË/A:	13.02.2024
PËR/ZA/TO:	KPF dhe Kuvendin e Komunës
PËRMES	Ferit Idrizit, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Abit Abiti, ZKF
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i ZKA-së

Bazuar në Rregulloren e punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit 2019 të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), neni 14, paragrafi 5, „Entiteti i audituar i dorëzon Auditorit të Përgjithshëm dhe Kuvendit/Aksionarit raporte lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve”. Raportet dorëzohen dy herë në vit, respektivisht deri me 30 shtator dhe 15 Mars, mirëpo paraprakisht Raporti i bashkangjitur do të shqyrtohet në KPF dhe Kuvend.

Me respekt!

Të bashkangjitur keni tabelën “Raporti periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga ZKA për Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRISË



Për Zyren Kombëtare të Auditimit

Nga z. Ferit Idrizi, Kryetar I Komunës

**RAPORT PERIODIK PËR ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE**
të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Nr	Çështja	Gjetja	Rekomandimet	Veprimi i menaxhmentit	Zyrtar/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
1	<p>Çështja A1 - Mangësi gjatë ekzaminimit fizik të projekteve</p>	<p>Rregulla financiare Nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, nenet 22 deri 26, ndër të tjera përcaktojnë se paraprakisht duhet të bëhet pranimi i mallrave pastaj duhet të bëhet pagesa</p> <p>Në pesë (5) kontrata kemi evidentuar mangësi në ekzaminimet fizike të datës 08-09.03.2023 mes puneve të realizuara dhe të paguara:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrata “Rregullimi i shterrit të lumit Sitnica në Vushtrri” në vlerë 1,049,680€, kemi evidentuar që në situacionin e tetë të paguar, kishte punë të pa realizuara por të paguara në vlerë 13.650€. Këto punë kishin të bënin për pozicionet e paramasës: IV.10.furnizim, transporti dhe mbjellja e drurit Globosum, IV.1.furnizim, transporti dhe mbjellja e drurit Catalpa dhe III.14. Montimi i ulëseve përgjatë shëtitores. • Kontrata “Ndërtimi i trotuarit në fshatin Stanoc i Epërme Faza II” në vlerë 10,869€, kemi evidentuar që në situacionin e parë të paguar të datës 23.12.2022, kishte punë të pa realizuara por të paguara në vlerë 2,940€ për pozicionin 1.8 Furnizimi dhe vendosja e kubzave me trashësi 7cm (kubëza të përfunduara sasi rreth 150m² dhe jo sipas situacionit 500m²). • Kontrata “Ndërtimi dhe rregullimi i parqeve dhe shesheve në 6 fshatra” vlerë 89,236€, kemi evidentuar që në situacionin e katërt dhe përfundimtar, kishte punë të pa realizuara por të paguara në vlerë 968€. Këto punë kishin të bënin me pozicionet e paramasës: 2.2.9 Rrethoja dhe 3.3.3 Mbjellja 	<p>Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e tyre të mos aprovonjë situacione të punëve të pa përfunduara, si dhe këto mjete të paguara të kthehen në buxhetin e komunës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Punë të pa realizuara por të paguara në vlerë 13,650€ për projektin “Rregullimi i shterrit të lumit Sitnica në Vushtrri” në vlerë 1,049,680€ janë ekzekutuar ashtu siç janë të parapara me kontratë. (Raport i dt. 22.05.2023) • Sasitë e parapara me kontratën “Ndërtimi i trotuarit në fshatin Stanoc i Epërme Faza II” në vlerë 10,869€ janë përmbyshur të gjitha në pajtim me dokumentacionin teknik (Raport i dt. 05.05.2023) • Për punë të pa realizuara por të paguara në vlerë 968€, është urdhëruar OE t'i kthej mjetelet financiare dhe me dt.09.06.2023 i ka kthyer ato. (dëshmi Urdhëresa për deponim) • Furnizimi me aparaturë për kinema për funksionalizimin në qendrën e kulturës” vlerë 46,757€ është montuar në vendin siç është përcaktuar dhe funksionalizuar. • Instalimi i paisjes Chiles në vlerë 20,250€ është instaluar (montuar), pasiqë janë plotësuar kuyshtert të cilat kanë qenë pengësë për instalim. 	<p>Infrastruktura Publike Shërbimet kulturore</p>	<p>E zbatuar</p>

	<p>e drurit 3. Uiset (Novolan) dhe 2.2.12 Rrethoja (Smerkonice).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrata "Furnizimi me aparaturë për kinema për funksionalizimin në qendrën e kulturës" vlerë 46,757€, të gjitha aparaturat janë furnizuar sipas kontratës me datë 21.12.2022, mirëpo nuk janë të funksionalizuara ende. Kjo për shkak të menaxhimit të dobët të Qendrës së Kulturës rreth përcaktimit të vendit të vendosjes së pajisjeve. • Kontrata "Renovimi i Palestrës Jeton Terstena" Ritender e vitit 2022 në vlerë 114,900€, kemi evidentuar që në situacionin e parë të paguar të datës 22.12.2022, pozicioni I.1 – Furnizimi dhe instalimi i paisjes Chiles në vlerë 20,250€ nuk ishte instaluar (montuar). Kjo për shkak të kushteve atmosferike si dhe nevojës së montimit të dy pajisjeve të tilla në të njëjtën kohë. <p>Kjo situatë ka ndodhur për shkak të neglizhencës dhe pakujdesisë nga ana e menaxherëve të kontratave dhe mbikëqyrëseve të tyre.</p>				
<p>2</p> <p>Çështja B1 - Përzgjedhja e Operatorit Ekonomik të papërgjegjshëm</p>	<p>Bazuar në Ligjin për Prokurim Publik neni 59.4, përcakton se autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Sipas dosjes së tenderit për Ndërtimin e rrugëve lokale në tetë (8) fshatra (LOT 1), tek pjesa Kapaciteti teknik dhe profesional, kërkohet që Operatori Ekonomik (OE) duhet të ketë Gurëthyes të licencuar në pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavorr, kurse për dëshmi në rastin kur OE nuk ka licencë valide nga Agjencia për Miniera dhe Minerale, ajo duhet të ofroj marrëveshje për furnizim me OE të licencuar.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë kontrollin në procesin e vlerësimit të ofertave, në mënyrë që përzgjedhja e fituesve të bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.</p>	<p><i>Në të ardhmen gjat procesit të vlerësimit do të kushtojmë vëmendje ne menyre qe te mos perseriten lëshime te tilla:</i></p> <p><i>Do të i referohemi :</i></p> <p>LIGJ PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS</p> <p>nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së në bazë të UDHEZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK neni 10 pika 10.1</p>	<p>Prokurimi</p>	<p>Shkurt 2023</p>

	<p>OE fitues, për tenderin e sipërmendur, nuk ka plotësuar kriteret e dosjes së tenderit, pasi që ka bashkangjitur marrëveshjen me një Gurëthyes, e cila e kishte afatin e skadimit deri me datën 11.10.2022, po ashtu, ky gurëthyes kishte licencë operimi vetëm deri me datën 11.10.2022. Me tujte raporti final i vlerësimit është nënshkruar nga prokurimi me datë 12.10.2022. Kontrata për këto punë është nënshkruar me datë 24.10.2022 në vlerë prej 147,859€, dhe afati i kryerjes së punëve është 50 ditë. Rrjedhimisht OE fituese nuk ka pasur marrëveshje valide për periudhën e implementimit të projektit.</p> <p>Kjo ka ndodh si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin e vlerësimit të tenderëve konform kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.</p> <p>Ndikimi Përzgjedhja e OE fitues që nuk përbush kriteret e përcaktuara me njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, rezulton me shpërdlimin e OE në kundërshtim me kërkesat ligjore. Kjo mund të rrezikojë implementimin dhe mos arritjen e objektivave të parapara në projektin.</p>				
<p>3</p> <p>B2 - Mungesa e projektit ekzekutues</p>	<p>Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik neni 20.10, përcakton që specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten. Ndërsa pika 13 “ Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit”. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikojnë në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.</p>	<p>Lidhur me rekomandimet e auditorit për mungesën e projekteve gjatë inicimit të aktivitetëve të prokurimit ju njoftoj se DUMM gjatë vitit 2023 ka lidhur kontratë për Hartimin e Projekteve në 3 lloje: 1 Hartimi i projekteve të infrastrukturës</p>	<p>Zyra e Kryetarit Mesjia kerkuese Menaxheret e Projekteve Prokurimi</p>	<p>E zbatuar</p>

	<p>Kemi identifikuar se në katër (4) mostra të testuara për kontrata pune të vitit 2022, komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe paralogarinë. Mungesa e projekteve ekzekutuese kryesisht ishte të: "Ndërtimi i shëtorës dhe shtegut për biçikleta Vushtri-Nadakof", "Ndërtimi i rrugëve lokale ne 8 fshatra (LOT 1)", "Ndërtimi i kanalizimeve dhe infrastruktura përçjellëse" dhe "Renovimi i Palestres "Jeton Terstena".</p> <p>Kjo ka ndodh pasi që komuna nuk ka kapacitete të mjaftueshme për hartimin e projekteve. Në lidhje me këtë, komuna ka planifikuar dhe inicuar kontraktimin e ndonjë OE, megjithatë për shkak të ankesave të njëpasnjëshme nga OE në aktivitetin e prokurimit për hartim të projekteve, nuk ka arritur të kontraktojë këtë shërbim.</p>		<p>2 Hartimi I projekteve të ndërtesave si dhe 3 Hartimi I projekteve urbane</p>		
<p>4</p> <p>B3-Mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit konform periudhës së zbatimit të kontratës</p>	<p>Regullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, neni 30 përcakton: "Siguria e ekzekutimit është paraparë të mbështetë përmbushjen e kontratës. Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës. Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës". Po të njëjtin obligim ligjor komuna e kishte përfshirë edhe te kushtet e vecanta të kontratave.</p> <p>Në gjashtë mostra të identifikuarat të vonesave në kryerjen e punimeve dhe të cilat kanë pranim teknik, zyrtarët përgjegjës, përkatësisht zyra e prokurimit nuk kishte kërkuar vazhdimin e sigurimit të ekzekutimit të kontratës, përkundër që siguria e ekzekutimit kishte skaduar akoma pa përfundu projektin.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që në të ardhmen përmes zyrtarëve përgjegjës, sigurimet e ekzekutimit për projektet e përfunduara duhet të kenë vlefshmëri në raport me periudhën e përmbushjes së kontratës ashtu siç parashihet me Regullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik.</p>	<p>Gjate implementimit të kontratave do të aplikojmë kontrolle të shtuara me bashkëpunim me menaxherin e kontratave, ne mënyrë që mos të vijë deri te skadimi i validitetit të sigurimit të ekzekutimit.</p> <p>Zyra e prokurimit në zbatim të Nenet 30 të Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, do të siguroj minimum 10 % (dhjetë për qind) e vlerës së përgjithshme të kontratës dhe do të sigurohet që sigurimi i kontratës të jetë aktiv deri me përfundimin e kontrates</p>	<p>Menaxheret e projekteve Prokurimi</p>	<p>Pjesërisht</p>

	<p>Një situatë e tillë kishte ndodhë si pasojë që zyra e prokurimit si dhe menaxherët e kontratave kishin neglizhuar rëndësinë e sigurisë së ekzekutimit.</p> <p>Ndikimi Mungesa e sigurisë së ekzekutimit përveç që është anashkallim ligjor, rrit rrezikun që autoriteti kontraktues të mos ketë mbulesë për dëmet dhe shpenzimet eventuale të mundshme që mund të rrjedhin gjatë periudhës së shtyrë për implementimin e këtyre kontratave.</p>				
<p>5</p> <p>B4-Faturimet jo në pajtueshmëri me marrëveshjen</p>	<p>Në bazë të marrëveshjeve numër 542/21, nr. 625-1/22 dhe nr. 1451/22 për kryerjen e shërbimeve komunale në komunën e Vushtrrisë, vlera e shërbimeve mujore për mirëmbajtjen - pastrimin e objekteve dhe për sigurimin fizik të objekteve të institucioneve publike të komunës ishte përcaktuar në vlerë 45.850€.</p> <p>Në bazë të katër mostrave të audituara dhe raporteve mujore të komisionit të mbikëqyrjes së realizimit të shërbimeve siç janë sigurimi, pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës, shkollave, QMF dhe QPS për muajt janar, gusht, nëntor dhe dhjetor 2022, komuna ka pranuar faturat mujore nga N.P.L. "Përparimi" Sh.A për të cilat vlerat dhe specifikat e faturave nuk janë të përcaktuara qartë sipas marrëveshjes. Kjo ka rezultuar si pasojë e mungesës së monitorimit të mirëfilltë nga zyra e financave dhe të komisionit mbikëqyrës për përcjelljen e shërbimeve të kryera.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që komuna të pranoi faturat sipas specifikave të përcaktuara në marrëveshje dhe vlerat e faturës të jenë në pajtim me marrëveshjen për pagesat e caktuara mujore.</p>	<p>Drejtorija për Buxhet dhe Financa i ekzekuton pagesat në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara.</p> <p>Në zbatim të rekomandimit do t'i rishikojmë marrëveshjet me "Përparimin" duke i përcaktuar vlerat qartë me marrëveshje</p>	<p>Buxhet dhe Financa Administrata dhe Personeli Arsimi dhe Shkencë Shëndetësia dhe mirëqenia sociale</p>	<p>E pazbatuar</p>
<p>6</p> <p>B5 - Mangësi në regjistrin kontabël të pasurive</p>	<p>Sipas nenit 11.3 të Rregullores Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, pas përfundimit të procesit të investimit, pasuria kapitale do të klasifikohet si pasur në përdorim dhe të zbatohet zhvlerësimi. Po ashtu, neni 6.3 i rregullores përcakton se pasuria kapitale duhet të regjistrohet në</p>	<p>Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive kapitale konform gjetjeve të auditimit të trajtuara me lartë për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale.</p>	<p>Pagesa në vlerë prej 34,532€ është regjistruar në SIMFK.</p> <p>Zyrtari i depos është në proces rekrutimi, ky zyrtar do të kontribuoj që të kemi regjistra të saktë.</p>	<p>Buxhet dhe Financa</p>	<p>E pazbatuar</p>

	<p>SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stogët duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria. Kemi evidentuar 12 pagesa të kapitaleve me vlerë të përbashkët 179,691€, të cilat ishin regjistruar në SIMFK si investim në vijim përderisa është dashur të regjistrohen si pasuri në përdorim. Këto projekte kishin përfunduar dhe ishin bërë pranimet teknike. Një pagesë në vlerë 34,532€ vendim gjyqësore për projektin Ndërtimi i depos për ruajtjen e patates - Pestovë, nuk është regjistruar si pasuri në SIMFK.</p> <p>Nga testimi i pasurive nën 1,000€ kemi evidentuar 13 blerje, me vlerë 150,727€, të cilat nuk ishin të regjistruara në sistemin e-pasuria. Rrjedhimisht kjo kategori e pasurisë është e nënvlerësuar për këtë vlerë. Regjistrimet e gabuara kryesisht ishin për shkak të vullmit të madh të punëve në fund vit dhe pakujdesisë së zyrtarit të pasurive. Kurse për mos regjistrimin e blerjeve në sistemin e-pasurisë ka të bëjë me mungesën e depozitit të komunës.</p>		<p>Zyrtarja e pasurisë këtë vit e ka për objektive shqyrtimin e kategorisë Investime në vijim. Ka bërë shkresa në MFPT dhe ka artur që disa prej tyre nga Investim në vijim t'i kaloj në pasuri përdorim.</p>			
7	<p>A2 - Thirrjet publike në bujqësi jo në pajtim me rregulloren e brendshme për subvencionim</p>	<p>Sipas nenit 25 të Rregullores së brendshme të komunës nr. 03/2020 për përkrashjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat, dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione dhe grante për fermerë të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen të subvencioneve dhe granteve në lëmin e bujqësisë, për personat fizikë përfshijnë, duke mos u kufizuar janë: projektin ideor, fletë posedimin për patundshmëri, dëshmi për pagesën e taksave komunale, dëshmi mbi pagesën e tatimit ne pronë, deklaratë se nuk është përfritues i një granti të ndarë nga pushteti qendror apo lokal në këtë fushë brenda vitit fiskal.</p> <p>Ne kemi identifikuar se dokumentet e kërkuara në tri (3) thirrjet publike për subvencionimin e fermerëve në bujqësi</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme për forcimin e kontrollit të brendshme në mënyrë që dokumentet e nevojshme për subvencionimin e fermerëve të jenë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e përcaktuara me rregulloren e brendshme të komunës për subvencione.</p>	<p>Do të iniciohet draftimi i Rregullores së re për përkrashje të fermerve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat, rregullore e cila do t'i adresoj rekomandime e Zyrës Komëtare të Auditimit.</p>	<p>Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural</p>	<p>Pjesërisht e zbatuar</p>

	<p>(Subvencionimi i mbarshtrësve të deleve dhe dhive vlera e përkrahjes 41,292 , “Subvencionimi i bletëve” vlera e përkrahjes 40,240 , dhe “Subvencionimi i mbarshtrësve të bullicave” vlera e përkrahjes 870), nuk ishin në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e përcaktuara me rregulloren e brendshme të komunës për subvencionimin e fermerëve në bujqësi. Në të trija thirrjet mungonin kërkesat e përcaktuara me rregullore si në vijim: Projekti ideor, dëshmia për pagesën e tatimit në pronë, fletëposedimin për patundshmëri dhe deklaratë se nuk është përfutur një granti të ndarë nga pushteti qendror apo lokal në këtë fushë brenda vitit fiskal.</p> <p>Mos funksionimi i mirëfillte i kontrolleve të brendshëm gjatë përgatitjeve të thirrjeve publike, ka ndikuar që dëshmitë e kërkuara të mos jenë në pajtueshmëri të plotë me rregulloren e brendshme të komunës.</p>					
8	<p>B6 - Mangësi në raportin dhe monitorimin e projekteve të subvencionuara</p>	<p>Rregullorja 04/2017-mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 24, pika 2, përcakton se “Ofruesit e mbështetjes financiare kanë për detyrë të bëjnë monitorimin e rregullit dhe të drejtpërdrejtë të mbështetjes financiare publike për OJQ-të, me qëllim që ajo të jetë në linjë me kërkesat e Rregullores, dhe të arrijë qëllimin për të cilin është ofruar mbështetja financiare publike”.</p> <p>Në projektet për përkrahje financiare për klubin e futbollit Vushtrria në vlerë 50,000€, dhe klubin e hendbollit Samadrexha në vlerë 5,000€ të aprovuar me vendime të Kuvendit Komunal, komuna nuk kishte përcaktuar monitorimin e rregullit dhe të drejtpërdrejtë të mbështetjes financiare publike. Si pasojë e kësaj përfutjesit nuk kishin dorëzuar raporte financiare dhe narrative për</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që zyrta të përgjegjës për montorim dhe zbatim të projekteve të subvencionuara, zbaton të gjitha procedurat e kontrollit, për raportimin e tyre që të arrijnë të arsyetojnë shpenzimet sipas memorandumit, dhe monitorimeve apo raportimeve sipas kërkesës së rregullores përkatëse.</p>	<p>Klubi Samadrexha e ka dorëzuar raportin narrativ dhe financiar me dt: 23.03.2023</p> <p>Nga mjetet për përkrahje financiare të ndara nga Kuvendi Komunal, F.C. “ Vushtrria”, 40,000€ janë marrë nga ATK për shkak mospermbyshjes së obligimeve, kurse për mjetet e mbetura klubi do të raportoj.</p>	<p>Kultura, rinia dhe sportet</p>	<p>E pazbatuar</p>

	<p>arsyetimin e mjeteve të fituara për qëllimin e dedikuara.</p> <p>Klubi i Futbollit Vushtrria, si përfutues në vitin 2021, nuk kishte dorëzuar raportin financiar dhe narrativ në fund të vitit, kurse prap Kuvendi Komunal për vitin 2022 kishte ndarë mjete për mbështetje financiare në shumë prej 50,000€</p> <p>Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së llogaridhënies për monitorimin e dhur të projekteve të subvencionuara dhe neglizhencës zyrtarëve përgjegjës të komunës.</p>			
<p>9</p> <p>B7 - Mos përgatitja e planit vjetor për mbështetje financiare të OIQ-ve</p>	<p>Rregullorja 04/2017-mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OIQ-ve, neni 6, ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OIQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës.</p> <p>Komuna edhe pse me Buxhet kishte paraparë që gjatë vitit 2022 të ofrojë mbështetje financiare për projektet dhe programet e OIQ-ve, megjithatë, as këtë vit nuk kishte përmbyshur kërkesën ligjore për përgatitjen e planit vjetor për mbështetje financiare të OIQ-ve.</p> <p>Mos marrja e masave të nevojshme për rritjen e llogaridhënies për menaxhimin e mirëfilltë të subvencioneve, ishte shkak për mos përgatitjen e planit vjetor për mbështetje financiare të OIQ-ve.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se personat përgjegjës përgatitjen Planin Vjetor për Mbështetje Financiare për Organizatat Jogeritoriale (OIQ) dhe të sigurojë se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e percaktuara me rregullore për Mbështetje Financiare.</p>	<p>Edhe pse Planin Vjetor për Mbështetje Financiare për Organizatat Jogeritoriale në mënyrë parciale e kemi dërguar në zyrën përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Vitin vijues deri në më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës do t'a dërgojmë si plan përmbledhës të Komunës së Vushtrisë.</p>	<p>Zyra e Kryetarit Kulturës, rinia dhe sportet Shëndetësia dhe mirëqenia sociale</p>
<p>10</p> <p>B8 - Vonesa në pagesën e faturave</p>	<p>Sipas nenit 39 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, kërkohet që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e realizuara të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Nga testimi i mostrave dhe sipas listës së detyrimeve në fund vitit që ka komuna, kemi identifikuar se vonesat në pagesën e faturave e tejkalojnë kohën e paraparë me</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve si dhe iniciimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjeteve janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të vonesave për pagesat e faturave apo të shmanjësisë së padive eventuale nga operatorët ekonomik. Po ashtu, të forcojë që të gjitha obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh.</p>	<p>Drejtorija për Buxhet dhe Financa, faturat e pranura i përcjell te njësit kërkuese. Njësit kërkuese do të kujdesen që para se t'i pranojnë faturat t'i kenë të zotuarra mjeteve dhe planin e shpenzimeve ta përshtasin me obligimet e marra.</p>	<p>Buxhet dhe Financa</p> <p>E pazbatuar</p>

	<p>ligjin aktual. Gjithsej vlera e faturave e prezantuar në PVF të cilat nuk janë paguar brenda 30 ditëve është 93,929.</p> <p>Shkaku i mos pagesave me kohë janë kontrollet e dobëta në menaxhimin e borxheve dhe menaxhimin e buxhetit.</p>	<p>Kryetari duhet të thellojë bashkëpunimin me Ministrinë e Financave, për të siguruar që mjetet për kryerjen e obligimeve që kanë mbetur nga marrëveshja kolektive (para aprovimit të Ligjit të pagave) apo obligimeve tjera, të buxhetohen dhe të paguhen me kohë dhe nga kategoritë përkatëse, për të shmangur keqklasifikimin dhe shpenzimet e panevojshme.</p>	<p>Komuna e Vushtrrisë do t'i shtoj përplekjet me qëllim që faturat e pranuar të paguhen brenda afatit kohor. Dhe në bashkëpunim me Zyrën ligjore do të kujdesemi që pagesat të kryhen para se të marrin formën e urdhërit të prerë.</p>	<p>Buxhet dhe Financa Arsimi dhe shkenca Zyra e Kryetarit (Zyra ligjore)</p>	<p>Edhe kete vit kemi pasur ekzekutim te vendimeve gjyqësore</p>
<p>11</p> <p>A3 - Shpenzime të larta procedurale të pagesave të ekzekutuar sipas vendimeve gjyqësore</p>	<p>Neni 39 i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi ka përcaktuar se çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim të mallrave dhe shërbimeve të furnizuara ose punëve të realizuara duhet të paguhet brenda 30 ditëve kalendrike pas pranimit të faturës ose kërkesës së vlefshme për pagesë. Po ashtu Ligji Nr. 08/L-066 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 dhe plani kontabël definojnë qartë se shpenzimet duhet të ndodhin nga kategoritë adekuate ekonomike.</p> <p>Ne kemi identifikuar se Thesari kishte ekzekutuar në bazë të vendimeve gjyqësore pagesa në vlerë prej 198,779 . Nga kjo vlerë, pagesa për borxhin kryesor ishin 146,425 , kurse shpenzime procedurale të gjykatës/përmbartimit ishin 52,354 .</p> <p>Pagesat janë bërë nga këto kategori:</p> <ul style="list-style-type: none"> Nga kategoria e pagave 103,656 që kishin të bëjnë me detyrimet e dala nga marrëveshja kolektive për kompensimin e tri pagave jubiliare dhe tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve dhe shujtave. Nga kategoria e subvencioneve 41,977€, për pagesë të një furnitori; Nga kategoria e investimeve kapitale 34,533€, për pagesë të një furnitori; Nga kategoria për mallra dhe shërbimeve 18,613€, për pagesë të furnitorëve. <p>Arsyet e ekzekutimit të pagesave të tilla vijnë si rezultat i planifikimit të dobët dhe mungesës së buxhetit nga Drejtoria e Arsimit për vendimet gjyqësore që ndërliken me</p>				

12	C1 - Mangësi në menaxhimin e të dhënave nga tatimi në pronë	<p>ministrat e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë, ka njoftuar komunitat për vendimin e marrë për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, me qëllim të shmangies së dyfishimeve/ apo parregullive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni.</p> <p>Ne kemi analizuar bazën e tatimit pronë të vitit 2022, dhe kemi nxjerr një listë prej 3,775 tatimpaguesve, të cilat në shënimet e bazës ProTax kanë numrin e letërnjoftimit gabim (zbrazet ose shifra tjera të gabuara). Po ashtu, nga këta tatimpagues, 135 prej tyre, nuk e kanë të përcaktuar kategorinë e vlerësimit të pronës.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të kontroleve jo të duhura në këtë fushë lidhur me përditësimin e informacionit të tatimpaguesve në sistem.</p>	Kryetari duhet të sigurojë kontrollin shtesë në departamentin e tatimit në pronë, në mënyrë që numrat e letërnjoftimit të përmirësohen në sistemin ProTax.	Zyra e tatimit në pronë vitin 2022 i ka bërë tri fresa dhe një në muajin Prill 2023 për qyetarët, që t'i sjellin shënimet me qëllim të regjistruar – përmirësohen shënimet në sistemin ProTax. Lista e nxjerrë nga ProTax është kontrolluar në zyrën e ofiqrsisë, të njëjtën qashtë e kemi ngritur edhe gjatë degjimeve buxhetore dhe në raste tjera. Ndërsa shifra tjera të gabuara hyjnë numrat e tatimpagueseve me shtetësi të huaj. <p>E fundit është se me date 22.09.2023, lista e dërguar nga DTP për banime Primare është kontrolluar dhe përfunduar. Te qështja e përcaktimit të kategorisë së vlerësimit të pronës është qështje do të kërkojmë sqarime.</p>	Buxhet dhe Financa (Tatimi në Pronë)	Pjesërisht i zbatuar
13	B9 - Mangësi në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për subvencion	<p>Rregulloria 04/2017-mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 4, përcakton se duhet të bëhet trajtimi i barabartë dhe mos diskriminimi i aplikuesve si dhe gjithë përfshirja gjinore e përfutuesve.</p> <p>Sipas thirrjes për aplikim për "Motokultivator me Freza" aplikuesit duhet t'i plotësojnë kushtet për kryerjen e obligimeve komunale dhe dëshmi mbi përgatitjen profesionale.</p> <p>Sipas thirrjes të projektit subvencionimi i mbarështuesve të buallicave, dokumentacioni i nevojshëm për aplikuesit</p>	Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme që procesi i vlerësimit për subvencione të jetë në pajtueshmëri të plotë me kriteret e përcaktuara në thirrje publike për subvencione.	Menaxhmenti do të kërkojë nga komisionet që në të ardhmen lëshimet të tilla të mos përsëriten dhe do të kërkojë rrijën e përgjegjësisë nga komisionet përkatëse gjatë vlersimeve të aplikacioneve duke respektuar përparësitë e dispozitave ligjore në fuqi.	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	Gjatë vitit 2023 nuk kemi pasur subvencionime të kësaj natyre.

	<p>ishte kopja e listës së verifikimit të kafshëve të lëshuar nga sektori për identifikim dhe regjistrin në kuadër të Agjencës së Ushqimit dhe Veterinarisë dhe vendimin për numrin e buallcave të aprovuara për pagesë nga ana e Agjencionit të Zhvillimit të Bujqsisë.</p> <p>Ne kemi identifikuar mangësi në dy raste gjatë procesit të përzgjedhjes së përfutësve për subvencionim si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> Subvencionimin me motokultivator me freza, në pagesën e testuar në shumë 23,000€, dy përfutës nuk kishin plotësuar kriteret e përcaktuara në thirrje për aplikim. Në aplikacionet e tyre mungonin dëshmitë e përgatitjes profesionale dhe kryerjen e obligimeve të tatimit në pronë; Subvencionimin e mbarështuesve me buallica në pagesën në vlerë 870 , një përfutës nuk kishte plotësuar kriteret e përcaktuara në thirrje të projektit. Në dosje i mungonin dëshmitë e listës së verifikimit të kafshëve të lehura nga sektori për identifikimin dhe regjistrin në kuadër të AUV dhe vendimi për numrin e buallcave të aprovuara për pagesë nga ana e AZHB-së. Kjo ka ndodh si rezultat i mungesës së kontrolleve adekuate nga zyrtarët përgjegjës gjatë vlerësimit të aplikuesve. 		<p>Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ridentifinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa e regjistrimit i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe saktë sipas kodeve ekonomike adekuate.</p>	<p>Gjatë vitit 2023 do të kujdesemi që planifikimi i shpenzimeve dhe realizimi i tyre do të ekzekutohen nga kategoritë adekuate.</p>	<p>Buxhet dhe Financa</p>	<p>Pjesërisht e zbatuar.</p>
<p>14</p>	<p>B10 - Kecklasifikimi i shpenzimeve</p>	<p>Ligji Nr. 08/L-066 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, si dhe plani kontabël definon që të shpenzimet duhet të ndodhin nga kategoritë adekuate ekonomike. Gjithashtu Udhëzimi Administrativ Nr. 2005/08 për Klasifikimin ekonomik të shpenzimeve përsëkruan qartë definicionet e kategorive ekonomike që i përdor Thesari për të regjistruar dhe raportuar shpenzimet e qeverisë. Në dy mostrat e testuara nga kategoria e investimeve kapitale në vlerë 16,395 , kemi</p>				

	<p>identifikuar se janë keqklasifikuar shpenzimet për këtë kategori. Nga këto, një rast në vlerë 14,090 ishte furnizime mjekësore kurse një rast në vlerë 2,305 ishte furnizime me inventar për komunën. Këto të gjitha ju përkasin kategorisë së mallrave dhe shërbime.</p> <p>Në tri mostrat tjera të testuara nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vlerë 27,498€, kemi identifikuar keq klasifikime të shpenzimeve. Nga këto, një rast në vlerë 13,938€ ishte vendim gjyqësor për projektin e ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit që i takon kategorisë së kapitalave, një rast në vlerë 11,874€ ishte furnizim me kompjuter për një kabinet të cilat ju takojnë kategorisë së kapitalave si dhe një rast në vlerë 1,636€ ishte vendim gjyqësor për shujtë e që i takon kategorisë së pagave.</p> <p>Keqklasifikimi ka ndodh për shkak të planifikimit jo adekuat të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike.</p>					
15	<p>B11 - Vonesa në realizimin e kontratave</p>	<p>Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ të Prokurimit Publik, pikat 61.6, 61.19 dhe 61.20 përcaktojnë se: "Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se Operatorët Ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.</p> <p>Nga pagesat e testuara tek investimet kapitale, bazuar në pranimet teknike të tyre kemi evidentuar vonesa deri në një vit e gjysmë në realizimin e shtatë (7) kontratave, të cilat është dashur të përfundonin në vitin 2021/2022. Vonesat kanë të bëjnë me këto projekte:</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që mos të fillohen projektet pa u siguruar gëshjtjet pronësore, hartimit të specifikave adekuate të projekteve përmes projekteve ekzekutive dhe se menaxherët e kontratave për çdo raport të punëve të sgarojnë arsyet e vonesave. Po ashtu, për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen penalet e parapara me kontratë.</p>	<p>Vonesat janë si shkak i kushteve atmosferike, problemeve të ndryshme në terren si dhe në raste të caktuara probleme pronësore, ose edhe si pasojë e mungesës së projektit kryesor dhe mangësi në paramasa, andaj me hartimin e projekteve do të mundohemi që projekti të jete sa më i sakt dhe si zbatueshëm me qellim që të mos shkaktohen vonesa.</p>	<p>Menaxhimi I katastrofave natyrore Infrastruktura Publike Planifikimi Urban dhe Mjedis</p>	E pazbatuar

	<ul style="list-style-type: none"> • Pastirimi i kanaleve kullëse në fshatrat Lum Madh dhe Dumnicë e Postirne në vlerë 18,632€, i datës 25.11.2021; • Ndërtimi dhe rregullimi i parqeve dhe sheshëve në gjashtë fshatra Lot 2, në vlerë 89,235€, i datës 10.09.2021; • Rehabilitimi i zhveshtores në terrenin në fushën e sportit në fshatin Dobërlukë në vlerë 29,842€, i datës 16.08.2021; • Rregullimi i sheshit "Adem Jashari" në Vushtri në vlerë 366,079€, i datës 24.07.2020; • Ndërtimi i trotuareve në gjashtë rrugë Lot 1, në vlerë 45,200€, i datës 15.09.2022; • Asfaltimi i rrugëve lokale në qytet në vlerë 581,357€, i datës 15.07.2019; • Rregullimi i hapësirave publike - Një ecje në histori në vlerë 139,929€, i datës 10.06.2021. <p>Duhet theksuar se në asnjërin prej këtyre rasteve nuk kishte kërkesë/aprovim për zgjatjen e afatit për realizimin e kontratave, siç përcaktohet në nenin 18 të dosjes standarde të tenderit. Po ashtu, nuk kishte aplikim të penaleve.</p> <p>Shkaqet e vonesave kryesisht ishin për shkak të menaxhimit jo adekuat të komunës lidhur me problemet pronësore, specifkave të punëve, mungesa e projektit ekzekutiv për disa projekte, kushteve atmosferike, si dhe për shkak të ngritjes së çmimeve/inflacionit. Ndërsa, mos formalizimi i vonesave ishte për shkak të neglizhencës së menaxherëve të kontratave lidhur me kërkesat ligjore.</p>	Kryetari duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e	Komuna e Vushtrrisë gatë vitit 2023 do t'i përkushtohet këtij procesi dhe do t'i azhurnoj regjistrat e pasurisë.	Buxhet dhe Financa	E pazbatuar
16	<p>B12 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të</p>	Rregulloja 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 19.4.3 përcakton se çdo fundvit duhet të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistruar të pasurive jo			

	<p>pasurive jo financiare</p> <p>financiare. Ndërsa neni 21 i po kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare. Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëpo nuk është bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare ashtu siç kërkohet me nenin 19.4.3 të Rregullores 02/2013. Po ashtu nuk ishte bërë vlerësimi i pasurive jo financiare. Magësitë në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive, kryesisht ishin për shkak të neglizhencës së zbatimit të procedurave për menaxhimin e pasurive jo financiare.</p>	<p>pasurive jo financiare në organizatat buxhetore.</p>	<p>Komisionet për procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive d'i zbatojnë kërkesat e Rregullorja 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare dhe do të punojnë që t'a kenin një regjistrë të pasurisë sa më të sakt.</p>		
<p>17</p> <p>B13 - Shpalosje jo e saktë e vlerës së llogarive të arkëtueshme në pasqyrat financiare</p>	<p>Sipas rregullores 01/2017 neni 16 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, OB-të që mbledhin të hyra janë të detyruara që të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara dhe të pa arkëtuara. Bazuar në analizat e bazave të shënimeve mbi të arkëtueshmet e paraqitura në pasqyrat financiare të komunës së Vushtrisë, kemi identifikuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • saldot e llogarive të arkëtueshme për shfrytëzimin e pronës publike janë mbivlerësuar për 42,562€; dhe • saldot e llogarive të arkëtueshme për lejet ndërtimore janë nënvlerësuar për 35,659€. <p>Mbivlerësimi i LLA tek shfrytëzimi i pronës publike ka ndodhur pasi që zyrtarët përgjegjës kanë ngarkuar gabimisht bazën me kontratat afatgjate të ardhshme të qerave. Kurse nënvlerësimi i lejeve ndërtimore ka ndodhur për shkak të neglizhencës së zyrtarit përgjegjës për ta paraqitur borxhin.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidencën të saktë për llogaritë e Arkëtueshme në mënyrë që prezantimi i tyre në Pasqyra Financiare Vjetore të jetë i saktë dhe i drejtë.</p>	<p>Me ratën e hartimit të pasqyrave Financiare Vjetore do të kujdesemi që saldo e llogarive vjetore të jetë e saktë. Në drejtorinë e Kadastrit do të plotësohet sektori për menaxhimin e pronave me staf të mjaftueshëm i cili do të menaxhoj me pronat publike.</p>	<p>Buxhet dhe Financa</p> <p>Kadastri dhe Gjeodezia</p> <p>Planifikimi Urban dhe Mjedisi</p>	<p>E zbatuar pjesërisht.</p>
<p>18</p> <p>B14 - Dobësi në menaxhimin e</p>	<p>Sipas Rregullores së MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16, citon që OB që mbledhin</p>	<p>Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i</p>	<p>Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të</p>	<p>Buxhet dhe Financa</p>	<p>E pazbatuar</p>

<p>llogarive të arkëtueshme</p>	<p>të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara.</p> <p>Rritja e të arkëtueshmeve ndaj komunës, në fund të vitit 2022 ishte 811,879 € ose 16% më tepër se në vitin 2021.</p> <p>Sfida kryesore mbetet në inkasimin e tatimit në pronë, e cila është rritur për 13% në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 dhe të hyrat në inkasimin e mbeturinave, borxhet e të cilave janë rritur prej 25 % në vitin 2022, krahasuar me vitin paraprak. Vlen të theksohet se në shumicën e mostrave të audituara në tatimin pronë (24) dhe nga taksat e mbeturinat (10) ka vonesa të konsiderueshme në arkëtimin e mjeteve.</p> <p>Përkundër rekomandimit nga vitit i kaluar, komuna nuk ka ndërmarrë veprime konkrete apo të krijoj mekanizma përkatës për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.</p>	<p>programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit, regjistrimit dhe arkëtimit të tyre, do të ishin disa nga masat që mund të sjellin përmirësime.</p>	<p>arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit, regjistrimit dhe arkëtimit të tyre, do të ishin disa nga masat që mund të sjellin përmirësime.</p>	<p>Infrastruktura Publike</p>	
<p>19</p> <p>A4 - Mungesë e dëshmiave për llogaritë e arkëtueshme në taksën në biznes</p>	<p>Sipas Rregullores së MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16, citon që OB që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara.</p> <p>Vlera e llogarive të arkëtueshme për taksën në biznes sipas PVF 2022 është 471,823€. Pjesa dërmuese e këtyre borxheve janë të vjetra mbi dhjetë vite dhe si të tilla këto borxhe nuk pritet të arkëtohen, pasi që kanë kaluar shumë vite nga pezullimi i tyre.</p> <p>Nga gjashtë mostrat e përzgjedhura për auditim për llogaritë e arkëtueshme në taksat në biznes, në katër prej tyre në vlerë 10,118€ kemi hasur mungesë të dëshmiave lidhur me faturnimin që dëshmon vlerën e saktë të tyre.</p> <p>Kjo ka ndodhur si pasojë e mos funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme në</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës ruajnë gjithë dokumentacionin e nevojshëm për llogaritë e arkëtueshme të taksës në biznes dhe të siguroj funksionalizimin e sistemit të menaxhimit të taksës në biznes. Po ashtu duhet të merren të gjitha masat ligjore për trajtimin e borxheve në taksat në biznes.</p>	<p>Komuna e Vushtrrisë do t'i analizoje regjistrat e taksës në biznes, do t'i shqyrtojë mundësit për inkasimin e borxheve. Nëse nuk ekzistojnë mundësit për inkasim atëherë do t'a shqyrtojë edhe mundësin për falje, nëse nuk kemi pengesa ligjore.</p>	<p>Buxhet dhe Financa</p>	<p>E pazbatuar.</p>

		lidhje me ruajtjen e dokumentacionit për borxhet në taksat në biznes.				
20	A5 - Mbiqverësimi i obligimeve të papaguara në pasqyrat financiare	Rregullorja MF 01/2017 për Raportim Financiar Vjetor nga Organizatat Buxhetore, Neni 17 pika 3 thotë: Organizatat Buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues. Nga mostrat e testura të obligimeve të papaguara të vitit 2022 të paraqitura në pasqyrat financiare kemi hasur në mbiqverësimin e tyre në pasqyrat financiare për vlerën 5,510€. Kjo për shkakë që nga obligimi vlerë 6,410€ i paraqitur në PVF, vetëm vlera 900€ i takon vitit 2022.	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për obligimet e pa paguara në mënyrë që prezantimi i tyre në Pasqyra Financiare Vjetore të jetë i saktë dhe i drejtë.	Me rastin e hartimit të PVF për vitin vijues do të kujdesemi që raste të tilla mos të përsëriten.	Buxhet dhe Financa	E zbatuar
21	B15 - Mos kompletimin i NJAB-së	Neni 5.1.1 i Rregullores 01/2019 për themelimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm përcakton që çdo subjekt i sektorit publik me buxhet mbi 7,000,000€ duhet të ketë së paku tre auditorë. Komuna ka të themeluar NJAB i cili përbëhet nga 2 auditorë, drejtori i auditimit dhe auditori, përderisa sipas ligjit të buxhetit duhet të ketë së paku 3 auditorë. Për shkak të pengesave me sistemin e ri për rekrutimin e personelit për vitin 2022 komuna nuk ka mundur ta rekrutojë pozitën Auditor i Brendshëm. Për vitin 2023 kjo pozitë është planifikuar me buxhetin dhe me plan të personelit, mirëpo deri sa ishim në auditim nuk është zhvilluar ndonjë procedurë e rekrutimit.	Kryetari duhet të sigurojë që sa më parë të zhvillojë procedurat për auditor, për plotësimin me staf të mjaftueshëm, bazuar në rregulloren për themelimin e Njësisë për Auditimin e Brendshëm.	Pozita e tretë për auditor të brendshëm është buxhetuar dhe planifikuar me planin e personelit, pengesat për rekrutim janë eliminuar dhe rekrutimi për pozitën në fjalë do të shpallet këtë vit.	Zyra e Kryetarit (Burimet Njerzore)	E pazbatuar



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

DATË:	06.02.2024
PËR:	KPF dhe Kuvendin e Komunës
NGA:	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale Drejtori, Lorik Maxhuni: 
PËRMES:	Kryetarit të Komunës Ferit Idrizi 
LËNDA:	Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2023 në Komunën e Vushtrrisë

Të nderuar,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkëngjitur **Informatën për shërbimet shëndetësore për vitin 2023 në Komunën e Vushtrrisë**

Me respekt!



Komuna e Vushtrrisë



Q.K.M.F.'Dr.Safet Idrizi''Vushtrri

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRRIË
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

**Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2023 në
Komunën e Vushtrrisë**

Shkurt 2024

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
’’ DR.SAFET IDRIZI ’’ VUSHTRRI
(QKMF)-VUSHTRRI

I- HYRJE

Informata për shërbimet shëndetësore të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH) të Komunës së Vushtrrisë, paraqet informatën gjithëpërfshirës të organizimit dhe funksionimit të KPSH, me të cilin ofrohen informatat e nevojshme për shërbimet e ofruara.

DSHPS dhe menaxhmenti i QKMF-së bazuar në Strategjinë Sektoriale të KPSH në Vushtri dhe në zbatueshmëri me planin e veprimit janë të përkushtuar maksimalisht që të ofrojnë shërbime shëndetësore cilësore, ku përfshihen ato promovuese, parandaluese, diagnostikuese, trajtuese dhe paliative, duke përfshirë në procesin e përkujdesjes shëndetësore për të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Vushtrrisë.

Përkujdesja shëndetësore organizohet duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e popullatës, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

Organizimi i KPSH bazohet në Ligjin për Shëndetësi, aktet nën ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë, Statutin e Komunës dhe Statutin e QKMF-së. Me ligjin për vetqeverisjen lokale përgjegjësia për organizimin dhe kompetencat në KPSH i takojn nivelit lokal të qeverisjes.

QKMF-ja është përgjegjës për organizimin, implementimin e konceptit të Mjekësisë Familjare, si dhe sigurimin e vazhdimësisë të përkujdesjes shëndetësore për popullatën me objektivë kryesorë, përmirësimin e shëndetit të popullatës, duke ju ofruar shërbime të qasëshme, gjithëpërfshirëse si dhe shërbime të cilësisë së lartë.

II- BASHKËPUNIMI ME DONATOR

Gjatë vitit 2023 Komuna Vushtrrisë - DSHPS dhe QKMF kemi arritur bashkëpunim të shkëlqyeshëm me donator për realizimin e projekteve me bashkëfinancim.

- Bashkëpunimi me donatorin AQH e Zvicrës, është duke vazhduar në kuadër të zhvillimit të edukimit të vazhdueshëm profesional . Furnizimi me Inventar donacion na AQH, në vlerë totale 20000.00 Euro për objektin e ri të QKMF.
- DSHPS Komuna Vushtrri dhe Islamic Relief me seli në Prishtinë ka vazhduar projektin i cili ka pasur nismën dhe funksionalizimin në vitin 2017, në bazë të nevojave dhe kërkesave të qytetarëve në fushën e shëndetësisë për projektin e vizitave shëndetësore në shtëpi, ku kemi përmirësuar dhe rritur kapacitetet për funksionalizim më të mirëfillt, për përkujdesjen ndaj qytetarëve të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në krahasim me vitet e kaluara, me numrin e stafit profesional mjekësor të angazhuar 7 ditë të javës /13 orë, me dy ekipe mjekësore të përbëra nga 1 mjek dhe dy infermier, me dy vetura.
Po ashtu bazuar në marrëveshjen stafi aktual profesional është 7 mjek, 14 infermier, 2 teknik laborant dhe 1 asistent stomatologu.
- Në bashkëpunim me UNICEF kemi vazhduar projektin për vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare dhe me të arriturat sipas planprogramit jemi shpërblyer me një automjet terreni për realizimin e vizitave shtëpiake.

III- RRJETI I INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE

Aktualisht kujdesi parësor shëndetësor në komunën e Vushtrrisë është i organizuar përmes institucioneve shëndetësore si në vijim:

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) - institucioni themelor i KPSH-së,

10 - Qendrat të Mjekësisë Familjare (QMF) - si njësi përbërëse të QKMF-së

9 - Ambulanta të Mjekësisë Familjare (AMF) - si njësi përbërëse të QMF-së

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) "Dr.Safet Idrizi" në Vushtri është institucioni shëndetësor kryesor që ofron dhe zbaton Kujdesin Parësor Shëndetësor publik në gjithë territorin e komunës, sipas U/A për KPSH. QKMF ka obligim ligjor që të kujdeset për qytetarët e komunës për sa i përket Kujdesit Parësor Shëndetësor, nën mbikqyrjen dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë të Drejtorisë së Shëndetësisë (DSHPS), të cilës njeherit i raporton për të arriturat apo sfidat, duke i zgjedhur bashkarisht shqetësimet që hasen gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore. DSHPS-së s'bashku me menaxhmentin e QKMF-së caktojnë dhe implementojnë politikat shëndetësore për Komunën e Vushtrrisë.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare – është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët e komunës pa dallim etnije, gjinie, relegjioni, race etj.

Promovimin shëndetësor, parandalimin, mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin,

Promovim: informim, komunikim dhe edukim në institucione, shkolla dhe komunitete,

Parandalim: imunizimin/vaksinimin, monitorim të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve përmes vizitave sistematike,

mjekim: përcaktimin e diagnozës fillestare dhe kujdesin elementar shëndetësor, kujdesin akut përfshirë ofrimin e

kujdesit urgjent, mbikqyrjen dhe transportin deri në institucionet përkatëse, rehabilitim: kujdesi paliativ/terminal.

QKMF është e organizuar në dy departamente si :

Departamentin e Mjekësisë Familjare

Departamentin e Administratës dhe Personelit

Barnatorja Qendrore

Në kuadër të QKMF-së funksionojn edhe njësitë funksionale të ndara në sektore:

Spektori i Mjekësisë Familjare

Spektori i Shëndetit publik

Njësia e SISH

Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit

Spektori i Shëndetit Oral Preventiv,

Spektori i Urgjencës

Raporti vjetor i shërbimeve shëndetësore janar - dhjetor në QKMF 2023

Ju paraqesim në formë tabelare informatën për vizitat mjekësore në QKMF, QMF dhe AMF:

r.	Emri i shërbimit	Totali	Meshkuj	Femra	Participim	Shërbimet	Referime	Malinje	Kronike	Vizita me karte
1	QKMF	62148	29311	32837	9373	169875	3315	44	3361	929
2	Urgjenca	33670	14948	18722	3410	167256	4634	306	4129	0
3	Laboratori	16719	7275	9445	3652	179232	0	0	0	0
4	Stomatologjia	8220	3751	4469	853	36911	254	0	0	567
5	RTG	5468	2392	3076	1053	15934	0	0	0	0
6	Rtg e dhembit	620	297	323	79	1508	0	0	0	0
7	Vaksinimi	4426	2373	2053	0	16004	0	0	0	1385
8	QMF-1	67061	32005	35056	12927	178246	6288	12	4188	1152
9	QMF-2	5997	2680	3317	1048	36264	467	5	391	506
0	QMF-3	7882	3779	4103	1454	56987	35	3	1517	2348
1	QMF-AMF	22455	9843	12612	2913	104768	5911	30	2714	2717
2	V.SHTEPIAKE	4716	2006	2710	0	23290	19	0	0	685
3	Këshillimore AQH	1132	561	571	0	4607	0	0	673	38
	Gjithsejtë	240514	111221	129294	36762	990882	20923	400	16973	10327

Paraqesim në formë tabelare rrjetet e QMF dhe AMF, 12 mujori për vizitat mjekësore dhe shërbime 2023.

Institucionet	Totali	M	F	Referimet	Participim	Shërbime tjera	Vizita me karte	S.Malinje	S.Kronike
QMF Lumadh	6231	2638	3593	217	973	33068	766	8	563
QMF Smrekonicë	2143	967	1176	906	324	9319	74	1	216
QMF Pantinë	2430	1075	1355	806	546	10981	890	13	400
QMF Druar	1110	536	574	382	84	3654	18	0	32
QMF Novolan	663	291	372	205	24	3440	309	0	85
QMF Maxhunaj	3502	1424	2078	1886	595	11120	0	1	399
QMF Dumnicë	517	249	268	185	20	2614	268	0	47
AMF Samadrexhë	1002	419	583	294	52	6377	514	0	427
AMF Strofc	735	343	392	221	25	2232	0	7	196
AMF Pasomë	616	309	307	6	3	2648	100	0	23
AMF Oshlan	283	141	142	65	3	736	0	0	11
AMF Beçiq	425	216	209	71	0	1358	3	0	0
Amf Dubofc	209	140	69	25	0	661	2	0	2
AMF Ceceli	306	121	185	22	8	2692	0	0	44
Gjithsej:	20172	8869	11303	5291	2657	90900	2944	30	2445


- **Sektori i Shëndetit Publik**

Është përgjegjës për shëndetin publik, imunizim dhe vaksinim dhe për Sistemin Informativ Shëndetësor, ky sektor përcjell gjendjen epidemiologjike në bazë të raporteve kthyesë nga IRSHP dhe bashkë me ta vepron në rast se kërkohet apo dyshohet në ndonjë epidemi. **Sëmundjet ngjitëse sipas IKSHPK Mitrovicë**

1. Numri i rasteve të sëmundjeve ngjitëse sipas komunës së Vushtrrisë,

Sëmundjet ngjitëse	Totali	Sëmundjet ngjitëse	Totali
Pneumonia-ARI	712	Hepatitis B dhe C chr.	0
SARI	0	DPE	0
Diarea akute	2104	TBC te reja	17
Variqella	185	Bruceloza	1
Dyshimi ne Influence ILI	435	Malaria	1
Intoxicatio alimentaris	13	Dermatomycosis	0
Meningitis Acuta	7	Ictus ixodes	0
COVID-19	20	Herpes Zoster	4
Meningoencephalitis tuberculozis	0	Vulnus morsum viperi	0
Meningoencphalitis ac	0	Vulnus mors.caanni	1
Meningitis purulenta	0	SST	0
Hepatit acut B	2	Scarlatina-Erizipella	0
Hepatitis ac. C	1		

Grafikoni 1, Grafikoni nr.3 Ecuria e sëmundjeve infektive gjate vitit 2023 sipas komunave



- **Sektori i Vaksimit dhe imunizimit :**

Vaksimi i rregullt tek fëmijët dhe të moshuarit:

Shërbimi i vaksinimit gjatë kësaj periudhe ka qenë i furnizuar me vaksina mjaftueshëm dhe është kryer në bazë të planit në qytet si dhe në fshatra.

Vaksinimi kryhet edhe në 6 QMF si më poshtë:

Nr.	Vendi	Pacient	M	F	Shërbime
1	QKMF	2257	1177	1080	7196
2	QMF-1	1247	704	543	4072
3	QMF-2	233	108	125	842
4	Lumadh	291	166	125	1116
5	Maxhunaj	197	102	95	686
6	Smrekonicë	78	46	32	197
7	Pantinë	123	70	53	409
	Gjithsejtë	4426	2373	2053	14518

Vaksinat kundër gripit sezonal janë administruar:

Nr.	Përshkrimi	Vaksina
1	Vaksina kundër gripit sezonal	2700

Numri i fëmijëve të cilët kanë refuzuar marrjen e vaksinave janë 7.

Në mesin e tyre kemi dy fëmijë të komunitetit ashkali të cilët të janë vaksinuar sipas kalendarit të vaksinave.

Menaxhimi i zingjirit te ftohtë është sipas standardeve, paisjet për standardizim dhe arritjen e kushteve maksimale të respektimit të zingjirit te ftohtë është në nivelin e duhur.

Pasqyra e përfshirjes së nxënësve të vaksinuar 2023:

Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vaksinim

SHFMU	Nxënës të planifikuar		Kanë refuzuar		Vaksina të administruara	
	Nr.nxënësve	%	Nr.nxënësve	%	Nr.nxënësve	%
Klasa I	965	100	15	1.5%	950	98.44%
Klasa XII	600	100	90	14%	510	85%
Gjithësej	1565	100	105	6.71	1460	93.29%

Nxënësit e klasëve të VI – nuk janë vaksinuar sipas kalendarit të rregullt, vaksinimi i tyre është shtyer në vitin 2024 për shkak të vaksinës së re Human Papilo-Virusit.

Vizitat sistematike të nxënësve të klasave të para, pesta dhe të nënta në SHFMU-të të Komunës së Vushtrrisë.

Qëllimet e vizitave sistematike

1. Vlerësimi i nivelit të rritjes dhe zhvillimit të grupmoshës së caktuar, përkatësisht nxënësve të klasave të para, pesta dhe të nënta të shkollave fillore .
2. Njohja dhe identifikimi i veçorive specifike të problemeve shëndetësore të këtyre grupmosha, që do të mundëson zbulimin e hershëm të sëmundjeve dhe anomalive/çrregullimeve eventuale të fëmijët.
3. Dizajnimi dhe organizimi i intervenimeve me natyrë preventive, të bazuara në shkolla dhe komunitet.
4. Krijimi i një baze të të dhënave nga rezultatet e vizitave të realizuara e cila do të mbështesë modifikimin dhe përpilimin e politikave shëndetësore më favorizuese për fëmijët.

Parametrat e vlerësuar:

Është vlerësuar zhvillimi i përgjithshëm psikofizik dhe shëndeti oral Kronologjia e aktiviteteve

Planifikimi i vizitave sistematike

Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vizita sistematike

Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vizita sistematike						
SHFMU	Nxënës të planifikuar për vizita sistematike		Munguar		Vizita të realizuara	
	Nr. I nxënësve	%	Nr. I nxënësve	%	Nr. I nxënësve	%
Klasat I	959	100	26	3%	933	97%
Klasat V	1025	100	6	1%	1019	99%
Klasat IX	956	100	68	7%	888	93%
Gjithsejtë	2940	100	100	3%	2840	97%

Tabela nr. 1- Pasqyrë e përfshirjes së nxënësve në vizita sistematike nga gjithsejtë **2940** nxënës të planifikuar për vizita të realizuara janë 2840 **apo 97%**, ndërsa numri i nxënësve të cilët kanë munguar është **100 apo 3%**.



VLERËSIMI I REZULTATEVE NGA VIZITAT SISTEMATIKE PËR NXËNËS

Nga vlerësimi i rezultateve të dala nga vizitat sistematike të nxënësve të klasave të nënta ,mund të konstatohet se në përgjithësi kemi të bëjmë me një kategori të popullatës(nxënës) të shëndoshë, përjashtimisht problemeve të shëndetit oral, patologjive refraktare të syve .

Përndryshe, shkalla e përgjithshme e shprehur në përqindje e parametrave të vlerësuar me veçori patologjike në shumicën e parametrave është shumë e vogël (përjashtimisht dyshimit në çrregullimet refraktare të syve, mbipeshës, karriesit të dhëmbëve të qumështit dhe higjienës jo të mirë orale dhe rasteve të dyshuara me viciu cordis (zhurmat në zemër) .

Higjiena orale e nxënësve nuk është e mire, e shprehur në përqindje nga numri total i nxënësve të kontrolluar ,del se 53% e tyre janë me nivel të ulët të higjienës orale.Gjendja e mukozës dhe gingivave me veçori patologjike prezenton të jetë 12% nga numri total i nxënësve të vizituar.

Sa i përket zhvillimit të përgjithshëm psikofizik , veçori patologjike në shkallë më të madhe janë konstatuar të të pamurit e të cilat kanë të bëjnë kryesisht me anomali refraktare(ametropia).

Nga numri I përgjithshëm I nxënësve të kontrolluar (948 nxënës) , shkalla e përgjithshme e veçorive patologjike të të pamurit arrinë në 19%(177 nxënës),ndërsa numri I nxënësve të cilët bartin syze për korrektim të refrakcionit është 42, përkatësisht 4%.

Statusi psikik- Nga numri i përgjithshëm i nxënësve të kontrolluar, në aspektin psikik, nga numri total i nxënësve të ekzaminuar(948), si raste të dyshimta me veçori patologjike janë 14 nxënës(2%).Veçoritë patologjike të identifikuar adresohen kryesisht në drejtim të çrregullimit të mësuarit dhe mungesës së vëmendjes.

Gjatë ekzaminimit të të dëgjuarit nuk kemi gjetur raste patologjike të cilat do të konsideroheshin si shumë relevante dhe të besueshme ,për shkak se nuk kemi pasur hapësirat adekuate per te kryer ekzaminimet per degjim . Janë të dyshuar 26 nxënës (3%) .

Zemra- nga numri i përgjithshëm i nxënësve të kontrolluar, 13 nxënës (1%) janë të dyshuar për veçori patologjike të zemrës.

Gjatë evoluimit të projektit , të SWOT analiza u përmenden disa rreziqe të cilat do të reflektonin dukshëm në mundësinë e mos arritjes së rezultatit të pritur apo zëvendësimin e tij me ndonjë rezultat tjetër, atëherë shtrohet pyetja se cili do të duhej të ishte menaxhimi i supozimeve dhe rreziqeve në këtë rast:

Supozimet dhe rreziqet e rëndësishme veç janë identifikuar (sidomos pika 2,3,4 dhe 5);

Të minimizohen gjasat e rrezikut apo të eliminohet rreziku(në këtë rast rreziku për mos arritje të rezultatit të dëshiruar është nga faktori njeri, gjegjësisht nga të gjitha palët e interesit : drejtori i shkollës; mësimmshënësi, prindi si dhe nga ekipi zbatues i projektit).

Meqenëse neve në këtë rast po na mungon informata kthyesë mbi numrin e nxënësve të cilët i kemi referuar si raste të dyshimta ,atëherë që të minimizohet apo të eliminohet rreziku ,hartuesi dhe zbatuesi i projektit duhet që më fillimin e vitit të ri shkollor serish të bëjë ri monitorim për secilin rast të dyshuar dhe në secilën shkollë në mënyrë që rastet eventuale të cilat kanë qenë të referuara për ekzaminim të mëtejme të identifikohen dhe të realizohen këto ekzaminime.

REKOMANDIMET NGA VIZITAT SISTEMATIKE PËR NXËNËS

Duke u bazuar në rezultatet e nxjerra nga vizitat sistematike ,janë nxjerrë rekomandimet si në vijim:

Promovimi i shëndetit oral dhe i kujdesit shëndetësor parandalues për ruajtjen e shëndetit të dhëmbëve nëpër shkolla, çerdhe dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare,duke demonstruar teknikën e pastrimit të dhëmbëve,me qellim të parandalimit të kariesit të dhëmbëve.;

Vulosja e dhëmbëve të përhershëm dhe dhëmbëve të qumështit;

Fluorizimi i dhëmbëve;

Rritja e numrit të mjekëve Stomatolog në QKMF-re ku do të ofrohen shërbimet e stomatologjisë preventive dhe kurative më të avancuara të cilat janë më se të domosdoshme;

Hapja e ordinancave stomatologjike nëpër disa QMF-re në zonat rurale;

Organizimi i kampanjave për edukimin dhe këshillimin e prindërve,fëmijëve parashkollor , fëmijëve nëpër kopshte të tyre dhe nxënësve nëpër shkolla lidhur me mënyrën e drejtë dhe të shëndetshme të ruajtjes së dhëmbëve dhe të ushqyerit e shëndetshëm.

- **NJËSIA E SISTEMIT INFORMATIV SHËNDETËSOR**

Në Sistemin Informativ Shëndetësor në QKMF Vushtrri punohet vazhdimisht në Mjekësinë Familjare, Stomatologji, Tretman, Infuzione, Lidhetore dhe Vaksinim.

Ka pas ndërprerje të Sistemit BHIS gjatë muajve shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor ku ne janar të 2024 është aktivizuar prapë sistemi.

Gjatë këtij viti në SISH është punuar me vizita sistematike ku janë futu në data bazë 2940 fletëza ,dhe është përgatit raporti për klasat e I ,V dhe të IX. Raportohet çdo muaj për morbiditeti,sëmundjet malinje dhe kronike,vizitat mjekësor e Stomatologjike .

Referuar bazës së te dhënave për sëmundjet kronike,hipertension,diabet dhe astmës.

I10	E10	J45
351	673	23

• SEKTORI I SHËNDETIT ORAL

Në sektorin e shëndetit oral preventiv janë vizituar gjithsejtë **8220** pacient dhe ka dhënë **36911** shërbime. Këtu përfshihet këshilla mjekësore, nxjerrja e dhëmbëve, shërimi, bllobbimi dhe pastrimi i gurëzve në dhëmbë. Punohet nga ora 07^h deri në ora 20^h në QKMF dhe në QMF-1, ndërsa dy herë në javë në QMF-2 dhe QMF-3 nga ora 07^h deri ne ora 14^h, QMF Lumadh dhe QMF Pantinë. Kujdestaria mbahet në QMF-1 në ditën e shtunë nga ora 07^h deri ne ora 19^h.

Shërbimet në sektorin e shëndetit oral preventive:

Shërbimet për nxjerrjen e dhëmbit: Caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, eks. Dhëmbit, tamponade e alveolës, këshilla për pacientin.

Shërbimet për vizita: caktimi i diagnozës, aplikim local me udhëzim për rtg dhe terapia e përgjithshme.

Shërbimet për shërimin e karriesit: caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, preparimi i kavitetit, vendosja e shtresës (me ose pa kalcimol), vendosja e bllobbës dhe polirimi dhe korigjimi I pikave kontaktuese.

Shërbimet te pulpitet e dhëmbëve: caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, preparimi i kavitetit deri në hyrje të kanaleve, eksterpimi i pulpës, mbushja e kanalit dhe vendosja e bllobbës.

Shërbimet te gjakëderdhja pas nxerrjes së dhëmbit: caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, kiretazha e alveolës, vendosja e hemostatikut dhe tamponade e alveolës.

Trajntimi I gingiviteve: largimi I pigmenteve të buta dhe të forta me kavitron dhe past me brush.

Bazuar në statistikat sipas regjistrit të popullësise të vitit 2011 në ASK komuna e Vushtrrise ka gjithësej 69870 banor, KPSH në Vushtri ka gjithësejt 9 stomatolog, sipas U/A 6000 banor për një stomatolog, andaj nevoja është për rritjen e numrit të stomatologëve, duke ja shtuar dhe hapjen e shërbimit stomatologjikë ne Pantinë dhe Lumadh.

* **SEKTORI I KUJDESIT URGJENT**

- Sektori i Kujdesit Urgjent është i organizuar dhe punon 24^h/7 ditë të javës, përbëhet nga një ekip mjekësor profesional multidisiplinare me gjithsejtë 26 puntor:

Prej tyre:

- 5 Doktor apo 19.23% e stafit punonjës;
- 10 Infermier apo 38.46% me mosh mesatare 53.7 vjeç;
- 7 Infermiere apo 26.92% me mosh mesatare 47.42 vjeç;
- 4 vozitës apo 15.38% me mosh mesatare 53.25 vjeç.

Gjatë vitit 2023 ka pas gjithsejtë **33670** pacient janë dhanë **167256** shërbime shëndetësore. Në sektorin e kujdesit urgjent kryhen vizita mjekësore dhe shumë shërbime tjera që dalin nga këto vizita. Urgjenca transporton pacientët nga vendi i ngjarjes deri në Emergjencën e Spitalit Sheikh Zayed në Vushtrri e nëse kërkohet ndihmë nga Emergjenca e spitalit, transportohen sipas nevojë në SHSKUK Prishtinë. Në disa raste ofrojn vizita dhe shërbime shëndetësore edhe në shtëpi, kur gjendja e pacientit është e rënd.

Do të paraqesim në formë tabelare raportin e Shërbimit të Sektorit të Kujdesit Urgjent për 12 mujorin 2023

Emri i shërbimit Urgjenca	Totali	Meshkuj	Femra	participim	referime	Referim Tercial	Aksidentet	IM	LV	I.S.C	Infuzione	Glikemia	RKP	EKG	O2	Kateterizim	Lidhje	Rastet e terentit	Vizita gjatë kujdesarise	S.Malinje	S.Kronike	Shtatzana	Mjeku privat	Rastet emergjente	Sherbimet	Dhuna familje	Tetabulin
																						Inek.Infuzi					
Janar	2987	1324	1663	343	445	27	24	759	193	35	299	133	0	295	36	5	36	117	2987	7	349	16	263	552	14930	0	19
Shkurt	2530	1092	1438	353	342	19	9	702	197	33	228	119	2	276	32	9	45	115	1833	16	262	20	231	500	12745	0	36
Mars	2969	1295	1674	381	329	13	25	816	205	64	300	129	4	243	30	5	51	162	1518	12	341	25	368	1023	14725	1	18
Prill	3116	1440	1676	330	384	23	61	704	186	48	310	118	1	190	33	7	63	148	2185	11	389	21	419	889	14990	0	38
Maj	2890	1332	1558	202	409	31	16	834	196	59	290	165	2	159	52	4	90	147	2223	39	483	18	351	138	13772	0	22
Qershor	2827	1332	1495	284	412	27	11	824	129	42	274	160	0	192	33	6	109	98	2237	41	372	28	318	724	14245	1	16
Korrik	3018	1312	1706	262	399	24	25	774	143	62	382	228	1	252	32	5	123	149	3018	35	449	10	447	974	15132	0	41
Gusht	3024	1323	1701	324	452	26	51	761	140	56	397	204	0	311	24	5	94	110	3024	37	424	23	403	811	15510	0	24
Shtator	2691	1128	1563	176	407	29	36	692	100	35	298	206	8	258	25	7	101	134	2691	27	356	18	454	787	13328	0	37
Tetor	2656	1212	1444	249	414	25	18	647	144	48	274	172	0	266	30	5	88	131	2656	35	416	24	311	707	13280	0	27
Nentor	2144	913	1231	193	399	28	36	533	116	28	217	127	1	190	15	5	88	131	2144	37	219	15	267	581	10722	0	56
Dhjetor	2818	1245	1573	313	461	24	18	750	121	44	317	172	5	237	26	6	81	185	2818	44	439	11	376	710	13877		20
Gjithsej	33670	14948	18722	3410	4853	296	293	8796	1870	554	3586	1933	24	2869	368	69	969	1627	29334	341	4499	229	4208	8396	167256	2	334

Rastet e konfirmuara të vdekjes sipas tabelës gjithësej, meshkuj, femra dhe moshë mesatare e vdekjeve:

Muaji	Gjithësej	Meshkuj	Moshë mesatare meshkuj	Femra	Moshë mesatare femra	Moshë mesatare e vdekjeve në total
Janar	18	10	71.30	08	71.25	71.20
Shkurt	10	03	74.66	07	76.57	75.60
Mars	14	06	65.00	08	76.33	70.06
Prill	20	10	70.03	10	74.02	72.20
Maj	15	07	69.05	08	73.04	71.40
Qershor	20	09	70.01	11	74.01	72.00
Korrik	19	08	75.12	11	72.27	73.69
Gusht	13	08	77.87	05	81.20	79.53
Shtator	16	06	72.89	10	83.80	78.34
Tetor	18	14	77.50	04	80.05	78.77

Nëntor	26	11	76.66	15	75.21	75.93
Dhjetor	23	12	70.38	11	78.00	74.19
Totali	212	104	72.53	108	76.31	74.42
Përqindja meshkuj		49.05%	Përqindja femra	50.95%		

Mosha mesatare e vdekjeve, ju paraqesim në formë tabelare krahasimet:

Vitet	Mosha mesatare e vdekjeve
2019	72.14
2020	75.04
2021	73.49
2022	75.3
2023	74.42

• Sektori diagnostikues

Laboratori se bashku me Rëntgenin bëjnë pjesë në sektorin e diagnostikës.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2023 në Laborator ka pas gjithsejtë **15333** pacient dhe janë dhënë **150531** shërbime te ndryshme, është hapur laboratorin në Lumadh në bashkëfinancim me AQH të cilët kanë dhënë donacion me pajisje mjekësore për laborator por për shkak gjendjes e cila u përkeqësua nga virusi dhe në mungesë të stafit laboratorit, përkohësisht nuk është funksional.

Laboratori ka kemi pasur vonesa në furnizuar mirë me reagensë, për të cilat kemi raportuar në DSHPS dhe Drejtorinë e Prokurimit.

Raporti një vjeçar 2023 për vizitat dhe shërbimet në laborator të QKMF

Nr.	Periudha kohore	Totali	Meshkuj	Femra	Pacient që kanë Participu	Euro	Shërbim	Përqindja/participim
1	Janar	1342	528	814	335	960	13508	24.96%
2	Shkurt	1438	588	850	369	1045	17071	25.66%
3	Mars	1587	634	953	368	997	18852	23.19%
4	Prill	879	348	531	184	509	10505	20.93%
5	Maj	1320	519	801	285	814	15509	21.59%
6	Qershor	1127	430	697	233	654	13156	20.67%
7	Korrik	1035	410	625	233	658	11156	22.50%
8	Gusht	1194	447	747	269	763	13586	22.50%

9	Shtator	1426	573	853	361	1018	16623	25.30%
10	Tetor	2546	996	1550	380	1060	18144	24.60%
11	Nëntor	1371	575	796	333	959	15912	24.20%
12	Dhjetor	1244	516	728	302	843	13704	24.20%
Totali		15506	6564	9945	3652	10280	177726	23.35%

Raporti 8 mujor për vizitat dhe shërbimet në laborator QMF Lumadh

Nr.	Periudha kohore	Totali	Meshkuj	Femra	Pacient që kanë Participu	Euro	Shërbim	Përqindja/participim
1	Maj - dhjetor	120	28	92	28	84	1096	23.33%
Totali		120	28	92	28	84	1096	23.33%

Raporti 2 mujor për vizitat dhe shërbimet në laborator QMF 3

Nr.	Periudha kohore	Totali	Meshkuj	Femra	Pacient që kanë Participu	Euro	Shërbim	Përqindja/participim
1	Nëntor - dhjetor	90	21	69	0	0	410	0.00%
Totali		90	21	69	0	0	410	0.00%

- Rëntgeni nga Janari deri në Dhjetor** ka pas gjithsejtë 5675 pacient dhe janë dhënë 15949 shërbime. Organizimi i punës në sektorin e radiologjisë bëhet sipas orarit pesë ditë pune nga ora 08:00h deri në ora 13:00h, të angazhuar 4 teknik të radiologjisë, vlen të ceket se të gjithë ata që kanë kërkuar shërbim në Radiologji kanë marrë shërbimet radiografike, material për punë kanë pas mjaftueshëm filma të Rëntgenit si dhe CD.

Viti-2023.	Pacient	Participime	Ekspozime	CD	Filma	Shërbime
1. Janar	448	107	846	0	529	1374
2. Shkurt	435	94	807	0	510	1318
3. Mars	535	107	936	28	530	1493
4. Prill	356	62	604	321	65	985
5. Maj	540	107	971	524	74	1565
6. Qershor	439	80	799	426	77	1322
7. Korrik	443	76	772	422	82	1277

8.	Gusht	547	110	916	514	109	1538
9.	Shtator	532	96	865	466	175	1496
10.	Tetor	490	108	856	464	110	1433
11.	Nëntor	273+187 në spital=460	65	472	270	61	803
12.	Dhjetor	450	91	775	448	122	1345
Totali		5675	1103	9619	3883	2444	15949

- **Barnatorja Qendrore**

Ka për detyrë të bënë planifikimin, organizimin, ruajtjen e zingjirit të frohtë dhe liferimin e produkteve medicinale nëpër QMF dhe AMF.

Per shkak te mungesave gjatë furnizimit me barna dhe material shpenzues nga Ministria e Shendetësisë, QKMF ka qenë e detyruar të bëjë blerjet e tyre nga buxheti i komunës së Vushtrisë të ndarë për blerjet e produkteve medicinale dhe material shpenzues, permes korniz kontratës me furnizuesin “MEDPLUS ShPK”:

Nr.	Vlera e blerjesë €
2023	19.049.42
Gjithsej	19,049.42

Në tabelën e mëposhtme keni të bashkangjitur përqindjen e furnizimeve nga M.Sh. me barna dhe material shpenzues për periudhën kohore janar – dhjetor 2023, nga lista esenciale:

Nr.	Muaji	Barnat	Material shpenzues
1	Janar	31.65%	75%
2	Shkurt	13.92%	80%

3	Mars	30.38%	75%
4	Prill	26.58%	70%
5	Maj	27.84%	72.22%
6	Qershor	35%	72%
7	Korrik	41.77%	60%
8	Gusht	45%	55%
9	Shtator	32%	60%
10	Tetor	40%	60%
11	Nentor	46.83	70%
12	Dhjetor	48.75%	50%
	Mesatarja vjetore	35.81%	66.80%

Depoja Qendrore Farmaceutike gjatë vitit 2023 ka bërë shpërndarjen e barnave dhe materialit shpenzues në gjithsej 18 QMF dhe AMF të komunës së Vushtrrisë, në interval të caktuara kohore, QMF dhe AMF për çdo muaj, ndërsa QKMF dhe QMF-1 në intervale 2 javore.

Raporti i bombolave të oksigjenit medicinal Janar – dhjetor 2023

Nr.	Pershkrimi	Dhënia	Sasia	Totali
1	Bombola oksigjeni medicinal 8.5 kg	Pacient	226	226
2	Bombola oksigjeni medicinal 8.5 kg	Insitucionet/QKMF/QMF/AMF	60	60
3	Dhënia e aparatit koncentrador	Pacientë	5	5
Totali			286	286

- **Sigurimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore**

Sigurimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore definohet si “ sistem i organizuar për përmirësimin e praktikave apo kualitetit të kujdesit mjekësor”. Përmirësimi i kualitetit përfshin përpjekjet e vazhdueshme nga të gjitha anëtarët e organizatës për të përmbushur nevojat dhe pritjet e pacientëve. Gjatë vitit 2023 aktiviteti ynë ka qenë i orientuar në plotësimin e kriterëve dhe dokumentacionit të Sitemit të Menaxhimit të Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore nën monitorimin dhe vlerësimin e auditorit të jashtëm të anagazhuar nga AQH Zvicrane.

Gjatë vlerësimit kemi pasur një vlerësim 8 orësh nga Auditor ndërkombëtar dhe vlerësimi preliminar ka qenë që i kemi plotësuar kriteret për menaxhimin e blloqeve (12 blloqe të vlerësimit) në mënyrë të knaqëshme me disa vërejtje që duhet ti plotësojmë për vlerësimin e ardhshëm në vitin vijues.

Gjatë këtij viti kemi punuar në informimin e stafit për shfrytëzimin e proceduarave operative standarde dhe kemi vendosur në çdo vend pune në form të shkruar PSO (Porcedura Standarde Operative) si dhe përgjegjësit e shërbimeve ku stafin kemi furnizuar me literaturën dhe janë obliguar ti monitorojnë dhe ngritjen e nivelit të shfrytëzimit të PSO.

Në bazë të planit gjatë këtij viti kemi mbajtur 4 takime të Komiteteve të Cilësisë duke i adresuar detyrat dhe aprovimin e dokumentacionit që është i domosdoshëm për plotësimin e dokumentacionit të SMC (Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë).

Në mbledhjen e fundit kemi aprovuar 3 dokumente që kanë qenë Konformitete të mëdha nga vlerësimi dhe tani kemi plotësuar obligimet e SMC nga vlerësimi.

Gjatë këtij viti është punuar një Audit (Shkalla e vlerësimit të vaksinimit me Hep.C te stafi) dhe janë marrë hapat e duhur që ti sigurojmë vaksinat e duhura që të krijojmë siguri të stafit në punë që është duke u zhvilluar.

Është punuar edhe një Rishqyrtim Kolegial për të ndihmuar Vizitat shtëpiake të fëmijëve, grave shatëtzëna dhe pacientëve me gjendje të rëndë terminale me rekomandime që të rritet efikasiteti i këtij shërbimi.

Kemi punuar një intervistë për satisfacion të pacientëve me të dhëna për disa pyetje standarde në lidhje me shërbimet dhe vlerësimin e punës së stafit.

Në muajin dhjetor kemi pas një takim me të gjitha qendrat tjera të Kosovës (QKMF) duke i prezentuar punën dhe gjatë këtij prezentimi punimi jonë ka gjetur vlerësim për zgjedhje të temave që janë relevante dhe praktike për stafin dhe avansim të shërbimeve.

Për ngritje të nivelit të cilësisë së SHSH në bashkëpunim me Drejtorin e drejtorisë së Shëndetësisë së Komunës kemi zhvilluar edukimin për ultrazërin e abdomenit dhe ka pasuar sukses dhe shpresojmë të vazhdojmë me punë pas vitit të ri.

- **ZHVP- Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional**

Bazuar në raportin e ZHVP-së lidhur me aktivitetet e ndërmaruara ka bërë bashkëpunim me QZMHF në Prishtinë dhe QTMF në Mitrovicë duke realizuar planprogramin gjatë vitit 2023,

Koordinatori i Cilësisë së bashku me Kryeinfermieren e QKMF dhe trajneret e Mjekësisë familjare ka bërë një Audit klinike dhe një Rishqyrtim kolegial, po ashtu në pjesën e dytë të vitit 2023.

ZHVP- Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional për mjekët dhe infermier, është komponent me rëndësi të veçantë për institucionin e QKMF-së. Në QKMF mbahen takime të rregullta me mjek dhe infermier të cilat organizohen përmes përgjegjëses për ZHVP. Gjatë vitit mbahen takime profesionale për profesionistët mjekësor për çdo muaj, 10 ligjërata , këto ligjërata nuk mbahen vetëm në muajin korrik dhe gusht. Zakonisht janë mbajtur ligjërata me tema që kanë qenë të përzgjedhura nga këshilli profesional i QKMF-së dhe nga ky vit janë të certifikuar nga OMK.

Nr.	Tema	Ligjërues	Vendi	Nr.Pjesm.	Data
1					

	Arresti kardiak respirator Kolikat abdominale	Dr.Arjan Cakaj Dr.Edon Peci	QKMF Vushtrri QKMF Vushtrri	19 pjesemarres(mjeke familjare dhe doktor te mjekesise) 22 pjesemarres (mjeke familjare dhe doktor te mjekesise)	27.01.2023 24.02.2023
2	Artriti reumatoid	Dr.Selman Maxhuni	QKMF Vushtrri	21 pjesemarres (mjeke familjare dhe doktor te mjekesise)	31.03.2023
3	Gastritet	Dr.Leonora Drevinja	QKMF Vushtrri	16 pjesemarres (mjeke familjare dhe doktor te mjekesise)	28.04.2023
4	Cistitet Kronike	Dr.Elsa Merovci	QKMF Vushtrri	11 pjesemarres (mjeke familjare dhe doktor te mjekesise)	31.05.2023
5	Cregullimet e gjumit	Dr.Ilir Berisha	QKMF Vushtrri	17 pjesemarres (mjeke familjare dhe doktor te mjekesise)	03.10.2023
6	Diabeti Melitus	Dr.Hasan Rama	QKMF Vushtrri	16 pjesemarres (mjeke familjare dhe doktor te mjekesise)	03.11.2023
7	Semundjet me te shpeshta te lekures	Dr.Albiona Shabani	QKMF Vushtrri	14 pjesemarres (mjeke familjare dhe doktor te mjekesise)	04.12.2023
8	Dhimbjet e shpines	Dr.Feim Zahiti	QKMF Vushtrri	14 pjesemarres (mjeke familjare dhe doktor te mjekesise)	26.12.2023

Raporti i ZHVP-se per trajnimet e mbajtura ne periudhen Janar-Dhjetor nga oda e mjekëve dhe AQH

- Vizitat në shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijët 0 - 3 vjet – 06.02.2023–10.02.2023 3 mjek
- Bazat e komunikimit dhe këshillimit në KPSH – 10.03.2023 – 1 mjek
- Kudjesi ndaj të moshuarve- 16.03.2023 – 1 mjek
- Parandalimi dhe kontrolli i infeksioneve- 24.03.2023 – 1 mjek
- Trajnimi dhe menaxhimi i Bernaut Syndrome – 04.04.2023 – 2 mjek
- Trajnimi dhe menaxhimi i Bernaut Syndrome 05.04.2023 – 1 mjek
- Trajnimi dhe menaxhimi i Bernaut Syndrome 18.04.2023 – 1 mjek

- Trajnimi dhe menaxhimi i Bernaut Syndrome 19.04.2023– 2 mjek
- Trajnimi dhe menaxhimi i Bernaut Syndrome 25.04.2023 – 2 mjek
- Trajnimi dhe menaxhimi i Bernaut Syndrome 26.04.2023 – 2 mjek
- Bazat e komunikimit dhe keshillimit ne KPSH 07.04.2023 – 1 mjek
- Kujdesi ndaj të moshuarve 27.04.2023 – 1 mjek
- Parandalimi dhe kontrolli i infeksioneve 28.04.2023 – 1 mjek
- Etika profesionale dhe të drejtat e pacientit 02.05.2023 - 1 mjek
- Dhuna ne baza gjinore 11.05.2023 -12.05.2023 1 – mjek
- Vizitat në shtëpi për gratë shtatzena dhe femijet 0-3 vjeq 23.05.2023-29.05.2023 – 2 mjek
- PEN – protokolet 19.09.2023 1-mjek
- PEN – protokolet 05.10.2023 1-mjek
- PEN – protokolet 10.10.2023 1-mjek
- PEN – protokolet 17.10.2023 1-mjek
- Ligjerata e KOMC shkollës së ultratingullit 07.12.2023-23.12.2023
Janë trajnuar 8 – mjek

- **ZHVP për infermier** gjithashtu mbanë ligjërata të përmuajshme për infermier dhe ligjërata në komunitet me theks të veçantë në edukim dhe promovim shëndetësor. Ligjëratat në komunitet mbahen zakonisht ne viset rurale në objektet e qendrave shëndetësore apo në shkolla fillore, ligjërata mbahen edhe për adoleshentët në shkollat e mesme . Gjithashtu ZHVP se bashku me koordinatorin e cilësisë dhe qendrën trajnuese për infermier (QEV) i shënon ditët e caktuara botërore për sëmundje të ndryshme, me aktivitete jashtë institucionit dhe në bashkëpunim me punëtorë tjerë shëndetësor në QKMF.

Qendra për zhvillim të vazhdueshëm professional infermierik ka dhënë aktivitetet si më poshtë për periudhën kohore 01.01.2023 deri 31.12.2023:

Raporti i aktiviteteve të ZHVP-së Infermiore në QKMF-Vushtrri

Tabela . Aktivitet e organizuara nga ZHVP-infermieri në QKMF

Nr	Tema	Ligjëruesi-ja	Nr.Pjesmarresve	Data
1.	Reanimacioni Kardiopulmunar	Inf.Esat Uka	17	18.01.2023

			20	25.01.2023
2.	Proceduarat e perpunimit te plages dhe djegies	Inf.Fatmire Feka	20 20	06.02.2023 13.02.2023
3.	Java e imunizimit	Inf.Gyltene Haziri	16 18	10.03.2023 17.03.2023
4.	Metoda imazherike ne diagnostiken radiologjike	Inf.Hajrie Bregaj	12 18	02.06.2023 07.06.2023
5.	Roli dhe detyrat e infermierise ne KPSH	Inf.Valbone Mernica	17 10	09.06.2023 16.06.2023
6.	Vlersimi I shenjave vitale nga infermiera	Inf.Gylshene Zuqaku	20 11	08.10.2023 11.10.2023
7.	Perdorimi I dezinfektusve në ambientet e KPSH dhe higjena e duhur në institucion	Inf.Ibadete Muzaqi	11 16	15.11.2023 29.11.2023
8.	Pergatitja e pacientit për analiza biokimike	Inf.Dafina Halili	12 15	06.12.2023 14.12.2023

Nr	Tema	Ligjëruesi-ja	Nr.Pjesmarresve	Data
1.	Këshillimi Motivues	10	06-07.03.2023, 25-26.04.2023, 21-22.03.2023, 01-02.11.2023, 06-07.11.2023	Këshillimi Motivues
2.	Bazat e komunikimit dhe këshillimit	2	10.03.2023 07.04.2023	Bazat e komunikimit dhe këshillimit
3.	Kujdesi ndaj të moshuarve AQH	2	10.03.2023 07.04.2023	Kujdesi ndaj të moshuarve AQH
4.	Parandalimi dhe kontrolli i infeksioneve	2	24.03.2023 28.04.2023	Parandalimi dhe kontrolli i infeksioneve
5.	Infeksionet seksualisht të trasmetueshme	2	20-22.03.2023	Infeksionet seksualisht të trasmetueshme
6.	Komunikimi nderpersonal për vaksinim	38	27.03.2023 08.12.2023	
7.	Etika profesionale dhe të drejtat e Pacienteve	1	02.05.2023	
8.	Dhuna në baza gjinore	3	2023	
9.	Klasa për Nana dhe grup-care	3	16.17.2023	
10	Trajnimi për vaksinim në Mitrovicë	16	26.10.2023 01-02.11.2023	

Raporti i aktiviteteve të ZHVP-së infermierore në Komunitet Janar-dhjetor 2023

Nr	Tema	Ligjëruesi-ja	Nr.Pjesmarresve	Data
1.	Rregullat e komunikacionit dhe masat parandaluse	Inf.Edona Munishi	Shkolla fillore "Mustaf Venhari"	14.03.2023
2.	Kujdesi infermieror te personat me Hipertension & Dita Botërore e Diabetit	Inf.Florije Shaqiri	QMF Pantin	27.03.2023
3.	Parandalimi TBC	Inf.Emine Cimili	SHMU "Anton Zako Qajupi"	24.04.2023
4.	Keshilla për higjenen personale te femrat &Thuaj JO duhanit	Inf.Aferdita Uka	AMF.Fsh.Pasome SHMU."Adem Voca"	12.05.2023 31.12.2023
5.	Metodat dhe mjetet kontraceptive	Inf.Mire Syla	QMF.Fsh.Smrekoni c	23.06.2023
6.	Palpimi I gjirit	Inf Dafina Halili	Qmf2	12.10.2023
7.	Aktivitetet në kuader te Dites Botrore e Diabetit	Inf.Dafina Halili Inf.Burbuqe Gjoni	QMF1 dhe Shesh	14.11.2023
8.	Parandalimi I HIV-AIDS	Inf.Lirije Bivolaku Inf.Dafina Halili	Gjimnazi "Eqrem Qabej"	11.12.2023

Në bazë të nenit 1.8 të Ligjit të Odave të Profesionistëve Shëndetësor 04/L-150 dhe nenit 14 pika 1.7, nenit 3.6 dhe nenit 6.8 të Rregullores për Edukim të Vazhdueshëm Profesional, Oda e Infermierëve të Kosovës ka leshuar kete Vendim 05/1-4PJV2 ka akredituar planin e aktiviteve trajnuese për profesioniste shëndetësor QKMF "Dr. Safet Idrizi" Vushtrri.

Trajnimet që janë mbajtur dhe do te mbahen në vazhdimësi dhe kanë synim kyq zhvillimin e aftësive të infermierëve në edukim modern, transferin e mirë të njohurive dhe shkathtësive të mësuara përmes zbatimit të teorisë dhe praktikës si dhe përgjegjësive të tyre etike e profesionale.

Aktivitetet trajnuese të planifikuara për infermier dhe profesionistë tjerë shëndetësor kanë të bëjnë me :

- Edukimi shëndetësor
- Parandalimi i sëmundjeve
- Promovimin e shëndetit dhe kujdesit infermieror
- Menagjimi i informacioneve të reja
- Vazhdimi i edukimit, shëndetësor ne komunitet
- Përmirsim i relacionit infermier klient.

I tërë ky aktivitet është për të rritur vetëbesimin në shërbimet infermiore dhe natyrisht përmes kësaj edhe lehtësimin e marrjes së vendimeve tek profesionistët shëndetësorë, njëherit që të fitohen edhe pikë akredituese për infermier.

Në janar filluam me trajnimet e gjata 3 ditore me teme "Menaxhimi dhe mbeshtetja e personave me aftësi të kufizuara". Trajnimi ka një modul i cili i ka gjithsejt 10 tema. Trajnimi është mbajtur gjatë orarit të punës nga ora: 10:00 - 14:00.

Grupi 1 me 24.01.- 26.01.2023 8 pjesëmarrës

Grupi 2 me 31.01.- 02.02.2023 8 pjesëmarrës

Grupi 3 me 07.02. – 09.02.2023 8 pjesëmarrës

Grupi 4 me 14.02.- 16.02.2023 **8** pjesëmarrës

Grupi 5 me 28.02. – 02.03.2023 **8** pjesëmarrës

Grupi 6 me 07.03.- 09.03.2023 **11** pjesëmarrës

Grupi 7 me 21.03. – 23.03.2023 **6** pjesëmarrës

Grupi 8 me 02.05. – 04.05. 2023 **7** pjesëmarrës

Grupi 9 me 16.05. – 18.05.2023 **7** pjesëmarrës

Grupi 10 me 30.05. – 02.06.2023 **6** pjesëmarrës

Grupi 11 me 13.06. 15.06.2023 **6** pjesëmarrës

Pas kryerjes se trajnimit kemi përgatit certifikatat për pjesëmarrësit të cilët janë kredituar me nga 20 pikë.

Me 25.05.2023 kemi marrë pjesë në Karvanin Shëndetësor në fshatin Samadrexhë të organizuar nga AQH-ja dhe OJQ Mundësia Mitrovice.

Gjashtëmuajori i dytë i vitit 2023

Me datën 01.09.2023 aktivitet në komunitet me organizatën joqevritare”Karavani shendetsor” kemi kryer këto shërbime : matjen e TA, matjen e peshës, matjen e glikemisë, edukim shëndetësor, si dhe shperndarjen e fletpalosjeve.

Datë 24.08.2023 u mbajt sesioni i katërt me grupin e dytë të grave shtatëzana.

1.Planifikimi familjar

2.Dhuna ne familje dhe Lindja e parakohshme

Me dt.25.09.2023 filluan me gr.12 për trajnimin “Menagjimi dhe mbeshtetja për personat me aftësi të kufizuara”.

15.09.2023 Kam ligjruar në sesionin e pestë të grupin e dyte me gratë shtatzana

1.Lindja normale dhe me operacon

2. Vendi I lindjes për grat shtatëzana

3.Kur të telefonojm(shenjat e rezikut).

Me dt. 03.10.2023. **Java e gjidhanjes** , ligjerim me dy grupe qiftesh me temen “Te ushqyerit e fëmiut me qumësht gjiri”.

Me 04 .10.2023 kam ligjërat me temen “Tetori muaji I ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit” në QKMF.

Me 05.10.2023 Ligjrat me grup femrash shtatëzana dhe lehona për “Të ushqyerit e fëmiut me qumësht gjiri”

Me 03.11.2023 Ligjerat per Higjien personale në kopshtin Foleja2 në Vushtrri si dhe kontrollimin e fëmijëve për pedikuloz, higjienen e trupit dhe dhëmbëve.

Në gjashtmuajorin e dytë janë kryer këto grupe të tranimeve :

Gr 12- 05.08.2023- 07.09.2023	6 pjesëmarrës
Gr 13 -19.09.2023- 21.09.2023	5 pjesëmarrës
Gr 14-03.10.2023-05.10.2023	8 pjesëmarrës
Gr 15- 10.10.2023-12.10.2023	7 pjesëmarrës
Gr16-24.10.2023-26.10.2023	8 pjesëmarrës
Gr 17—31.10.2023-02.11.2023	9 pjesëmarrës
Gr 18 – 14.11.2023- 16.11.2023	6 pjesëmarrës

Pas kryerjes së trajnimit kemi përgatit certifikatat për pjesëmarrës të cilët janë kredituar me nga 20 pikë.

Gjethsejt të trajnuar gjatë keti viti jane 128 pjesemarrës ,prej tyre 105 punetorë të qendres tonë ,17 punetor të Islamikut IRV dhe 11 profesionist shendetesor të pa punesuar .

Aktivitet në komunitet “Dita botërore e Diabetit” më14.11.2023 u mbajt në në sheshin e qytetit.

01.12.2023 Ligjrata në komunitet për Diten botërore të luftës kunder HIV/AIDS . Në shkollat fillore të fshatit Pestovë dhe Maxhunaj.

Gjate muajit dhjetor në vazhdimi jemi duke.pergatitur planin për trajnimet e gjata për vitin 2024 në plane janë parapar 10 tema të cilat kanë nga 2 pikë, d.m.th pjesëmarrësit do të pajisen me certifikata me 20 pikë.

- **Këshillimorja për Edukim dhe Motivim Shëndetësor**

Këshillimorja për Edukim dhe Motivim Shëndetësor, për sëmundje kronike jo infektive me theks Hipertensionin , Diabetin dhe Astma është fryt i bashkëpunimit me donator Zvicran për kujdes të qasshëm dhe cilësor (AQH). Vizita mjekësore si dhe të matjes së tensionit, glikemisë dhe asthms, furnizimi me broshura për edukim dhe preventivë për këto sëmundje, dhënia e librezave për pacient ku përshkruhet edhe terapia që e merr pacienti, regjistrimi i matjeve të tensionit dhe glikemisë për përcjellje te gjendjes shëndetësore. Po ashtu është bërë trajnimi i stafit shëndetësor mjek dhe infermier për edukim shëndetësor motivues, kemi përfituar trajnime të shumta si për stafin menaxherial, profesionistet shëndetësor . Numri i pacientëve nga janar deri në dhjetor 2023 këshillimore për sëmundje kronike, në KPSH si QKMF, QMF-1 QMF-2, QMF-3, QMF dhe AMF 7 fshatra janë këshilluar pacient me sëmundje kronike Diabet, Hipertesion dhe Asthma.

Të dhëna për hipertensionin, diabetin dhe astmën 2023;

Numri i vizitave në Këshillimore, Periudha e raportimit: Janar - Dhjetor 2023

Grupmosha	Gjinia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej Janar- Dhjetor
0-4	Meshkuj													0
	Femra													0
5-9	Meshkuj				1									1
	Femra													0
10-14	Meshkuj													0
	Femra													0
15-19	Meshkuj													0
	Femra	1											1	2
20-24	Meshkuj								2					2
	Femra					1	1							2
25-29	Meshkuj		1											1
	Femra		1			1			1	1				4
30-34	Meshkuj											1		1
	Femra										1			1
35-39	Meshkuj			4		2						1		7
	Femra		2						2					4
40-44	Meshkuj	1		2					1		8	3	3	18
	Femra					2	1	1	3	2			1	10
45-49	Meshkuj			1		1		5	4	2				13
	Femra	4	4	4	1	5	3	4	5	6	5	6	2	49
50-54	Meshkuj	5	4	7	1	5	2	7	2	3	1	2	5	44
	Femra	13	9	13	6	13	8	7	10	5	7	12	6	109
55-59	Meshkuj	5	9	5	2	1	5	4	7	5	5	4	2	54
	Femra	9	5	4	4	13	4	4	8	7	7	10	7	82
60-64	Meshkuj	11	7	10	1	9	6	10	8	8	5	3	3	81
	Femra	11	8	15	3	13	9	4	13	14	8	13	4	115
65-69	Meshkuj	14	10	13	5	13	19	7	12	22	16	16	7	154
	Femra	5	7	8	4	10	3	7	6	6	9	12	4	81
70-74	Meshkuj	11	10	11	2	16	11	6	13	14	18	12	6	130
	Femra	5	10	15	3	9	9	6	7	9	11	13	6	103
75-79	Meshkuj	8	6	11	3	9	4	3	7	5	15	14	4	89
	Femra	4	4	1	1	1	2	6	3	2	2	4		30
80+	Meshkuj	1	2			3	3	2	2		4	2	1	20
	Femra	1		1		1				3	2			8
Gjithsej		109	99	125	37	128	90	83	116	114	124	128	62	1215

Numri i përgjithshëm i pacientëve në këshillimore për periudhën janar – dhjetor 2023

Nr.rendor	Sëmundjet	Nr.pacientëve	Nr.Shërbimeve
1.	Diabet	243	988
2.	Hipertension Arterial	17	70
3.	Vizita Astmë	7	30

4.	Pacient me DM dhe HTA	932	3786
5.	Pacient me faktor rrezikut DM-HTA	16	66
Totali		1215	4940

Sërbimi vizitat shtëpiake për gra shtatzëna, lehona dhe fëmijët deri në moshën 3 vjeçe

BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATËN JOQEVERITARE UNICEF DHE AMC

Gjatë vitit 2023 DSHPS dhe QKMF kanë arritur që të vazhdojnë bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me donator për realizimin e projekteve me bashkëfinancim.

Në koordinim dhe bashkëpunim të MSH, UNICEF-in dhe AMC-ën vazhdohet të implementohet programi i vizitave shtëpiake për gra shtatzëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare

Në bashkëpunim me UNICEF-in dhe AMC-në kemi vazhduar projektin për vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare.

- Si rezultat i përmbushjes së planprogramit QKMF është shpërblyer me një veturë për kryerjen e vizitave në teren nga Ministria e Shëndetësisë.

Puna në terren ka mundësuar të hasim në shumë raste me interes, mirëpo rastet të cilat janë referuar për trajtim dhe identifikim tek mjeku familjar, pastaj te pediatri kanë qenë gjithsej 15 të tilla. Këto rastë te veçanta kryesisht kanë të bëjnë me ngecje në rritje dhe zhvillim.

Numri i vizitave shtëpiake në komunën e Vushtrrisë në vitin 2023:

Shërbimet	Jan ar	Shk urt	Mar s	Prill	Ma j	Qe rsh or	Ko rrik	Gu sht	Sht ator	Tet or	Nënto r	Dhjetor	Total
Numri i vizitave për fëmijët 0-3 vjeç	383	314	338	223	295	339	444	366	477	426	284	165	4054
Numri i vizitave për shtatzëna	59	47	45	23	78	58	84	72	65	55	37	39	662
Numri total i vizitave.	442	361	383	246	373	397	528	438	542	481	321	204	4716

- **Projekti është realizuar sipas Objektivave të shtojcës B të marrëveshjes për ofrimin dhe dhënien e shërbimeve mjekësore si :**

- Gratë shtatzëna dhe lehonat;
- Moshë e tretë mbi moshën 65 vjeçare;
- Personat me aftësi të ndryshme;

- Personat me sëmundje kronike;
- Pesonat me sëmundje malinje;
- **Për ofrimin e shërbimeve mjekësore janë furnizuar sipas kërkesës:**
 1. Furnizimi me barëra dhe material shpenzues mjekësore;
 2. Furnizimi me karburant për vetura, servisimi dhe mirëmbajtja e veturave;
 3. Furnizimi me mbushje të telefonisë mobile;
- **Organizimi i punës:**

Qytetarët e komunës së Vushtrrisë në nevojë për dhënien dhe ofrimin e shërbimeve mjekësore përveç vizitave mjekësore, janë dhënë shërbime të ndryshme si dhe janë aplikuar terapitë e nevojshme nga projekti sipas listës esenciale të Ministrisë së Shëndetësisë.

Nga muaji janar 2023 projekti konkretisht realizohet me përpikëri sipas marrëveshjes ku kemi 6 ekipe mjekësore të përbërë nga 1 mjek dhe 2 infermier. Puna për ofrimin e shërbimeve mjekësore ditore është kryer sipas këtij plani dy ekipe mjekësore (2 mjek dhe 4 infermier), njëri ekip i cili e organizon punën për dhënien e shërbimeve mjekësore në vise urbane, kurse tjetri në vise rurale, me dy automjete, terapinë dhe materialin e nevojshëm për ofrimin e shërbimeve mjekësore, si këshillimin (pacientët me sëmundje kronike, pacientët me sëmundje malinje, shtatzënat dhe lehonat etj.), vizitat mjekësore, marrjen e anamnezës, matjen e tensionit, matjen e glukozës, matjen e saturimit, matjen e pulsit, matjen e temperaturës, përshkrimin e terapisë sipas nevojës, EKG, dhënien e terapisë paranterale (intravenoze dhe intramuskulare), kateterizimin, pastrim dhe fashim të plagës deri në shërim, referime tek nivelet tjera të kujdesit shëndetësor sipas nevojës.

Orari i punës është 7/13 orë, që do të thotë se punohet 7 ditë të javës me orar 13 orë duke përfshirë edhe vikendet, festat etj.

- Për realizimin e projektit momentalisht janë të angazhuar këto resurse humane:

Pozita profesionale	Numri i nëpunësve
Doktor të Mjekësisë	7
Infermier të Përgjithshëm	14
Teknik laborant	2
Asistent stomatologu	1

Ofrimi i shërbimeve mjekësore për vizitat shtëpiak sipas marrëveshjes së Komunës së Vushtrrisë dhe Islamic Relief Worldwide me seli në Prishtinë.

- Bazuar në marrëveshjen mes Komunës së Vushtrrisë dhe IRW Kosova, unë jam angazhuar si organ mbikëqyrës, andaj sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Islamic Relief Worldwide-Zyra në Kosovë dhe Komuna Vushtrri , në kuadër të realizimit të projektit paraqes raportin janar dhjetor 2023:

Nr.	Raport 12 mujor 2023	Numri total i vizitave	Meshkuj	Femra	Numri i vizitave të pacientëve mbi 65 vjeç	Numri i vizitave lehonave	Numri i vizitave të fëmijëve deri 3 vjeç	Totali i Shërbimeve

1	Janar 2023	2765	1019	1746	945	37	288	8077
2	Shkurt 2023	3264	1176	2088	1046	51	341	1249
3	Mars 2023	3180	1250	1930	1016	45	338	6309
4	Prill 2023	2278	919	1359	999	23	217	6284
5	Maj 2023	4240	1182	3058	989	78	298	13283
6	Qershor 2023	2401	962	1439	914	58	339	6262
7	Korrik 2023	2338	1039	1299	927	84	424	5418
8	Gusht 2023	2770	1194	1576	983	72	366	11286
9	Shtator 2023	2524	1096	1428	934	20	75	5839
10	Tetor 2023	1487	744	743	806	15	63	3003
11	Nëntor 2023	1371	660	711	810	18	100	2829
12	Dhjetor 2023	1729	693	1036	908	33	54	3038
	Totali	30347	11934	18413	11277	534	2903	72877

- **Shërbimi teknik dhe mbështetës**

Autoparku

Autoparku ka gjithësejt 7 vozitësa. Vozitësat e autoparkut janë të angazhuar në sektorin e urgjencës, të cilët mbajnë kujdestari 12 orëshe dhe janë të koordinuar me stafin profesional të urgjencës.

QKMF në Vushtri po ashtu kryen edhe shërbimin e transportit të pacientëve me sëmundje të veshkëve të cilët i transporton në Spitalin e Dializës në Mitrovicë për marrjen e shërbimeve të dializës, po ashtu i transporton prapë në shtëpi, punon në dy ndërrime dhe bënë transportin e 23 pacientëve të komunës së Vushtrrisë, në vise rurale dhe urbane për Dializë në Mitrovicë. Po ashtu kemi 3 pacient me gjendje të rëndë të cilët transportohen me autoambulancë.

Me autorizim të kryetarit të komunës, gjithnjë bazuar në nevojat e qytetarëve të komunës së Vushtrrisë, ne kemi transportuar edhe pacientët me sëmundje të rënda jasht shtetit të Kosovës e që gjatë kësaj periudhe kemi transportuar 4 pacient, Shqipëri, Maqedoni dhe anasjelltas.

Autoparku vozitës në bazë të fletëudhëzimit nga Mjeku kujdestar në Sektorin e Kujdesit Urgjent në QKMF Vushtrri gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, ka transferuar pacientët në Emergjencën e Spitalit Sheikh Zayed në Vushtrri dhe në disa raste ka transferuar pacientët në Emergjencën e SSHKUK-së Prishtinë, dhe në bazë të nevojave bëjm transportin nga SSHKUK në Vushtrri.

Përfundim

Falënderoj të gjithë stafin profesional mjekësor dhe administrativ në ” QKMF-së Dr.Safet Idrizi ”që ka dhënë kontribut në vazhdimësi gjatë gjithë kohës dhe angazhimeve të pakursyera, të cilët gjithnjë kanë qenë të rrezikuar nga sëmundjet ngjitëse, të cilët nuk kanë kursyer vetën në asnjë moment dhe kanë ofruar shërbimet shëndetësore.

Synimi i objektivave për dhënien e shërbimeve shëndetësore cilësore bazohet në planifikimin, organizimin, udhëheqjen dhe kontrollin, e ku me theks të veçantë i kushtohet rëndësi bashkëpunimit, sepse kur jemi të unifikuar mund të arrijmi atë që kemi **objektiv të përgjithshëm**.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vucitrn – Municipality of Vushtrri



Për: Kuvendin Komunal

Propozues dhe hartues: Drejtoria e Arsimit, drejtori Alban Tahiraj

Përmes: Kryetarit të Komunës, Ferit Idrizi

Lënda: Propozim – vendim për formimin e Komisionit për ndarjen e bursave për student dhe shpërblime për nxënës të Komunës së Vushtrrisë.

Duke u Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, dhe nenin Nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores për ndarje të Bursave për Student dhe Shpërblimeve për nxënës Nr.47/23, dt.23.02.2023 Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më, _____ miraton këtë :

V E N D I M
PËR EMËRIM TË KOMISIONIT PËR NDARJE TË BURSOVE

1. Me këtë vendim formohet komisioni për ndarjen e bursave për student dhe shpërblime për nxënës të Komunës së Vushtrrisë, me këtë përbërje:
 - 1.1. Enver Bajrami, zyrtar i DKA-së, kryesues
 - 1.2. Edona Shotani, zyrtare e DKA-së, anëtare
 - 1.3. Bastri Duraku, jurist nga Sekretaria e Kuvendit Komunal Vushtrri, anëtar.
2. Komisioni në fjalë do të zhvillojë të gjitha procedurat për ndarjen e bursave, konform dispozitave të Rregullores për ndarje të Bursave për Student dhe Shpërblimeve për nxënës të Komunës së Vushtrrisë Nr.47/23, dt.23.02.2023.
3. Komisioni i cekur si në nenin 1(një) të këtij vendimi ka mandat një vjeçar (për një vit shkollor/akademik).
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria Komonale e Arsimit dhe Komisioni i lartë cekur.
5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesja e Kuvendit

Melihate Basholli Latifi

A r s y e t i m

Me qenë se anëtarëve të mëparshëm të Komisionit për ndarjen e bursave iu ka skaduar mandati, Drejtoria Komunale e Arsimit kërkon nga Kuvendi Komunal që të bëhet emërimi i komisionit të ri për ndarjen e bursave sipas Rregullores për ndarjen e Bursave për Studentë dhe Shpërblimeve për nxënës Nr.47/23 të datës 23.02.2023 për një vit shkollor.

Me respekt!





Alban Tahiraj
Drejtori i DKA-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova • Republic of Kosova



Komuna Vushtrri
Opstina Vucitrn • Municipality of Vushtrri
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

DATË/A	02.05.2024
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Kuvendin e Komunës Znj. Melihate Basholli-Latifi
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Kryetarit të Komunës Ferit Idrizi 
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit Fortuna Krasniqi-Spahu 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë lidhur me procesin e Lejeve Ndërtimore

Të nderuar,

Bazuar në Planin e punës së Kuvendit Komunal e cila ka të bëjë me Informatën lidhur me procesin e kërkesave për Leje Ndërtimore e cila përfshinë periudhën Janar-Dhjetor 2023 ju informojmë se Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vushtrrisë shqyrton dhe trajton të gjitha kërkesat për Kushte Ndërtimore dhe Leje Ndërtimore për kategorinë e parë dhe të dytë në bazë të Ligjit të Ndërtimit, Ligjit për Planifikim Hapësinor me Nr.04/L-174, Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031, UA mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor me nr.08/2017, UA për kategorizimin e ndërtimeve me nr.04/2017, UA për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për Kushte ndërtimore, Leje ndërtimore dhe Leje rrënimi për kategorinë I dhe të II-të të ndërtimeve me nr.06/2017, Rregullores Nr.03/2016 për Normat Minimale Teknike për Ndërtesat e banimit në Bashkëpronësi dhe Rregullores për Rregullat dhe të gjitha akteve tjera nënligjore që kanë të bëjnë me këtë fushë.

Në kuadër të kësaj Drejtorie janë trajtuar gjithsej 714 kërkesa të ndryshme, vendime, informime, njoftime, pëlqime etj.

- Vendime për Leje Ndërtimore - /28
- Vendime për Leje Mjedisore-/20
- Vendim për Leje për punë të KEDS- 2
- Refuzime për Leje Ndërtimore / 5
- Leje Rrënimi / 8
- Kërkesa të ndryshme(Informime, Pëlqime etj) –671

Deri më 31.12.2023 janë realizuar të hyrat buxhetore në vlerë prej **922,211.37 Euro**

Më poshtë gjeni të bashkangjitur listën e lejeve të ndërtimit.

PROCESI I LEVETË NDRERTIMI PËR VITIN 2023

Nr.	Data e aplikimit të kësaj	Data e shpallimit të fitimit	Prosjekt / Promovues (Përkrahësit)	KATEGORIA E NDRERTIMIT	Kompania investimit	Parçes	Lloji	Emërtimi i objektit	Detajet e objektit
1	09.05.2023	20.05.2023	Saad Xhaferi	I	Saad Xhaferi	P-70202016-06247-8	Rr. "Muzinë Xhaferi"	P-0	Objekt Ekonomik - depo për rruatë e Patisier
2	15.05.2023	12.04.2023	Fehmi Haxemi	II	Fehmi Haxemi	P-70202016-06492-2	Rr. "Gjyq Beqirxhan" dhe Zgjerim "Adem Xhaferi"	B-S-P-2	Objekt Afarist Hotele
3	27.02.2023	11.05.2023	Ces Plan sh.p.k.	II	Jemur Bajrami	P-70202016-06456-0	Rr. "Marxer e Lirze"	B-P-8-PH	Objekt Bannor Afarist
4	18.05.2023	24.05.2023	Luljete Cakaj	I	Luljete Cakaj	P-70202021-00422-0	Rr. "Amerika"	P-0	Depo e panënie dhe perunave
5	04.05.2023	25.05.2023	Blerim Sejdiu promov Blorim Sejdiu B.L. me emër tregtar N.T.P. "Jehona-S"	II	Blerim Sejdiu	P-70202016-06062-0	Rr. "Besh Pejani"	B-P-3	Objekt Afarist Bannor
6	30.08.2023	08.06.2023	NB Construction sh.p.k.	II	Kujtim Pllana, Elxom Uka	P-70202016-06405-0	Rr. "Haxhi Zeka"	2B-P-7-Pb	Objekt Afarist Bannor, blloku A dhe B
7	07.04.2023	06.06.2023	Artiani Company sh.p.k.	II	Naser Iseni	P-70202016-06412-1	Rr. "Enxhem Hyzeu Hironani"	Bloku A B-P-8-Pb, Bloqe B, C, D dhe E 2B-P-8-Pb	Kompleksi Bannor Afarist, Blloku A, B, C, D, E
8	24.04.2023	05.06.2023	Fisat Project sh.p.k.	II	Ajzen Jusufi	P-70202016-06444-0	Rr. "Jeron Termetza"	B-P-7	Objekt Afarist Bannor, adresat A, B, C dhe D
9	17.05.2023	24.07.2023	Arban Hajdini	I	Ajzen Hajdini	P-70202016-01595-13	Rr. "Naser Zambari"	P-1	Shërbë Bannor
10	02.06.2023	23.06.2023	Bedri Elezi	I	Bedri Elezi	P-70202016-06274-1	Rr. "Erver Muxa"	B-P-2	Objekt Afarist Bannor
11	13.06.2023	18.07.2023	Nurije Halili	I	Nurije Halili	P-70202099-00493-0	Rr. "Sadi e Ramadan Manani"	P-NK	Kompleksi Bannor - 4 bajtan
12	21.06.2023	09.08.2023	Naser Iseni	II	Naser Iseni	P-70202016-04013-2	rr. "Avni Kllaku"	P-1	Objekt bannor
13	19.06.2023	04.07.2023	Hasan Haxha	I	Hasan Haxha	P-70202063-00380-0	Rr. "Sairë Dehmeti"	P-0	Dhomë Mjale
14	14.07.2023	24.07.2023	Besnik Çelguri	I	Besnik Çelguri	P-70202020-06544-0	Rr. "Zeqir Kaxha"	P-1	Shërbë Bannor
15	10.07.2023	05.08.2023	Mustafa Mulliqi	I	Mustafa Mulliqi	P-70202016-03006-32	Rr. "Jeron Termetza"	P-1	Shërbë Bannor
16	18.07.2023	16.08.2023	Halima Përçiku	I	Halima Përçiku	P-70202068-01317-3	Rr. "Shabi LUKK"	S-P-1	Objekt bannor - Bujtinë
17	10.07.2023	22.06.2023	Murat Bajraktari	II	Murat Bajraktari	P-70202046-02149-1	Rr. "Toni Bler"	P-0	Restorant Piceri - fast food
18	01.06.2023	14.08.2023	Burimed Building sh.p.k.	II	Leuf dhe Namuf Zhegrova	P-70202016-06537-0	rr. "Izzat Qevaj"	2B-P-8-Pb	Objekt Afarist Bannor
19	18.08.2023	03.09.2023	Xhavit Hajdari	II	Xhavit Hajdari	P-70202016-01056-2	Rr. "Farak Beqiri"	B-P-2	Objekt bannor Gatsh
20	03.05.2023	12.10.2023	Lin Project - v sh.p.k.	II	Ferik Hashimelhaseni	P-70202016-06490-0	Rr. "Jeron Termetza"	B-P-7	Objekt Bannor afarist blloku 1 dhe 2
21	07.06.2023	08.11.2023	Dijari sh.p.k.	II	Vilazim Zariqi	P-70202016-06422-0	Rr. "Kadi Zeka"	2B-P-8-Pb	Objekt Afarist Bannor
22	12.08.2023	24.11.2023	Zarifi Group sh.p.k.	II	Veton Zariqi	P-70202016-06507-0	Rr. "Tasim Paduri"	2B-P-8-Pb dhe B-P-3	Objekt Afarist Bannor, blloku A dhe B
23	05.09.2023	15.11.2023	Kastriot Dakllari	I	Kastriot Dakllari	P-70202016-03006-2F	Rr. "Hoxha Sahasani Muxa"	P-3	Shërbë Bannor
24	28.09.2023	17.10.2023	Dijari Estate sh.a.	II	Muharrem Zariqi	P-70202016-06531-0	Rr. "Erver Muxa"	2B-P-8-Pb	Objekt Afarist Bannor
25	29.08.2023	14.11.2023	NTP Rili	II	Samu Ferizi	P-70202016-06440-0	Rr. "S Pllit"	2B-P-8-Pb, B-P-5-P-8-Pb, 2B-P-8-Pb	Objekt Afarist Bannor
26	22.02.2023	08.12.2023	Premium Building sh.p.k.	II	Sylvanë Sahbu	P-70202016-06461-0	Rr. "Gjergj Kastrioti Skenderbeu"	P-0	Objekt Afarist Bannor, 3 Blloqe
27	09.11.2023	08.12.2023	Hib Petrol sh.p.k.	II	Ruga "Ana Lin"	P-70202016-1395-0	Ruga "Ana Lin"	P-0	Objekt restorant polje e derivate
28	03.10.2023	22.12.2023		II	Bashkim Fazlu	P-70202016-02226-4	Rr. "Tahu Smari"	B-P-1	Objekt Bannor Afarist

Valutë	Përshkrim	Periudha	Debiti	Kredit
EURO (€)				
SPROG / LITEM				
66425	- PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - VUSHTRRI	922,062.09	149.28	922,211.37
50009	- TAKSA PËR LEJE NDËRTIMI	771,491.23	77.28	771,568.51
50026	- TAKSA PËR LEGALIZIMIN E OBJEKTEVE	25,663.86	0.00	25,663.86
50033	- TAKSA PËR LEJE RRËNIMI	852.60	0.00	852.60
50045	- LEJE MJEDISORE KOMUNALE	113,076.90	0.00	113,076.90
50405	- SHFRYTËZIMI I PRONËS PUBLIKE	10,977.50	72.00	11,049.50
Total Balance			149.28	922,211.37


Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUÇITRN

DATË:	06.02.2024
PËR:	KPF dhe Kuvendin e Komunës
NGA:	Zdravko Zdravković  Kryesues i Komitetit për Komunitete
LËNDA:	Raporti vjetor i Komitetit për Komunitete për vitin 2023

Të nderuar,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkëngjitur raportin vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2023.

Me respekt!

RAPORTI VJETOR I KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2023 KOMUNA VUSHTRRI

Gjendja e sigurisë

Situata e përgjithshme e sigurisë gjatë vitit 2023 ka qenë në përgjithësi e mirë dhe stabile. Sipas raportimeve të përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë dhe policisë së Kosovës, në territorin e komunës së Vushtrrisë nuk janë regjistruar incidente të mëdha ndëretnike.

Mbledhjet e komitetit të komunitetit

Në vitin 2023, Komiteti për Komunitete ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje, njëra prej të cilave në muajin nëntor ka qenë mbledhje e jashtëzakonshme. Udhëheqja e diskutimeve për çështjet dhe problemet e komuniteteve në komunën tonë.

Në Plan - programin e vitit 2023 kanë qenë të përfshira temat e mëposhtme:

Janar:

- Shqyrtimi dhe miratimi i raportit vjetor për vitin 2022.

Shkurt:

- Diskutim për hartimin e planit të punës së Komisionit për Komunitete për vitin 2023.

Mars:

- Miratimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023.

Prill:

- Diskutim i hapur për gjendjen ekologjike në territorin e komunës së Vushtrrisë.

Maj:

Diskutim i hapur për çështje sociale.

Qershor:

Diskutim i hapur me Kryetarin e Komunës për problemet e Komuniteteve.

Korrik:

Diskutim i hapur për mundësinë e punësimit të të rinjve.

Gusht:

Në këtë muaj nuk ka pasur mbledhje të Komitetit për Komunitete për shkak të pushimeve.

Shtator:

Diskutim i hapur për gjendjen e bujqësisë.

Tetor:

Diskutim i hapur për përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucione si dhe për të drejtat e komuniteteve.

Nëntor – Mbledhja e jashtëzakonshme :

Diskutime të hapura për gjendjen e sigurisë në territorin e komunës së Vushtrrisë.

Nëntor:

Diskutim i hapur lidhur me punën e Zyrës për Komunitete për vitin 2023.

Dhjetor:

Diskutim i hapur me Kryetarin e Komunës për problemet e Komitetit.

- Prezantimi i raportit të punës së Zyrës për Komunitete dhe Kthim për vitin 2023.

Në seancën e parë të mbajtur në janar është miratuar raporti vjetor për vitin 2022.

Në muajin shkurt dhe mars është punuar në hartimin dhe miratimin e planit vjetor të punës së komitetit për komunitete, si dhe në prezantimin e raportit vjetor të punës së zyrës për çështje të komuniteteve dhe kthim.

Në mbledhje për situatën ekologjike në komunën tonë u diskutua për heqjen e deponive ilegale si dhe për problemet që lindin kur nuk kujdesemi për mjedisin. Të gjithë ranë dakord që duhet të ndikojmë në ndërgjegjësimin e qytetarëve për të mbrojtur mjedisin e tyre. Janë paraqitur disa zgjidhje për ruajtjen e mjedisit, ku u propozua heqja e vend grumbullimeve të egra si dhe organizimi i një fushate ndërgjegjësimi të qytetarëve, si dhe raportimi në inspektim të të gjithë atyre që dëmtojnë situatën ekologjike.

Para takimit të Komitetit për Komunitete ku u diskutua për gjendjen mjedisore, u mbajt një seminar me perfaqësuesit e UNMIK-ut ku mësuam se si duhet të funksionojë Komiteti për Komunitete.

Në mbledhjen për gjendjen sociale në komunën e Vushtrrisë,

anëtarët e komitetit diskutuan për sfidat me të cilat ballafaqohen familjet që kanë nevojë për mbështetje sociale dhe shëndetësore. Ndërsa gjatë diskutimit u theksua aspirata e përbashkët e të gjitha komuniteteve lokale për zgjidhjen e këtij problemi.

Drejtori i Zyrës për Çështje të Komitetit dhe Kthimit informoi për ekzistimin e një programi të posaçëm për subvencionimin e familjeve me anëtarë të sëmurë. Megjithatë u theksua se për aplikim kërkohen kritere të caktuara, por për fat të keq, perfaqësuesit e Departamentit Social dhe Shëndetësor nuk ishin të pranishëm gjatë diskutimit, për këtë arsye na u privuan informacionet lidhur me ato kritere

Në muajin qershor takimi i planifikuar i anëtarëve të komisionit me kryetarin e komunës, nuk u zhvillua për shkak të angazhimeve të kryetarit të komunës dhe kjo mungesë e prezencës së kryetarit e kufizoi mundësinë e dialogut të drejtpërdrejtë dhe shkëmbimit të informacionit.

Më pas, anëtarët e komisionit diskutuan për vërshimet që goditën komunën në muajin maj, si dhe për dëmtimin e infrastrukturës gjatë ndërtimit të hekurudhës, duke shkaktuar shqetësim për pasojat në nivel lokal.

- Diskutimi për punësimin e të rinjve, u zhvillua për mundësitë dhe burimet që do të mbështesnin të rinjtë në kërkimin e një pune në Kosovë. U diskutua për konkurset, grantet, subvencionet dhe aktivitetet e komunës.

Është propozuar që të caktohet një takim me Kryetarin për të diskutuar drejtpërdrejt temat e punësimit të të rinjve.

Anëtarët e komisionit ranë dakord se mbështetja për punësimin e të rinjve është thelbësore dhe se është e nevojshme të vendoset komunikim i drejtpërdrejtë me Kryetarin për të zgjidhur çështjet

që kanë të bëjnë me papunësinë e të rinjve në Kosovë.

U propozuan hapa konkretë, duke përfshirë organizimin e fushatave informuese dhe takime të rregullta me Kryetarin e Komunës.

Diskutim i hapur për përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucione dhe të drejtat e komuniteteve.

Përfaqësuesit e Zyrës për Komunitete dhe Kthim deklaruan se situata është e kënaqshme sa i përket gjuhëve zyrtare, por e pranojnë problemin e kapacitetit të komunës për përkthime. Ata propozuan ripunësimin e një përkthyesi. Ata mbështesin iniciativën dhe këshillojnë anëtarët e bordit që kërkesat e tyre t'i paraqesin me shkrim organeve kompetente.

Një anëtar i bordit të komunitetit turk, deklaroi se gjuha turke është e pranuar si gjuhë zyrtare në komunën e Vushtrrisë, por se mungojnë fushatat informuese për dhënien e dokumenteve në gjuhën turke. Ai i propozoi Zyrës për Komunitete dhe Kthim që të organizojë një fushatë informuese për të gjitha komunitetet.

Kryesuesi i Komitetit për komunitete deklaroi se situata nuk është e keqe, por pajtohet me idenë e punësimit të përkthyesve për të gjitha komunitetet, gjuhët e të cilave janë zyrtare në komunën e Vushtrrisë në mënyrë që të përmirësohen shërbimet ndaj qytetarëve.

Në seancën e jashtëzakonshme të muajit nëntor është diskutuar për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë

Takimi mblodhi së bashku anëtarët e bordit, kryesuesin , si dhe përfaqësuesit e institucioneve, për të analizuar situatën aktuale të sigurisë dhe për të identifikuar problemet e mundshme.

Kryesuesi i Komitetit theksoi se në mbledhjen e fundit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi , ku mori pjesë edhe Komandanti i Policisë, janë diskutuar për aspekte të ndryshme të sigurisë, përfshirë aksidentet në komunikacion dhe abuzimin me drogën. Ai theksoi nevojën për të marrë parasysh çështjet e sigurisë dhe për të kontribuar në zgjidhjen e tyre.

U prezantuan problemet që kanë të bëjnë me sigurinë në vendbanimin rom në Prelluzhë, duke theksuar nevojën e vendosjes së “policëve të shtrirë” për të parandaluar shpejtësinë e makinave, veçanërisht duke pasur parasysh rrezikun që kjo paraqet për fëmijët. Në këtë vendbanim propozohet të vendosen të paktën tre barriera për të garantuar sigurinë.

Shefi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim mbështeti idenë e vendosjes së barrierave në Prelluzhë, por theksoi se është e nevojshme që ato të vendosen edhe në vendbanimet tjera. Ai theksoi gjithashtu nevojën për kontrolle më të shpeshta të policisë rrugore për monitorimin e lëvizjes së automjeteve.

Një nga sfidat e identifikuar në komunën e Vushtrrisë është problemi i qenve endacak. U vu në dukje joefikasiteti i masave aktuale të tredhjes së qenve dhe nevoja për të gjetur zgjidhje më efektive. Situata komplikohet edhe më shumë sepse me automjete i sjellin qentë.

U diskutua edhe për problemin e dëmtimit të infrastrukturës rrugore nga kamionët e mëdhenj, veçanërisht gjatë punimeve të riparimit të hekurudhave, ndërsa anëtarët e bordit theksuan nevojën për të kontrolluar lëvizjen e kamionëve, veçanërisht kur fëmijët shkojnë në shkollë.

Në pjesën e dytë të takimit, përfaqësuesi i UNMIK-ut i informoi të pranishmit për vizitën e planifikuar të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të UN në komunën e

Vushtrrisë, duke u dhënë mundësinë anëtarëve të bordit të marrin pjesë në takime me përfaqësues të komuniteteve.

Diskutimi kontribuoi në identifikimin e sfidave kryesore të sigurisë dhe zgjidhjeve të mundshme, dhe do të punohet më tej për zgjidhjen e tyre.

Informacion në lidhje me punën e Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Shefi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim theksoi se raporti i plotë i Zyrës për Komunitete dhe Kthim do të prezantohet në formë të shkruar në shkurt. Anëtarëve të bordit iu prezantua një raport i shkurtër i punës ku ai na njoftoi me aktivitetet e Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

KËRKESAT

Anëtarët e bordit ranë dakord që në vitin e ardhshëm të japim rekomandime dhe kërkesa me shkrim pas çdo takimi për temat që do të diskutojmë, votojmë dhe t'ua dërgojmë autoriteteve kompetente. Gjatë vitit 2023, Komiteti për Komunitete ka shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe ankesat e pjesëtarëve të komuniteteve dhe të gjitha kërkesat do t'i dërgohen me shkrim drejtorive përkatëse për zbatimin e tyre.

Projektet për zhvillimin e komuniteteve joshumicë në komunën e Vushtrrisë

Komiteti për Komunitete gjatë vitit 2023 ka mbështetur projekte për investime kapitale, projektet kryesisht janë të bazuara në rindërtimin dhe ndërtimin e rrugëve, rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit, deri më tani janë realizuar disa projekte dhe presim të realizohen edhe projekte gjatë vitit të ardhshëm.

Konkluzione

Gjatë vitit 2023, Komiteti për Komunitete, gjatë takimeve të mbajtura, doli në këto konkluzione: Takimi me drejtorët e drejtorive komunale, ku duhej të prezantonim problemet, ekologjinë, gjendjen sociale, punësimin etj, nuk u realizua për shkak të mos ardhjes së përfaqësuesve të drejtorive komunale.

Takimi me Kryetarin e komunës, ku edhe ne duhej të prezantonim pikëpamjen tonë për zgjidhjen e problemit, nuk u realizua gjithashtu për shkak të mosardhjes së kryetarit në takim.

Konkluzion për rritjen e efikasitetit të punës së Komitetit për komunitete, shtimin e punës në terren dhe përcjelljen e të gjitha kërkesave direkt me shkrim tek drejtoritë kompetente si dhe kryetarit të komunës pas çdo takimi.

Sfidat

Gjatë vitit 2023, Komiteti për Komunitete ka shqyrtuar dhe zbatuar të gjitha aktivitetet e planifikuara sipas planit për vitin 2023 dhe rregullave të punës së Komitetit për komunitete.

Sfida kryesore mbetet realizimi i projekteve të investimeve kapitale, që të realizohen në kohë dhe pa vonesa në realizimin e tyre.

Ndihmë për familjet në gjendje të rëndë, pjesëmarrje aktive në ndërgjegjësimin për mbrojtjen e mjedisit, si dhe ndihmë në zbatimin e punësimit të të rinjve.

Rritja e efikasitetit të Komitetit për Komunitete, më shumë punë në terren dhe ndihmë në zgjidhjen e problemeve lidhur me çështjet e dakorduara.

Anëtarët e bordit konkludojnë se bordi do të punojë së bashku për të arritur qëllimet për të gjitha komunitetet, pavarësisht sfidave të ndryshme.

Të gjitha takimet zhvillohen në një atmosferë të drejtë dhe demokratike!

Zdravko Zdravković



Kryesues i Komitetit për Komunitete



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI



Kryetari

Informatë
lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
për vitin 2023

Shkurt 2024

Këshilli komunal për siguri në bashkësi i themeluar me Udhëzimin Administrativ të MPB-së dhe MAPL-së është organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi, me përfaqësim të gjerë të të gjitha komuniteteve. Ky këshill ka për qëllim rritjen e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me sjelljet e dhunshme në komunitet, si dhe ndërtimin e besimit në mes të policisë dhe qytetarëve, nëpërmjet ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në bashkësi.

KKSB, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të tij, bashkëpunon me Policinë e Kosovës dhe institucionet qendrore, të cilat merren me sigurinë publike, me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt në bashkësi, si dhe ndërtimin e besimit për jetë të qetë e të sigurt të të gjitha komuniteteve në meset ku ata jetojnë.

Në vitin 2023 janë mbajtur gjithsej 6 mbledhje, sipas Udhëzimit Administrativ. Mbledhjet në këtë këshill janë mbajtur në gjuhët zyrtare në komunë, duke qenë se përbërja e tij është shumë etnike. Mbledhjet e KKSB-së kanë qenë të hapura, ato i kanë përcjell përfaqësues të KFOR-it, OSBE-së, etj. Në këto mbledhje pjesëmarrja e anëtarëve të KKSB-së ka qenë e kënaqshme, dhe secili nga anëtarët e këshillit kanë diskutuar për çështjet dhe problemet për të cilat ka përfaqësuar në këtë këshill, si dhe ka dhënë kontributin në zgjidhjen e problemeve të caktuara. gjithashtu kemi pasur pothuajse çdoherë prezent organizatat ndërkombëtare KFOR-in, OSBE-në, UNMIK etj.

Në këto mbledhje janë shqyrtuar problemet e ndryshme që i preokupojnë qytetarët e Vushtrrisë dhe masat që duhen të merren për parandalimin dhe evitimin e tyre.

Vlen të theksohet se në aspektin e sigurisë - janë shtuar masat e sigurisë në trafik në periudha të caktuara kohore gjatë kohës kurë fëmijët shkonin në shkolle ku duhet ta kalojnë rrugën dhe gjatë sezonit veror kurë ka ekzistuar fluksi i madh i bashkatdhetarëve

Gjithashtu ka bere kontrollimin e armëmbajtjeve, ku si rezultat i këtij kontrolli janë konfiskuar një numër i armëve. Policia është angazhuar në parandalimin e gjuajtjeve me armë zjarri në ahengje të ndryshme, por fatmirësisht numri i tyre është në zvogëlim e sipër, pasi që njerëzit po vetëdijesohen.

Sipas raporteve të policisë numri më i madh i veprave penale është kundër pasurisë, pra vjedhjet dhe vjedhjet e rënda por me angazhimin e shtuar të Policisë, ky numër është dukshëm më i vogël se vitin e kaluar, por në këtë vit është rritur numri i veprave penale të narkotikëve.

Anëtarët e KKSB-së nga radhët e komunitetit serb, turk, rom, dhe ashkali, kanë raportuar lidhur me gjendjen e sigurisë brenda komuniteteve të cilat i kanë përfaqësuar, kanë prezentuar problemet dhe kërkesat e tyre para anëtarëve të këshillit, me të cilat është njoftuar këshilli, me ç'rast janë nxjerr rekomandime për zgjidhjen e problemeve.

Komandanti i Stacionit Policor, përveç raportimit të rregullt për gjendjen e sigurisë, njëkohësisht ka raportuar për bashkëpunimin e mirë me KFOR-in, me përfaqësues të komuniteteve gjatë

punës në terren, ku janë njoftuar më për së afërmi për raportet ndëretnike në vendbanimet multi etnike.

Përveç KKSB-së, edhe Këshillat lokale për siguri në bashkësi si KLSP që përfshin fshatrat: Gojbulë dhe fshatrat Karaçë, Begaj, Sllatinë, Banjskë, Tërllabuq dhe Bashkësia lokale “Kalaja” në Vushtrri si dhe KLSP – Prelluzhë, ku përfshihen fshatrat (Gllavatin, Bivolak, Beçuk, Stroc, Zhilivodë, kanë funksionuar në mënyrë të rregullt. Kurse në qershor të këtij viti është formuar edhe KLSP që përfshin qytetin e Vushtrrisë.

Këto këshilla lokale, kanë mbajtur takime në të cilat janë shqyrtuar çështje me rëndësi dhe interes për komunitetin, si në aspektin e sigurisë ashtu edhe në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike.


Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi



Plani i Punës

i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024

Janar 2024

Hyrje

Keshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) është organ këshillues, në bashkëpunim me Policinë analizojnë dhe shqyrtojnë të gjitha çështjet e sigurisë së komunitetit për të mirën e të gjithë qytetarëve që jetojnë në komunë. Objektiv i KKSB-së është ngritja e vetëdijes kundër llojeve të ndryshme të krimit, kundër prishjes së rendit dhe sjelljeve të dhunshme brenda komunitetit lokal si dhe identifikimi i shqetësimeve lokale sa i përket sigurisë publike përkatësisht krijimin e ambientit për implementimin e një koncepti të sigurisë në bashkësi ku jetojmë, duke mundësuar që institucionet e sigurisë të hyjnë në partneritet me qytetarët e komunës në mënyrë që të evidentohen rastet dhe të ndërmerrin masa preventive në parandalimin e tyre.

Në zbatimin e Planit vjetor të KKSB-së, padyshim rol më të rëndësishëm kanë: Kryetari i Komunës, që njëherit është edhe kryesues i KKSB-së Policia, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtoria për Inspektime, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Administratë, Drejtoria për Arsim, ZBGJ, FSK-ja etj. Krahas mekanizmave institucional komunal në zbatimin e Planit, komuna bashkëpunon edhe me institucionet vendore siç janë Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria për Kthim dhe Riardhësim etj. si dhe me organizatat e ndryshme ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

Qëllimi i Planit të veprimit për siguri në bashkësi është koordinimi efikas i punës dhe aktiviteteve të institucioneve bashkë me qytetarët për të ndërtuar një shoqëri e cila jeton në paqe dhe pa kërcënime nga rreziqet që prekin sigurinë publike personale dhe të pronës duke krijuar në këtë mënyrë imazhin e Komunës së Vushtrisë, si një vendë i qetë, multi etnik dhe me standarde të larta të sigurisë

Mbledhjet e KKSB-së janë të rregullta, minimumi 6 mbledhje në vit, tre në tremujorin e parë dhe tre në tremujorin e dytë.

Kryesuesi i KKSB-së dhe Sekretaria në vazhdimësi i respektojnë afatet kohore për caktimin e mbledhjeve të KKSB-së, dërgimin e ftesave për mbledhje, përpilimin e procesverbalit, Planit të punës, Raportit të punës, si dhe dhënien e informatave të dy Ministrive të lartë cekura dhe organizatave ndërkombëtare lidhur me punën e KKSB-së

Aktivitetet e KKSb-së

Nr.	Objektivat	Aktivitetet	Bartësit e Aktiviteve	Realizimi i Aktivitetit	Vërejtje
1	Promovimi i vlerave të multietnicitetit dhe bashkëjetesës në vendbanimet ku jetojnë komunitetet e përziera.	Promovimi i bashkëjetesës mënyrë e jetesës në page (ligjerata në shkolla) në shkolla dhe institucione fetare	Komuna, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Bashkësitë fetare	Gjatë gjithë vitit	
2	Aktivitetet në identifikimin dhe pengimin e treziqeve kundër radikalizimit dhe ekstremizmit si dhe rehabilitimin e atyre që kanë qenë të involvuar në luftërat e huaja.	Organizimi i ligjeratave me maturanet e shkollave të mesme të larta, si dhe në bashkësitë fetare lidhur me treziqet e ekstremizmit dhe radikalizimit.	Institucionet komunale Policia e Kosovës Bashkësitë fetare	Maj me maturan Shtator, dhjetor, prill në bashkësitë fetare	
3	Parandalimin i aksidenteve në rrugë.	Fushatë vetdijësuese për ngasësit e automjeteve	Policia e Kosovës, Komuna	Nëntor & Prill	
4	Parandalimi i vjedhjeve dhe vjedhjeve të rënda	Aktivite parandaluese	Policia e Kosovës	Gjatë gjithë vitit	
5	Parandalimi i përdorimit të drogës nga të rinjtë sidomos në shkolla.	Fushatë vetdijësuese me nxënës të shkollave të mesme të larta	Policia e Kosovës, Drejtoria e Arsimit, Këshilli i Prindërve Inspekcioni,	Shtator, nëntor, shkurt, prill	

		Takime informuese me prindër	Këshilli i arsimtarëve dhe Këshilli i nxënësve të shkollës		
6	Angazhimet në parandalimin e sjelljeve devijante dhe dhunës në shkollat e komunës sidomos ato të arsimit të mesëm	Kontrolle të rregullta për armëmbajtje të nxënësve në shkolla Trajtimi i dhunës në shkolla në takimet prindër-arsimtar	Institucionet arsimore, ZMF(Zyrtari per Mbrojtjen e Femijeve) Policia e Kosovës, Prindërit	Gjatë gjithë vitit shkollor	
7	Pengimi dhe parandalimi i dhunës në familje .	Fushatë vetëdijësuese Veprime parandaluese	Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale, ZBGJ dhe Bashkësitë fetare	Gjatë gjithë vitit	
8	Parandalimi i konflikteve dhe vrasjeve në shoqëri	Identifikimi me kohë i situatave të tensionuara në shoqëri Veprimet parandaluese	Policia e Kosovës QPS Institucionet, shoqëria civile dhe Bashkësitë fetare.	Gjatë gjithë vitit	
9	Pengimin e qytetarëve që prishin rendin publik.	Identifikimi i rasteve Zbatimi i masave	Policia e Kosovës Inspekcioni Policia	Gjatë gjithë vitit	
10	Aktivitetet për pengimin e zjarreve fushore si dhe marja e masave parandaluese	Fushata vetëdijësuese për dëmet e zjarreve të qëllimshme Identifikime i rasteve	Policia e Kosovës Komuna – Njësi i Zjarrfikësve dhe Këshillat e fshatrave.	Sidomos gjatë stinës së verës	
11	Aktivitetet e shijes së pa autorizuar të mjeteve shpërthyes .	Shitimi kontrollit nga inspektoriat dhe Policia	Policia E Kosovës Inspekcioni	Muaj dhjetor	

		Identifikimi i shitesve Zbatimi i masave ligjore		
12	Aktivitetet e mbrojtjes në punë.	Inspektimet rregullta	Inspektoriat i Punës	Gjatë gjithë vitit
13	Masat mbrojtëse gjatë ndërtimit të objekteve të larta.	Inspektimet rregullta	Inspektoriat i punës	Gjatë gjithë vitit
14	Pengimi i shfrytëzimit të rërës në shtretërit e lumenjve dhe dëmtimi i argjinaturave	Kontrollet rregullta lumenjëve inspektoriat policia	Inspektorati komunal dhe policia	Gjatë gjithë vitit
15	Rregullimin e kanaleve kulluese nëpër tokat bujqësore të cilat janë të rrezikuara nga vërshimet	Identifikimi pengesave	NH "Ibër Lepenc" komuna	Gjatë kohës kur nuk ka apo ka më pak të lashta, në tokat bujqësore
16	Masat në pengimin e ndoqjes akustike.	Paisja inspektorave me aparate për matjen e ndoqjes akustike Identifikimi i vendeve që shkaktojnë ndoqje akustike Zbatimi imasave ligjore	Inspektorati komunal dhe Policia e Kosovës	Gjatë gjithë vitit
17	Masat për eliminimin e rrezikut nga genët endacak.	Hartimi i projektit për menaxhimin e geneve endacak	komuna	Gjatë gjithë vitit e sidomos gjatë sezonit të dimrit.

		Zbatimi i projektit			
18	Identifikimi i rrezeqeve që sjellin rrjetet e elektrike dhe trafot.	Kontrollet e rregullta Njofimi i KEDS-it	Komuna KEDS-i	Gjatë gjithë vitit, sidomos gjatë përkeqësimit të motit – erërave të forta apo reshjeve të mëdha të bores.	
19	Mbikëqyrje e lokaleve hoteliere që mos të shërbehen me pije alkoolike fëmijët nën moshën 18 vjeçare.	Kontrollet e lokaleve hoteliere që shërbejnë pije alkoolike	Policia e Kosovës Drejtoria e Inspektimit	Gjatë gjithë vitit	
20	Mbikëqyrje e lokaleve-kafiterive e veçanërisht ato që ekzistojnë afër objekteve shkollore ku mundësitë për trafikim me mjete narkotike janë më të mëdha.	Vizitat e lokaleve e Përcjellja e produkteve që i shesin këto lokale Paralajmërimi i shitësve të këtyra lokaleve për rreziqet dhe penalizimi	Policia e Kosovës Inspektorati komunal	Gjatë gjithë vitit	
21	Këshillat e nxënësve të veprojnë të organizuar nëpër shkolla, në aspektin e sigurisë në trafik.	Drejtoria e Arsimit e Drejtorët shkollave	Policia e trafikut dhe NJKDNJ	2 herë brenda vitit	
22	Aktivitetet e parandalimit të trafikimit me gënie njerëzore	Fushata vetdijëse me gjeneratat e reja	Policia e Kosovës kryetarët e fshatrave dhe bashkësitë të lagjeve, ZBGJ dhe ZMF	Dy here në vit	
23	Pengimin i krijimit të depolive ilegale	Pastrimi i depolive ekzistuese Ndalmimi i krijimit të depolive përmes kontrollit	Inspekcioni komunal Policia e Kosovës	Në vazhdimësi	

24	Kontrollimi i kombibuseve për mos tejkalimin e numrit të nxënësve sa i përket nr. të ulësve	Kontrolllet e rregullta gjatë orarit të transportit Penalizimi i shkelësve të ligjit	Policia e Kosovës Inspektori i komunikacionit	Sipas nevojës	
25	Përcjellja e rasteve të inkurajimit dhe shkuarjes së individëve nga Komuna e Vushtrisë në lufërat e huaja dhe ndërmarrja e masave ligjore	Fushatë vërdijësuese	Policia e Kosovës Organet e Drejtësisë	Në vazhdimësi	

Ferit Idrizi

Kryesues i KKSBB